



Financuar nga
Bashkimi Evropian

arise Action for Reducing
Inequalities in Education

Programi i Zhvillimit të Shkollës – PZHSH

Manual Burimor





Financuar nga
Bashkimi Evropian

arise Action for Reducing
Inequalities in Education

Frymëzuar nga puna dhe dedikimi ndaj
mësimdhënies i Radmila Rangelov Jusović

Iniciativa për Uljen e Pabarazisë në Arsim
Programi i Zhvillimit të Shkollës - PZSHH
Manual Burimor

Publikuar nga:
Center for Educational Initiatives Step by Step

Për publikuesin:
Nedim Krajišnik

Redaktuar nga:
Adnan Pripoljac dhe Nedim Krajišnik

Autorët:
Adnan Pripoljac
Amna Hodžić
Beba Šarkinović
Ivona Čelebičić
Jasna Kovačević
Jelena Vranješević
Nedim Krajišnik
Muamer Tinjak
Radmila Rangelov Jusović

Kopertina dhe DTP:
Boris Čović

Përkthimi dhe përshtatja në gjuhën shqipe:
Qendra "Fëmijët Janë e Ardhmja"
Sarajevo, 2022.

Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, nëpërmjet Projektit ARISE "Iniciativa për Uljen e Pabarazisë në Arsim". Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të Bashkimit Evropian.



PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS

Nedim Krajišnik

Shkolla nuk është thjesht një vend ku fëmijët dhe të rriturit shpenzojnë kohën çdo ditë, ose ku transmetohen dije dhe ku duhen mësuar e memorizuar të dhëna, fakte, etj.. Shkolla, në radhë të parë, është një komunitet ku transmetohen vlerat dhe normat kulturore dhe ku krijohen marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe të rriturit, është vendi ku fëmija mëson nëpërmjet eksperiencave dhe zhvillon aftësitë që i duhen për të jetuar në një mjedis më të gjerë social.

Si në çdo komunitet tjetër, jeta e shkollës mund të përmbushet nga eksperiencia të gëzueshme, nga një ndjenjë sigurie, mbështetjeje dhe përkatësie. Ne jemi të lumtur të frekuentojmë shkolla të tilla dhe na vjen keq kur largohemi prej tyre, sepse, përveç njohurive, në shkollë ne fitojmë aftësitë sociale dhe krijojmë miqësi dhe aftësi për jetën. Eksperiencia të tilla shkollimi kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit dhe të vetëvlerësimit, ashtu sikurse edhe zhvillimin e empatisë dhe të përkujdesit ndaj të tjerëve, çka ndikon drejtpërdrejt në jetën tonë jashtë shkollës. Një komunitet i fortë shkolle krijon një rrjet mbështetës dhe na bën më të fortë dhe më të vendosur ndaj ndikimeve të ndryshme të mjedisit. Ai na parandalon të marrim vendime të gabuara, të cilat mund të na lëndojnë ne ose të tjerët.

Një mjedis stimulues për fëmijët që vijnë nga një status më i ulët socio-ekonomik është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Për këta fëmijë dhe familje nevojiten ndërhyrje krijuese në shkollë dhe në komunitet për të kapërcyer një pengesë shumë të rëndësishme në të mësuarit dhe përparimin e mëtejshëm. Sipas të gjitha hulumtimeve, ekziston një lidhje e fortë midis sfondit socio-ekonomik të fëmijëve dhe suksesit të tyre në mësim.

Po kështu, përvojat e jetës në komunitetin e shkollës mund të jenë negative, të mbushura me frikëra, ndjenja refuzimi, dështimi dhe ndonjëherë dhunë ose diskriminim. Kjo na bën të ndihemi të pambrojtur, të pakënaqur dhe të mërzitur dhe, për rrjedhojë, të papërgatitur për t'u përballur me sfida të ndryshme. Në çdo rast, koha që kalojmë në shkollë na shënjon në masë të madhe dhe përcakton drejtimin tonë. Përvojat e përfituara në shkollë, qofshin të mira apo të këqia, mbeten për gjithë jetën.

Komuniteti i shkollës përbëhet nga mësues, stafi i shkollës, si edhe prindërit dhe komuniteti, në të cilin jetojnë fëmijët dhe familjet. Çdo anëtar i komunitetit ka nevojë për të njëjtën ndjesi përkatësie, ndjesinë e të qenit i respektuar dhe ndjesinë e të qenit një anëtar i rëndësishëm dhe i vlefshëm i atij komuniteti. Rritja dhe arsimimi i fëmijëve kërkon një partneritet të fortë midis të gjithë anëtarëve të komunitetit, mbështetje reciproke, komunikim të hapur dhe të sinqertë, si edhe përkushtim drejt një qëllimi të përbashkët.

Të gjithë këta komponentë i referohen klimës dhe kulturës së shkollës. Ata përfshijnë vlerat e përbashkëta, besimet, rregullat dhe normat e sjelljes dhe ndërveprimet ndërpersonale, si edhe aksesin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Klima dhe kultura e mirë e shkollës kushtëzohen dhe rezultojnë në një ndjenjë sigurie fizike dhe psikologjike, marrëdhënie të mira reciproke midis të rriturve dhe nxënësve, si edhe në ndjenjën e mbështetjes në të mësuarin dhe zhvillimin, përkatësinë dhe respektin reciprok. Vetëm klima dhe kultura mbështetëse, me gjithçka që ato mbartin, mund të njohin, vlerësojnë dhe ndërhyjnë në trajtimin e fëmijëve që vijnë nga një status socio-ekonomik më i ulët.

Komponentët që përbëjnë klimën dhe kulturën shpesh duken të paprekshëm dhe të pakapshëm. Normat kulturore, zakonet, marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe mënyrat e sjelljes shpesh nënkuptohen paraprakisht ose besohet se zhvillohen vetë. Zhvillimi i klimës dhe i kulturës së shkollës, sikurse edhe organizimi i procesit mësimor, nënkupton aktivitete të planifikuara dhe sistematike, të cilat janë përgjegjësi parësore e administratës së shkollës dhe realizohen me mbështetjen e mësuesve, prindërve, nxënësve dhe gjithë komunitetit.

Programi i Zhvillimit të Shkollës synon në radhë të parë fuqizimin e shkollave në procesin e krijimit të një mjedisi të sigurt, ku çdo fëmijë ndihet i pranuar dhe zhvillon kompetencat e nevojshme për jetën dhe krijimin e një shoqërie të bazuar në vlerat universale njerëzore, respekt dhe mbështetje reciproke.

<p>PËR KË ËSHTË PROGRAMI?</p>	<p>Programi i zhvillimit të shkollës përfshin ekipet e shkollës, mësuesit dhe fëmijët, drejtuesit dhe prindërit. Megjithatë, duke pasur parasysh rolin jashtëzakonisht të rëndësishëm të drejtorit, bashkëpunëtorëve profesionistë dhe anëtarëve të tjerë të administratës së shkollës, të cilët përcaktojnë tonin, mbështesin zhvillimin e marrëdhënieve të mira dhe krijojnë një mjedis pozitiv e mbështetës, programi forcon edhe kompetencat e tyre.</p>
<p>PARIMET KU BAZOHET PZHSH</p>	<p>Programi bazohet në besimin se procesi i përmirësimit të klimës dhe kulturës së shkollës është një proces i vazhdueshëm që kërkon angazhimin dhe partneritetin e të gjithë anëtarëve të komunitetit. Aktivitetet do të përshtaten me nevojat individuale të çdo shkolle dhe do të nxisin formimin e një rrjeti mbështetës, mësimit e ndërsjellë dhe adoptimin e asaj që është mësuar në praktikë.</p>
<p>STRUKTURA E PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS</p>	<p>Programi përbëhet nga pesë module, duke ofruar hapat në procesin e zhvillimit të klimës dhe kulturës dhe hapat e sugjeruar për të zbatuar atë që mësohet pas çdo moduli me mbështetjen e mentorimit. Secili prej moduleve nis nga situata dhe nevojat aktuale të shkollës, ofron një kornizë teorike dhe ide e zgjidhje të ndryshme, shembuj të praktikave të mira ekzistuese dhe mjete dhe instrumente që mund të jenë të dobishme për çdo shkollë.</p>
<p>FOKUSI TEK VLERAT DHE MENDIMI KRITIK</p>	<p>Edukimi dhe zhvillimi i mendjes dhe zemrës së një fëmije është qëllimi themelor i një sistemi arsimor cilësor. Vlerat që përcaktohen përmes sjelljeve specifike na ndihmojnë të marrim vendime të mira, të reflektojmë mbi veprimet dhe pasojat tona, njerëzit e tjerë dhe mjedisin. Ato na ofrojnë udhëzime se si të bëhemi persona me integritet, vetëbesim dhe vetëvlerësim. Të jetosh vlerat do të thotë të jesh në gjendje të ndërtosh një botë të bazuar në parimet e respektit të ndërsjellë, drejtësisë sociale dhe solidaritetit - një botë që ushqen paqen dhe miqësinë, inkurajon përgjegjësinë dhe vlerëson edukimin.</p> <p>Mendimi kritik na mëson se si të vëmë në pikëpyetje vendimet tona dhe botën përreth nesh, të kërkojmë argumente dhe të vërteta, të shohim këndvështrime të ndryshme dhe të gjejmë qëllimin e njohurive dhe të të mësuarit në përdorimin e tyre që kontribuojnë në të mirën e përbashkët. Të menduarit kritik kërkon të bësh pyetje thelbësore, të analizosh informacionin, të nxjerrësh përfundime të bazuara në fakte dhe të veprosh në përputhje me to.</p> <p>Vlerat dhe mendimi kritik janë dy përbërës të pandashëm të çdo njeriu. Ata ndërthuren dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Ata na ndihmojnë të bëhemi njerëz të mirë, versioni i mirë i vetes sonë dhe qytetarë të përgjegjshëm, të aftë për t'i rezistuar ndikimeve të ndryshme negative në këtë kohë dhe shoqëri komplekse.</p>

VARFËRIA DHE ZHVILLIMI I FËMIJËS: IMPLIKIMET NË ARSIM¹

Jelena Vranješević

Rezultatet e studimeve të ndryshme tregojnë një lidhje të fortë midis varfërisë dhe të gjitha aspekteve të zhvillimit të fëmijës: zhvillimi kognitiv dhe socio-emocional, arritjet në shkollë, qëndrueshmëria dhe mekanizmat e përbërësve, etj. Dallimet midis fëmijëve të varfër dhe bashkëmoshatarëve të tyre më të pasur janë veçanërisht të dukshme kur bëhet fjalë për zhvillimin kognitiv dhe gjuhësor.

Ndikimi në zhvillimin e fëmijëve dhe rezultatet arsimore: Arsimi ka një rol vendimtar në thyerjen e rrethit të varfërisë. Rëndësia e arsimit theksohet, si përmes dokumenteve të të drejtave të njeriut, ashtu edhe përmes studimeve për zhvillimin ekonomik dhe social. Sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (1984), arsimi do të jetë falas dhe i detyrueshëm (neni 26). Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) nënvizon se arsimi duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë fëmijët pa diskriminim (neni 28) dhe se ai duhet të jetë me cilësi të lartë (neni 29).

Edhe pse cilësia e arsimit varet nga shumë aspekte të politikave arsimore, mësuesit ende kanë rolin që përcakton më së shumti rezultatin përfundimtar të procesit arsimor.

NDËRHJRJET PËR TË PËRMIRËSUAR ZHVILLIMIN E FËMIJËVE DHE ARRITJET ARSIMORE

Programet dhe politikat që mund të zbusin efektet negative të varfërisë në zhvillimin e fëmijëve varen nga të kuptuarit e natyrës së varfërisë dhe nga shkaqet kryesore të varfërisë (së bashku me strategjitë për shpëtimin nga varfëria). Nëse varfëria përcaktohet në terma ekonomikë, bazuar në masat e të ardhurave, programet dhe politikat do të fokusoheshin në rritjen e të ardhurave qoftë nëpërmjet mundësive të punësimit, apo përmes skemave të mirëqenies. Nga ana tjetër, nëse perceptohet si një disavantazh më i gjerë social, që do të thotë mungesë jo vetëm e pasurive materiale, por edhe e aftësive, të tilla si: përkatësia sociale, identiteti kulturor, respekti dhe dinjiteti, informacioni dhe edukimi, atëherë programet dhe politikat do të fokusoheshin në ndryshimin e të gjithë kontekstit social që mohon të drejtat dhe mundësitë e barabarta dhe inkurajon shtypjen, pabarazinë dhe padrejtësinë (Engle & Black, 2008).

Për sa i përket shkaqeve të varfërisë, disa studiuues dhe politikëbërës ia atribuojnë ato individëve, kapaciteteve të tyre, aftësive, kompetencave, sistemit të vlerave, motivimit, nivelit të aspiratës/aspiratave arsimore, etj. Në këtë kuptim, ndërhyrjet që ata zgjedhin për trajtimin e varfërisë fokusohen në ndryshimin e mentalitetit të individëve, rritjen e motivimit dhe nivelit të aspiratave të tyre dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre përmes programeve arsimore dhe mbështetëse. Qëllimi kryesor i këtyre programeve është përmirësimi i kapaciteteve të individëve ose grupeve të varfra në mënyrë që ata të jenë në gjendje të ndërmarrin veprime të qëllimshme dhe të ushtrojnë fuqinë e tyre (Narayan & Petesch, 2007). Problemi me këtë qasje është se ajo mund të përforcojë stereotipet/paragjykimet ndaj njerëzve të varfër (duke i fajësuar ata për varfërinë dhe marginalizimin) dhe të mbështesë mekanizmat shtypës që ruajnë sistemin e pabarazisë (duke u përpjekur të ndryshojnë individët në vend që të ndryshojnë sistemin e padrejtë).

Qasja tjetër që ndërmarrin disa studiuues dhe politikëbërës përfshin të gjithë kontekstin social dhe faktorët e përjashtimit social që i pengojnë grupet ose kategoritë e njerëzve të dalin nga varfëria. Programet që synojnë ndryshimin e kontekstit social përpiqen të zhvillojnë dhe mbështesin mekanizma mbështetës që do të mundësonin barazi dhe drejtësi sociale. Kjo do të thotë ndryshime në strukturën e mundësive, e përbërë nga klima dominuese institucionale dhe strukturat sociale brenda të cilave aktorët e pafavorizuar duhet të punojnë për të përmbushur nevojat dhe interesat e tyre (Narayan & Petesch, 2007).

¹ Përshtatur nga: Breaking the poverty taboo - Creative ideas for mitigating the effects of poverty: school-based activities, Network of Education Policy Centers (NEPC) – Zagreb, 2019.

Strategjitë për uljen e varfërisë mund të ndahen në tre kategori (Dearing, 2008; Engle & Black, 2008):

1. Strategjitë që fokusohen në uljen e varfërisë familjare, duke rritur të ardhurat e familjeve të varfra dhe, në këtë mënyrë, duke përmirësuar mirëqenien psikologjike të fëmijës
2. Strategjitë që përqëndrohen në parandalimin e varfërisë dhe “investimin në të ardhmen” dhe nxjerrin në pah rëndësinë e arsimit, si: rritja e stimulimit të të mësuarit nëpërmjet edukimit të hershëm cilësor, përmirësimi i aftësisë së prindërve për të mbështetur mësimin e hershëm, ngritja e kapaciteteve profesionale të mësuesve, etj.
3. Strategji që fokusohen në sfidimin e praktikave shtypëse institucionale dhe fuqizimin e të varfërve.

TRAJTIMI I PABARAZIVE SOCIO-EKONOMIKE NË SHKOLLË

Arritjet arsimore të nxënësve varen nga mënyra se si ndihen ata në shkollë - hulumtimet tregojnë se mjedisi shoqëror kontribuon në arritjet arsimore mbi vetë arsimin (Prosser 1999, sipas Vuković Vidačić, 2016). (Prosser 1999, sipas Vuković Vidačić, 2016).

A është e nevojshme të pritet për reforma në shkollë e kushte më të mira financiare, apo shkollat mund të fillojnë me krijimin e një klime pozitive shkollore?

Megjithëse sistemet arsimore në vende të ndryshme nuk ndajnë të njëjtat parakushte të nevojshme për punën e shkollave, hulumtimi i kryer në Estoni ka konfirmuar se parakushtet e nevojshme për një klimë pozitive të shkollës janë universale dhe pa pagesë dhe se ato varen nga bashkëpunimi midis të gjithë aktorëve në jetën e një shkolle, me theks të veçantë tek nxënësit.

Dëshmitë nga Estonia tregojnë se bashkëpunimi ndërmjet drejtuesve të shkollave, mësuesve, prindërve dhe nxënësve duhet të konsiderohet si vlerë. Mësuesit në Estoni punojnë në mënyrë aktive për të njohur familjet e nxënësve, veçanërisht në fillim të rrugëtimit arsimor të nxënësve. Ata besojnë se marrëdhënia mes nxënësve dhe stafit të shkollës është shumë e rëndësishme. Për më tepër, prindërit përfshihen në shkollë përmes takimeve ku diskutojnë planet e përgjithshme për të ardhmen e shkollës dhe kjo është shumë e rëndësishme për nxënësit me SSE të ulët, sepse kjo ul braktisjen e hershme të shkollës (School Education Gateway, 2015). Së fundi, në rast se nxënësit kanë probleme, stafi mbështetës, punonjësit socialë, mësuesit dhe drejtuesit e studimeve punojnë së bashku për të zgjidhur problemet e nxënësve. Kur flitet për bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet të gjithë aktorëve, është e rëndësishme që nxënësve t'u jepet zë për të shprehur idetë dhe dëshirat e tyre në lidhje me jetën dhe rregullat në shkollë, të cilat mund të arrihen përmes angazhimit në qeverisjen e shkollës. Në rastin e shkollave të Talinit, unioni i nxënësve ka një ndikim të madh dhe është aktor i rëndësishëm në vendimmarrje. Për shembull, nxënësve iu desh të vinin "veton" në dokumentin e zhvillimit të një shkolle që nuk parashikonte një menu vegjetariane në mensën e shkollës. Përveç kësaj, nxënësit mund të mbështesin mësuesit në mësimdhënie dhe të përdorin e të krijojnë kompetencat e tyre në fusha të ndryshme. Të rinjtë që e perceptojnë veten si të lirë mund të ndjejnë se kanë aftësinë për të ndryshuar diçka për veten ose mjedisin e tyre për një qëllim me vlerë; kjo mund të rrisë qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë e tyre ndaj sfidave të jetës (Sharp, 2014). Për më tepër, kjo ndjenjë mund t'i ndihmojë nxënësit drejt rritjes së angazhimit të tyre në zhvillimin e tyre dhe të komunitetit të tyre (Welzel & Inglehart, 2010), gjë që mund të rrisë mirëqenien (Seligman, 2011).

Nxënësit mund të kontribuojnë në jetën e shkollës dhe të krijojnë një klimë pozitive në shkollë duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme ekstrakurrikulare/jashtëshkollore (më tej AEK/AJSH). Aktivitete të tilla duhet të propozohen nga nxënësit, sipas interesave të tyre. Në rastin e aktiviteteve vullnetare, ato duhet të trajtojnë problemet e identifikuara nga nxënësit dhe aktivitetet duhet të sugjerohen nga nxënësit.

Studime të shumta kërkimore kanë treguar se pjesëmarrja e nxënësveve në aktivitetet ekstrakurrikulare/jashtëshkollore mund të ketë shumë rezultate pozitive, të tilla si: vetëvlerësim më i lartë i nxënësve, qëndrueshmëri më e lartë e tyre dhe nivele më të ulëta të depresionit (Fredricks & Eccles, 2006), shkallë më e ulët e braktisjes së shkollës, më pak delikuençë dhe përdorim më të rrallë të substancave (Mahoney & Cairns, 1997).

Pjesëmarrja në aktivitetet ekstrakurrikulare/jashtëshkollore lidhet me rezultate më të mira akademike, nota më të larta, rezultate më të mira në teste, angazhim më të madh në shkollë dhe aspirata arsimore më të larta

(Eccles & Barber, 1999). Zaff etj. (2003) argumentoi se duke marrë pjesë në AEK të strukturuar, të rinjtë mund të eksplorojnë ato ku janë të mirë dhe kështu të rrisin ndjenjën e tyre të vetëvlerësimit dhe janë gjithashtu në gjendje të ndërtojnë marrëdhënie të rëndësishme mentorimi me të rriturit e kujdesshëm, duke ofruar kështu një mjedis për rritje/zhvillim.

Aktivitetet AEK/AJSH ndihmojnë në krijimin ose ruajtjen e një klime pozitive në shkollë, sepse ato hapin mundësi për bashkëpunim midis aktorëve të ndryshëm, duke krijuar marrëdhënie të ngrohta dhe mbështetëse dhe zhvillimin e ndërsjellë të identitetit, vlerave, qëndrimeve dhe sjelljes së shkollës.

Përfaqësuesit e shkollave estoneze kanë theksuar se ata nuk kanë strategji të veçanta për të punuar me nxënës me SSE të ulët, por ata ruajnë një klimë mbështetëse në shkollë – ku ka rëndësi zëri i secilit nxënës, ku nxënësit mbështeten të njohin dhe zhvillojnë kompetencat e tyre, të njohin veten e tyre, të zhvillojnë vetëvlerësimin, të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të mësojnë nga njëri-tjetri, që do të thotë të zhvillojnë rrethana, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e potencialit të plotë dhe arritje më të mira akademike për të gjithë nxënësit.



MODULI 1:

MINI SHKOLLA E VLERAVE

Përmes këtij moduli, pjesëmarrësit e ekipit të shkollës do të kryejnë trajnime të strukturuar për vlerat - metodat e mësimdhënies dhe krijimin e vlerave të shkollës, të cilat duhet të rezultojnë me ndryshime në praktikë, politika dhe monitorim shumë të qartë. Vlerat e mësimdhënies zhvillohen kryesisht si pjesë e procesit të mësimdhënies dhe mësuesve duhet t'u sigurohet trajnimi i duhur dhe mbështetja mentoruese, shembuj të mirë dhe ide për aktivitete të ndryshme. Mini Shkolla e Vlerave do të mbështesë zhvillimin e kompetencave të mësuesve dhe programi duhet të zbatohet në shkollë përmes komuniteteve të të mësuarit.

Krijimi i një sistemi të përbashkët vlerash në një shkollë është një proces që përfshin nxënësit, prindërit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollës. Zbatimi i këtij procesi do të jetë detyrë e Ekipit të Veprimit të Shkollës pas përfundimit të këtij moduli.

PËRMBAJTJA E MODULIT

- Vlerat - pikënisje teorike dhe përkufizimi i termit
- Udhëzime se si të përshkruhen vlerat nëpërmjet sjelljeve të dëshiruara
- Mjetet dhe udhëzimet se si të sigurohet një pjesëmarrje kuptimplotë e fëmijëve, prindërve dhe komunitetit në procesin e përzgjedhjes dhe përcaktimit të vlerave të shkollës
- Këshilla dhe truke se si të flasim për vlerat; si të arrihet mirëkuptimi i përbashkët...
- Udhëzime se si të mbështesim komunitetin e shkollës për të kuptuar, reflektuar dhe mbrojtur vlerat e zgjedhura
- Udhëzime se si të përfshihen vlerat në kulturën, politikat dhe procedurat institucionale duke përdorur mekanizma mbështetës...
- Udhëzime se si të modelohen proceset në shkollë duke përfshirë rolin e drejtuesve - modelimi nga niveli i leadershipit vertikalisht ose horizontalisht, modelimi hierarkik, modelimi emocional.
- Udhëzime për lehtësimin e reflektimeve në grup

REZULTATET/STANDARDET E MODULIT

- Shkolla ka një vizion, mision dhe vlera të qarta:
- Të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës (prindërit, nxënësit, mësuesit dhe i gjithë stafi i shkollës) janë të informuar për vlerat, si edhe anëtarët e komunitetit më të gjerë.
 - Vlerat thelbësore dhe mesazhet që lidhen me të menduarit kritik janë të dukshme dhe shfaqen në shkollë (ato shfaqen në ndërtesën e shkollës, në faqen e internetit të shkollës, në njoftimet dërguar prindërve, në ngjarjet e shkollës, etj.).
 - Vlerat janë formuluar në mënyrë që të mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin e rregullave, politikave dhe procedurave të shkollës - shpjegohen përmes një grupi sjelljesh të dukshme dhe të matshme
 - Stafi i shkollës, nxënësit dhe prindërit mund të identifikojnë vlerat thelbësore dhe të qartësojnë rëndësinë e tyre
 - Drejtuesit e shkollës dhe të gjithë mësuesit modelojnë, mësojnë dhe inkurajojnë sjellje që rrjedhin nga vlerat e përbashkëta

DETYRAT E SHKOLLES PAS MODULIT:

- Të zhvillojë misionin, vizionin dhe vlerat e përcaktuara me aktorët kryesorë të komunitetit të shkollës (fëmijët, mësuesit, drejtuesit e shkollës, prindërit, përfaqësuesit e komunitetit)
- Të finalizojë procesin e pajtueshmërisë së vlerave në shkollë - të organizohen takime dhe forma të tjera lehtësimi si pjesë e procesit të përcaktimit të vlerave.
- Të përcaktojnë të gjitha vlerat përmes sjelljeve të matshme dhe të dukshme dhe t'i shfaqë ato në shkollë

SHKOLLA QË JETON/MISHËRON VLERAT

Nedim Krajišnik

A nuk do të ishte mirë sikur çdo ditë të kishim mundësinë të ktheheshim në mjedisin tonë të sigurt, në të cilin ushqehen dhe jetojnë/mishërohen vlerat? Të prisnim me padurim për një vend, të cilit i përkasim vërtet, ku mendimet dhe besimet tona janë të rëndësishme dhe të respektuara. A nuk do të ishte këndshëm të ecje nëpër një shkollë që rrezaton vlera, ku ke ndjesinë se gjithçka është produkt i bisedave, përpjekjeve dhe të të mësuarit tuaj? Nëse jeni prind, mund ta gjeni lehtësisht hapësirën e rregulluar për ju dhe të ndiheni i/e mirëpritur. Të gjithë e kanë të qartë se çfarë vlerash qëndrojnë pas njerëzve që jetojnë në atë shkollë. Jo vetëm që vlerat janë të qarta dhe shpalosen në postera të ndryshëm dhe hapësira të rregulluara bukur, por ju jeni gjithashtu të vetëdijshëm për rregullat dhe sjelljet që janë të dëshirueshme në atë shkollë. Kështu, të gjithë i kuptojnë ato vlera në të njëjtën mënyrë dhe janë të përkushtuar që t'i respektojnë ato. Ju i evokoni ato me krenari dhe sovranitet. Me çdo brez, hapësira bëhet edhe më e bollshme për përvojat e fëmijëve të rinj dhe prindërve të tyre. E imagjinoni?

Ne mendojmë se është e mundur të krijohen mjedise të tilla. Vlerat mund të jenë një element bashkues i komunitetit tuaj shkollor. Është e rëndësishme të theksohet se, nëse dëshironi vërtet të krijoni një shkollë që i jeton/mishëron vlerat, ju keni nevojë për aleatë. Këta janë kolegët dhe prindërit tuaj që duhet të përfshihen vazhdimisht në këtë proces, secili në fushën e tij. Në çfarëdo rasti, mos u dorëzoni. Ndonjëherë do të keni mundësinë të bindni disa nga kolegët tuaj dhe ndonjëherë të gjithë komunitetin e shkollës. Filloni me atë që është në fuqinë tuaj dhe në duart tuaja –KLASA DHE SALLA E MËSUESVE.

Këta janë hapat që ju duhet të ndërmerrni për të filluar krijimin e shkollës së vlerave:

NË SALLËN E MËSUESVE/PERSONELIT MËSIMOR

Përpara se të shkojmë në klasa dhe t'u drejtohem nxënësve dhe prindërve, një bisedë rreth vlerave duhet të fillojë në sallën e mësuesve. Pse? Parimi i parë dhe më i rëndësishëm në mësimdhënien e vlerave është modeli i sjelljes, por edhe arritja e një të kuptuari uniform të vlerave kryesore që duam dhe duhet t'iu mësojmë fëmijëve dhe që të gjithë duam t'i jetojmë në shkollën tonë. Nëse mësuesit nuk do të jenë të parët në të, atëherë nuk mund as të flasim për mësimdhënie autentike të vlerave. Vlerat thelbësore janë diçka që ne i ndajmë të gjithë dhe diçka që nuk do të bënim kurrë kompromis.

Ju mund të filloni një bisedë me kolegët tuaj duke pyetur pse vlerat janë të rëndësishme për ne dhe pse është e rëndësishme të diskutojmë për vlerat dhe t'i shpjegojmë e mësojmë ato? Ndani përvojat tuaja personale nga moduli i parë dhe nisni një dialog për vlerat në shkollën tuaj. Në një proces të mëvonshëm, mësuesit nga shkolla juaj do të ndjekin trajnimin e programit të quajtur "Shkolla e Vlerave", ku ata do të kuptojnë më thellë kuptimin e vlerave dhe mënyrat e mësimdhënies së tyre. Ata do të trajnohen për të përdorur mjete dhe qasje të ndryshme në mësimdhënien e vlerave. Megjithatë, për të ditur se çfarë të mësojmë, duhet të kemi një kornizë ose marrëveshje më të gjerë mbi vlerat tona të përbashkëta.

HAPI 1.

Filloni një diskutim më të gjerë të vlerave në sallën e mësuesve. Ju mund të filloni me pyetje të thjeshta në lidhje me perceptimin personal, përvojën dhe të kuptuarit e vlerave, të tilla si:

- Cilat janë vlerat tuaja?
- Si i adoptuat ato dhe sa me saktësi e dini se ato janë vlerat tuaja? Si i jetoni ato?
- Si ju janë mësuat vlerat në familjen tuaj?
- A kanë ndryshuar vlerat tuaja me kalimin e kohës?
- Çfarë do të thotë që kanë humbur vlerat ose nuk ka më vlera?
- Çfarë e ka shkaktuar këtë situatë?
- A flasim mjaftueshëm për vlerat – mes nesh, me fëmijët, prindërit?

HAPI 2.

Pas një interviste hyrjeje ose një serie intervistash në varësi të kapaciteteve tuaja dhe konceptit që keni parashikuar, mund të kaloni në hapin e dytë që na çon në përcaktimin e vlerave të shkollës. Ato sigurisht që ndryshojnë nga vlerat personale apo familjare, sepse ato duhet të jenë universale dhe domethënëse për të gjithë.

Varni një poster me një listë vlerash në sallën tuaj të mësuesve. Në poster ka 30 vlera pohuese. Nëpërmjet reflektimit dhe bisedës së përbashkët, qëllimi juaj është të dilni me një listë vlerash që janë të rëndësishme për të gjithë ju, vlera që komuniteti i shkollës suaj beson se i ka dhe që duhet të ushqehen dhe të mësohen. Jemi të sigurtë që do të zbuloni se të gjitha vlerat në listë janë të rëndësishme - si t'i zgjidhni ato më të rëndësishmet? Mbani mend se ju do t'ua mësoni ose do të flisni me fëmijët për të gjitha vlerat nga lista, por ato që do të zgjidhni do të përcaktojnë të gjitha aktivitetet në shkollën tuaj, do të ndikojnë në rregullat e sjelljes, në mënyrën se si i planifikoni dhe zbatoni aktivitetet dhe, ç'është më e rëndësishme, ato që nuk dëshironi të bëni kurrë kompromis. Janë ato që ju dëshironi t'i jetoni çdo ditë!

Ju lutemi kini parasysh se si nxënësit ashtu edhe prindërit do të kenë fjalën në zgjedhjen e vlerave.

HAPI 3.

Posterit është vetëm një udhëzues. Tani mund t'iu jepni detyrë anëtarëve të stafit tuaj që të mendojnë për këtë listë në periudhën e ardhshme dhe për vlerat dhe besimet e tyre në lidhje me rolin tuaj të edukimit dhe arsimimit. Si rezultat përfundimtar i këtij hapi, secili nga kolegët tuaj duhet të ofrojë 5 vlera që i delegon si të rëndësishme për shkollën. Mos harroni të përfshini personelin jo mësimdhënës në këto biseda.

Është thelbësore që mësuesit të kuptojnë vlerat për të cilat po flasin, veçanërisht nga aspekti i sjelljes që është tipar i një vlere të caktuar. Për të qenë plotësisht e qartë, është e rëndësishme që ata të jenë të vetëdijshëm për pasojat ose reagimet ndaj sjelljeve të caktuara që janë në përputhje me vlerat specifike.

Mendoni për një vlerë të veçantë nga tre aspekte:

Kuptimi: Çfarë do të thotë kjo vlerë për ju? Si e kuptoni dhe e përkufizoni atë?


Sjellja: Cilat situata dhe sjellje janë manifestim i një vlere të zgjedhur? Çfarë presim konkretisht nga kolegët/fëmijët/prindërit në këtë drejtim?

Pasojat: Cilat janë pasojat e një sjelljeje të caktuar - si reagojmë ndaj sjelljeve të dëshirueshme dhe të padëshirueshme që lidhen me një vlerë të caktuar?

HAPI 4.

Këtu jemi në hapin e fundit. Tani që secili prej jush ka menduar për vlerat tuaja, çfarë kuptimi kanë ato për ju në mënyrë specifike dhe pse këto janë vlerat që shkolla juaj duhet t'i ushqejë dhe t'i mësojë, le të shkruajë secili prej jush emrin (ose etiketën) nën 5 vlerat e zgjedhura në poster. Pasi të keni mbledhur të gjitha votat, mund të vendosni numrin total të votave në hapësirën pranë një vlere të caktuar (zemër), të mbledhni numrin total të votave dhe më pas të renditni vlerat e zgjedhura nga kolegët tuaj.

Tani duhet të jetë më e qartë nëse ka një marrëveshje apo mosmarrëveshje mes jush dhe deri në ç'masë, ose edhe nëse ka një të kuptuar të ndryshëm të vlerave të caktuara. Shumë mirë, thjesht është e rëndësishme të flasim për të dhe të arrijmë një konsensus.



Zgjidhni 10 vlerat që kanë më shumë vota për t'i analizuar më thellë, por edhe jepuni mundësi kolegëve të propozojnë disa nga vlerat që nuk ishin ndër 10 më të votuarat për t'ju bindur ndoshta për mendimin e tyre.

Për t'u siguruar që keni një listë të plotë (mund të keni 5 por edhe 10 vlera shkollore), analizoni vlerat e përzgjedhura për t'i parë ato nëpërmjet aspektit të sjelljes dhe ndikimit në jetën tuaj të përditshme në shkollë. Më poshtë janë disa sugjerime për analizë.

KONCEPTI/ PËRKUFIZIMI I FJALËS

Ju mund të përdorni disa nga format grafike të ofruara për një shpjegim dhe përkufizim më të detajuar të vlerave të caktuara.

HARTA E FJALËVE ju ndihmon të kuptoni më mirë një koncept të veçantë, në këtë rast vlerat, si dhe të integroni përvojën tuaj me përkufizimin.

Procedura:


1. Përzgjidhni një vlerë (term)
2. Cilat janë karakteristikat e njerëzve që e jetojnë/mishërojnë atë vlerë?
3. Çfarë shembujsh të aplikimit të kësaj vlere mund të jepni? Pse është ai një shembull i mirë?

PËRKUFIZIMI I FJALËVE (MODELI FRAYER) është një organizues tjetër grafik për krijimin e fjalorit.

Ai kërkon nga kolegët tuaj të përcaktojnë konceptin dhe të zbatojnë njohuritë e tyre duke krijuar shembuj dhe jo-shembuj; vizatoni një figurë/simbol për të ilustruar kuptimin e fjalës. Ky informacion është shkruar në një tabelë që është e ndarë në katër seksione.

Ju mund të krijoni një mur në sallën tuaj të mësuesve me vlera të përcaktuara që do t'ju çojnë në përzgjedhjen përfundimtare të vlerave që janë të rëndësishme për shkollën tuaj.

NË SHTOJCA GJENDEN SHEMBUJ TË KËTYRE ORGANIZUESVE QË MUND T'I PËRDORNI. KOPJOJINI DHE NDAJINI ME KOLEGËT TUJ. GJITHASHTU, ËSHTË NJË LISTË E VLERAVE IDENTIKE ME ATO NË POSTERA QË ATA MUND T'I MARRIN PËR KUJTJESË.



NË KLASË

Shfrytëzoni rastin e parë për të filluar një bisedë rreth vlerave në klasat tuaja. Merrni kohë për t'i prezantuar nxënësit (dhe më vonë prindërit) me faktin se në periudhën e ardhshme do të flisni intensivisht dhe do të mësoni për këtë temë. Sigurisht, sipas nevojës, aktivitetet do t'i përshtatni me moshën dhe aftësitë e fëmijëve. Nuk ka kufi të moshës më të hershme kur flitet me fëmijët për vlerat. Të gjithë fëmijët mund ta bëjnë atë në mënyrën e tyre. Sa më herët të filloni, aq më lehtë do të jetë për fëmijët t'i adoptojnë dhe të mësojnë t'i jetojnë /mishërojnë vlerat.

Ju mund të përdorni gjithçka për të filluar një bisedë. Mund të jetë një përrallë, një histori, një film ose thjesht një ngjarje në korridorin e shkollës që mund të shërbejë si një "grep" për temën tuaj. Bëni pyetje të ndryshme dhe përpikuni të shihni se në çfarë niveli i kuptojnë vlerat fëmijët. Filloni me atë se çfarë kuptimi kanë vlerat për ta ose cili është kuptimi i vlerave në përgjithësi? Ju mund të përdorni teknikën "Brainstorming/Stuhi mendimesh" ku kapni dhe shkruani në një dërrasë të zezë ose letër flipchart gjithçka që fëmijët thonë në lidhje me termin "vlera". Stuhi mendimesh do të thotë që fëmijët t'i shprehin lirisht mendimet e tyre, pa i ndërprerë apo komentuar idetë e tyre.

Mundohuni të përcaktoni kuptimin e vlerave së bashku dhe cilët elementë janë të rëndësishëm kur flasim për vlerat.

Është e rëndësishme që ata të kuptojnë se vlerat janë:

- përgjigje e pyetjes - çfarë lloj personi dëshironi të jeni
- çfarë do të dëshironit të thoshin të tjerët për ju - si jeni?
- ajo që ne besojmë se është shumë e rëndësishme për ne në jetë
- çfarë përcakton se si do të veprojmë në një situatë
- parimet, standardet, karakteristikat personale ose sjelljet që ne i konsiderojmë të vlefshme ose të dëshirueshme
- diçka që i jep kuptim jetës sonë

Mundohuni të renditni disa vlera me fëmijët. Ata mund të përpiqen të përshkruajnë njerëzit që admirojnë ose që janë të rëndësishëm për ta - si janë, çfarë vlerësojnë tek ata (mirësia, ndershmëria, respekti, guximi, besnikëria ...).

Flisni për:

Kuptimin: Çfarë do të thotë kjo vlerë për ta? Si e kuptojnë ata? Nëse fëmijët kanë vështirësi në përcaktimin e kuptimit, mundohuni të përdorni pjesë të tjera të fletës së punës për të rritur kuptimin dhe për të formësuar të kuptuarin e tyre.

Sjelljen: Cilat situata dhe sjellje mund të themi se përfaqësojnë një manifestim të një vlere të zgjedhur?

Pasojat: Cilat janë pasojat e sjelljes sonë tek njerëzit e tjerë - kur sjellje të tilla janë të mira e të bazuara në vlera dhe kur nuk janë?

Mos harroni se në korridorin e shkollës do të shfaqet një poster i madh me një listë prej 30 vlerash pohuese, i cili mund të shërbejë si kornizë për diskutimin e vlerave. Edhe një herë, kjo fazë e bisedës me fëmijët duhet vetëm të krijojë parakushte për përcaktimin e vlerave të përbashkëta dhe krijimin e një shkolle që i jeton/mishëron vlerat. Në proceset e mëvonshme, mësuesit do të trajnohen me një sërë teknikash dhe strategjish për t'i shpjeguar e mësuar më thellë vlerat.

HAPI 1.

Hidhiuni një sy të gjitha vlerave të shfaqura në poster (aneks). Pyetini ata nëse ka vlera që nuk janë në postera dhe që ata do të donin t'i vendosnin në listë - diçka që është e rëndësishme për ta.

Shpjegojuni nxënësve tuaj se së bashku ju duhet të zgjidhni ato vlera që do t'i jetojnë të gjithë në shkollën tuaj - vlera që na ndihmojnë të sillemi në atë mënyrë që të gjithë në shkollë të ndihen mirë. Sjelljet që tregojnë vlera të caktuara mund të bëhen rregullat e tyre të përbashkëta të mundshme.

Si fillim, çdo fëmijë mund të zgjedhë 5 vlera që i duken të rëndësishme dhe t'i shkruajë në letër. Ata mund të diskutojnë në grup nëse kanë zgjedhur vlera të njëjta ose të ndryshme. Së pari, ata mund të përpiqen të bien dakord në grupe të vogla se cilat vlera janë më të rëndësishme për ta dhe pse?

Më pas, kërkoni të përzgjedhin një nga vlerat e zgjedhura dhe të përpiqen ta përkufizojnë atë duke përdorur hartën e përkufizimit të fjalëve (shtojca). Diskutoni nëse të gjithë ndajnë një kuptim të përbashkët për të njëjtën vlerë.

Vendosni një poster ku fëmijët mund të votojnë për 5 vlerat e tyre më të rëndësishme duke shkruar emrin e tyre ose duke vendosur një yll poshtë vlerës. Në zemër, pranë vlerës, shkruani numrin e votave për vlerën e dhënë. Shihni se çfarë do të dalë, cilat 5-10 vlera janë më të rëndësishme për ju dhe sigurohuni që të gjithë bien dakord me të. Nëse nuk ka marrëveshje, lejojini fëmijët, vlera e të cilëve nuk është në listë, që të shpjegojnë pse mendojnë se është e rëndësishme. Nëse argumenti është i mirë, ju mund të ndryshoni mendim.

KËTU MUND TË PËRDORNI TË NJËJTAT FORMA DHE MODELE GRAFIKE TË OFRUARA PËR ANËTARËT E STAFIT DHE PËRSHTATINI ATO ME MOSHËN E FËMIJËVE.

HAPI 2.

Mos harroni të përfshini prindërit. Dërgojuni atyre një letër me një listë vlerash në mënyrë që të gjithë në shtëpinë e tyre të mund të flasin për vlerat. Letrën mund ta gjeni në shtojcë. Përveç kësaj, ju mund të organizoni një takim me prindër dhe një workshop me prindërit për të diskutuar vlerat dhe për të vendosur për cilat të votoni.

HAPI 3.

Pasi fëmijët dhe prindërit të kenë pasur mundësinë të mendojnë për vlerat, gjeni kohë për të përcaktuar listën përfundimtare të vlerave të klasës së bashku me fëmijët. Renditni vlerat që klasa juaj dëshiron të delegojë në nivelin e shkollës.

HAPI 4.

Kur ta përfundoni këtë, shënoni klasën tuaj nën ato vlera që klasa juaj dëshiron të delegojë (në korridorin/hollin shkollës).

HAPI 5.

Në fund të procesit, punoni së bashku për të bërë një renditje të vlerave që shkolla juaj dëshiron të jetojë/mishërojë. Nëse vlerat e klasës suaj ndryshojnë, ju mund t'i shtoni ato që mungojnë në listën tuaj të klasës dhe të merrni vlerat tuaja të brendshme që do të shërbejnë si bazë për krijimin e rregullave të përbashkëta.

Shtojcë: Letër drejtuar prindërve

Të dashur prindër!

Do të donim t'ju njoftojmë se në klasën dhe shkollën tonë kemi vendosur të hapim temën e vlerave. Ne do të donim të punojmë së bashku dhe ta bëjmë shkollën tonë të jetë një vend ku vlerat pozitive jetojnë/mishërohen dhe jo vetëm të flitet për to. Vlerat tuaja dhe vlerat që ushqen familja juaj janë shumë të rëndësishme për ne, në mënyrë që ato të përfaqësohen edhe në klasën tonë apo në shkollën tonë.

Së bashku me këtë letër, ne po ju dërgojmë një listë me vlerat që kemi diskutuar në klasën tonë dhe që mund t'ju ndihmojnë të filloni një bisedë në familjen tuaj për atë që është e rëndësishme për ju. Ju lutemi mos e konsideroni si përfundimtare. Mos hezitoni nëse dëshironi të shtoni ndonjë. Do të ishim të lumtur nëse do ta bënit këtë.

Si fillim, të gjithë anëtarët e familjes mund të zgjedhin disa vlera nga lista dhe të shpjegojnë pse janë të rëndësishme ato vlera për ta, çfarë kuptimi kanë për ta, si i kanë fituar ato, kush i ka mësuar dhe si, etj. Tregojuni fëmijëve historitë tuaja të fëmijërisë, kush ishin modelet tuaj përta i përket vlerave dhe pse?

Si rezultat përfundimtar, ne duam të marrim 5 vlera që do të dëshironit që fëmijët tuaj t'i mësonin dhe të jetonin me to në shkollën tuaj. Kur të vendosni se cilat janë ato, shkruajini në listën e bashkangjitur.


















Këtu janë disa pyetje të tjera që mund t'ua bëjnë më të lehtë të mendoni për vlerat:

- Çfarë kuptimi ka një vlerë e caktuar për ju?
- Kur manifestohet ajo – në cilat situata ose sjellje?
- Çfarë sjelljesh të bazuara në vlera prisni prej fëmijëve?
- Çfarë bëjmë ne si prindër për promovimin e këtyre vlerave? A jemi ne modele për fëmijët tanë?
- Çfarë do të donim të promovonte shkolla?

Ne mezi presim të shohim listat tuaja dhe të dëgjojmë se për çfarë keni biseduar! Ne së shpejti do të kemi një takim në shkollën tonë ku të gjithë do të ndajmë historitë tona.

Deri atëherë, le t'i jetojmë vlerat!

LISTA E VLERAVE

 PUNË NË GRUP	 SHQETESIM PER TE TJERET	 DREJTËSI SOCIALE
 TRIMËRI	 NDEKSHMËRI	 BARAZI
 KRIJIMTARI	 SUKSESI	 DASHURI
 PAQE	 ARSIMIM	 RUAJTJE E NATYRËS
 PËRKUSHTIM	 PËRGJEGJËSI	 PËRKATËSI
 FAMILJE	 DREJTËSI	 RESPEKT
 ANGAZHIM	 PUNË	 DIVERSITET
 BASHKËPUNIM	 LIRI	 SOLIDARITET
 LUMTURI	 TOLERANCË	 KURIOZITET
 SHËNDET	 MIQËSI	 SIGURI



...

VLERAT TUAJA

VLERAT

1:

NE

2:

DUAM

3:

TË JETOJMË

4:

...

5:

Shtojcë: Fletë pune

VLERA:


KUPTIMI:


MUNDOHUNI TË KUJTONI NJË SITUATË KU DIKUSH KA VEPRUAR NË PËRPUTHJE ME ATË VLERË.

MUNDOHUNI TË KUJTONI NJË SITUATË KU DIKUSH KA SHKELUR VLERAT.

A PËRJETUAT NDONJË PASOJË TË STELLJES SUAJ? NËSE PO, ÇFARË LLOJ PASOJASH?

SI DO T'UA MËSONIT TË TJERËVE OSE SI DO T'I FRYMËZONIT ATA ME KËTË VLERË?







ÇDARË VLERASH DËSHIROJMË T'U MËSOJMË FËMIJËVE TANË?

Ne kemi zgjedhur 12 vlera që janë edhe vlera universale sipas kuptimeve të ndryshme ndërkombëtare. Kjo kornizë është një bazë shumë e mirë për të diskutuar se cila nga sjelljet tona është në kundërshtim me vlerat për të cilat duam të flasim dhe, në anën tjetër, cili është roli i shkollës dhe çfarë duhet t'u mësojmë fëmijëve?

VLERAT	SJELLJET TONA QË USHQEJNË VLERAT	ÇFARË NUK PO BËJMË? Cilat sjellje janë në kundërshtim me këtë vlerë?	ROLI EDUKUES I SHKOLLËS Çfarë duhet t'iu mësojmë fëmijëve? Çfarë kanë nevojë të dinë, çfarë aftësish u duhen?
RESPEKTI	<p>Ne besojmë se të gjithë njerëzit, pavarësisht nga mosha, gjinia, origjina, klasa dhe çdo përkatësi tjetër, janë njësoj të rëndësishëm</p> <p>Ne e pranojmë veten dhe besojmë se jemi njerëz të mirë të denjë për t'u respektuar</p> <p>Ne respektojmë të drejtën e njerëzve të tjerë për të pasur mendimin e tyre edhe kur ai është i ndryshëm nga i yni</p> <p>Ne i vlerësojmë njerëzit sipas karakteristikave të tyre personale, jo sipas statusit të tyre material</p> <p>Ne e dëgjojmë dhe përpiqemi ta kuptojmë njëri-tjetrin</p> <p>Ne e trajtojmë veten me mirësi dhe kujdesemi për ndjenjat e njerëzve të tjerë</p>		
PËRGJEGJËSIA	<p>Ne e kuptojmë se të kesh një të drejtë do të thotë të kesh një përgjegjësi</p> <p>Ne e mbajmë fjalën dhe premtimin dhe respektojmë marrëveshjet</p> <p>Ne pranojmë pjesën tonë të përgjegjësisë dhe veprojmë në përputhje me rrethanat</p> <p>Ne përpiqemi ta bëjmë pjesën tonë të punës sa më mirë që mundemi</p> <p>Ne marrim përgjegjësinë për sjelljen tonë dhe jemi të vetëdijshëm për pasojat</p>		

<p>MIQËSIA</p>	<p>Ne ndajmë me njëri-tjetrin të mirat dhe të këqijat Ne jemi besnikë dhe të sinqertë dhe krijojmë besim të ndërsjellë Ne ndihmojmë njëri-tjetrin pa pritur asgjë në këmbim Ne flasim hapur për problemet dhe i zgjidhim ato së bashku Ne tregojmë se është e rëndësishme për ne se si ndihen miqtë/shokët tanë Nuk përjashtojmë askënd dhe i urojmë të mirën njëri-tjetrit Ne inkurajojmë njëri-tjetrin të jemi më të mirë dhe të suksesshëm</p>		
<p>DREJTËSIA</p>	<p>Ne flasim dhe vlerësojmë të vërtetën Ne bëjmë atë që është e drejtë, edhe kur askush nuk na shikon Ne nuk pretendojmë sukseset, përpjekjet dhe pasuritë e të tjerëve Ne jemi të drejtë dhe marrim vendime bazuar në ndërgjegje, jo në interes personal Ne i pranojmë gabimet tona dhe jemi të gatshëm të pranojmë pasojat</p>		
<p>SHËNDETI</p>	<p>Ne e vlerësojmë jetën dhe të gjitha format e jetës që ekzistojnë Ne kujdesemi për shëndetin tonë dhe shmangim çdo gjë që mund ta rrezikojë atë Ne përpiqemi të hamë ushqime natyrale dhe të shëndetshme nga mjedisi ynë Ne ushtrohemi rregullisht dhe flemë rregullisht Ne vlerësojmë respektin dhe sjelljen atletike Ne nuk rrezikojmë shëndetin e njerëzve të tjerë dhe mjedisin me veprimet tona Ne ndihmojmë të sëmurët dhe të pafuqishmit</p>		
<p>NATYRA</p>	<p>Ne e kuptojmë se edhe ne jemi pjesë e natyrës dhe se gjithçka në natyrë është e lidhur Ne vëzhgojmë natyrën, jetojmë me të dhe mësojmë prej saj Ne përdorim çdo mundësi për të shijuar natyrën dhe bukuritë e saj Ne mbrojmë dhe respektojmë të gjitha qeniet e gjalla Ne kujdesemi për natyrën dhe ngremë zërin kundër shkatërrimit të saj Ne i përdorim të gjitha burimet natyrore me zgjuarsiri dhe në mënyrë ekonomike</p>		

<p>EDUKIMI/ARSIMI</p>	<p>Ne përpiqemi të mësojmë diçka të re çdo ditë dhe në të gjitha situatat Ne jemi kureshtarë, bëjmë pyetje dhe eksplorojmë botën përreth nesh. Ne ndajmë njohuritë, ndihmojmë njëri-tjetrin dhe mësojmë nga njëri-tjetri Ne respektojmë përpjekjet, punën dhe përparimin e të gjithëve Ne vlerësojmë artin dhe kulturën, ne e studiojmë dhe e ruajmë atë Ne gjithmonë përpiqemi të bëjmë më të mirën që mundemi dhe bëjmë më të mirën Ne jemi këmbëngulës dhe përpiqemi t'i arrijmë qëllimet tona</p>		
<p>TRIMËRIA</p>	<p>Ne përpiqemi të bëjmë atë që është e drejtë, edhe kur e dimë që do të jetë e vështirë ose që jemi në pakicë Ne themi atë që mendojmë edhe kur të tjerët nuk janë dakord Ne rezistojmë kur të tjerët përpiqen të na bindin të bëjmë diçka që ne mendojmë se nuk është e mirë Frika nga gabimi ose dështimi nuk na pengon të provojmë përsëri</p>		
<p>SOLIDARITETI</p>	<p>Ne ndjejmë empati për problemet dhe vështirësitë me të cilat përballen njerëzit e tjerë dhe përpiqemi t'i ndihmojmë ata, pavarësisht se kush janë dhe ku jetojnë Ne mësojmë për njerëzit dhe kulturat e tjera dhe zbulojmë se cilat janë interesat dhe qëllimet tona të përbashkëta Ne e kuptojmë se të gjithë jemi anëtarë të racës njerëzore dhe se duhet ta ndihmojmë njëri-tjetrin Ne respektojmë dhe mbrojmë dinjitetin dhe të drejtat e çdo personi Ne ndihmojmë me vetëmohim njerëzit dhe komunitetet e tjera dhe kontribuojmë për të mirën e përbashkët Ne ndihemi dhe veprojmë jo vetëm si banorë të komunitetit tonë, por edhe si banorë të planetit Tokë</p>		

<p>LUMTURIA</p>	<p>Çdo ditë ne gjejmë diçka që na bën të lumtur Ne jemi të lumtur me veten dhe mirënjohës për atë që kemi Ne gjejmë gëzim tek miqësia, mirësia dhe te të ndarit e gjërave Ne festojmë dhe gëzohemi për suksesin e të tjerëve Ne jmi pozitivë dhe optimistë dhe besojmë se çdo problem ka një zgjidhje Ne përpiqemi të gjejmë diçka të mirë edhe në situatat më të vështira</p>		
<p>BARAZIA</p>	<p>Ne ndjekim rregullat që kemi bërë së bashku Ne respektojmë opinionin e të gjithëve kur marrim vendime dhe përpiqemi të jemi të drejtë Ne mbrojmë të drejtat e atyre në pakicë Në diskutim përdorim argumentet dhe të vërtetën Ne negociojmë për të marrë ose ndryshuar një vendim Ne luftojmë për të drejtat tona dhe të drejtat e të tjerëve, për lirinë dhe dinjitetin</p>		
<p>PAQJA</p>	<p>Ne gjithmonë përpiqemi të gjejmë një zgjidhje jo të dhunshme për një problem Ne mendojmë për pasojat para veprimeve tona Ne i ndihmojmë të gjithë të ndihen të sigurtë dhe e mbrojmë njëri-tjetrin Ne pranojmë pasojat e veprimeve tona dhe përpiqemi t'i korrigjojmë ato Ne kërkojmë falje sinqerisht dhe e falim njëri-tjetrin</p>		

MODULI 2: SI TË KRIJOJMË KLIMËN DHE KULTURËN E SHKOLLËS TË BAZUARA NË VLERA DHE MENDIMIN KRITIK

Moduli i parë duhet t'i përgjigjet pyetjes se çfarë lloj shkolle duam të krijojmë dhe pse është e rëndësishme të promovojmë dhe të mësojmë vlerat. Fokusi i këtij moduli është klima dhe kultura e shkollës, përcaktimi, analiza dhe përputhja e saj me standardet dhe treguesit e një shkolle që ushqen marrëdhënie të mira, ku të gjithë ndihen të sigurtë dhe të respektuar dhe ku i identifikojmë qartë fëmijët dhe familjet në nevojë. Moduli do të përmbajë hapa të qartë në procesin e identifikimit dhe krijimit të klimës dhe kulturës së shkollës, vizionit e misionit. Ky është gjithashtu hapi i parë dhe më i rëndësishëm në hartimin e një plani të zhvillimit të shkollës dhe krijimin e klimës dhe kulturës së shkollës.

PËRMBAJTJA E MODULIT

- Çfarë është klima dhe kultura e shkollës - si matet dhe ku ndikon ajo?
- Si mund ta përmirësojmë klimën dhe kulturën e shkollës?
- Aktivitete për përmirësimin e klimës dhe kulturës së shkollës që nxisin vlerat dhe mendimin kritik (katalog i ideve, kalendari i shkollës...)
- Zhvillimi i ndjenjës së komunitetit, përkatësisë etj. të të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës
- Modelimi i vullnetit të mirë për klimën dhe kulturën në shkollë duke përdorur Standardet e Shkollës që promovojnë vlerat dhe mendimin kritik

REZULTATET/STANDARDET E MODULIT

- Ekipet e Veprimit të Shkollës e njohin kuptimin dhe rëndësinë e klimës dhe kulturës së shkollës
- Hulumtimi dhe analiza e situatës aktuale në shkollë në aspektin e klimës dhe kulturës dhe analiza e vizionit dhe misionit aktual të shkollës nga Ekipi i Veprimit të Shkollës (EVSH)
- EVSH ka identifikuar aktivitetet për përmirësimin e klimës dhe kulturës së shkollës
- EVSH i njeh Standardet e një shkolle që promovon vlerat dhe mendimin kritik

DETYRAT E SHKOLLËS PAS MODULIT

- Të kryejë hulumtime mbi pikëpamjet e drejtuesve, mësuesve, nxënësve dhe prindërve në lidhje me kulturën e shkollës

PËR KULTURËN DHE KLIMËN NË SHKOLLË

Jasna Kovačević

"Kur shumë të vegjël pajtohen,
fuqia rritet njëqind herë,
Do të thotë se jemi më të fortë, se frymëzojmë
kur së bashku në një kor performojmë..."

(Kolonë zanore e filmit nga Drago Britvić from "Treni në Dëborë")

Kultura e shkollës është një tërësi rregullash dhe traditash të pashkruara, si edhe simbole, mite e legjenda, norma dhe pritshmëri që depërtojnë në të gjitha sferat e shkollës. Këta elementë të kulturës ndikojnë në mënyrën se si njerëzit sillen, vishen, flasin, kërkojnë ndihmë nga kolegët ose jo dhe, gjithashtu, ndikojnë në mënyrën se si mësuesit ndihen për punën e tyre dhe suksesin e nxënësve (Deal dhe Peterson, 1999). Një kulturë e shëndetshme në shkollë: (1) ndihmon në interpretimin e historisë, vlerave dhe zakoneve që mund t'i ndihmojnë anëtarët e shkollës të mësojnë se cilat sjellje janë (të padëshirueshme); (2) inkurajon një përkushtim ndaj vlerave të shkollës nga mësuesit dhe nxënësit, duke kontribuar në diçka në të cilën ata besojnë vërtet; (3) shërben si një mekanizëm kontrolli përmes të cilit drejtorët mund të stimulojnë dhe/ose dekurajojnë sjellje të caktuara dhe (4) rezulton në produktivitetin e anëtarëve të shkollës (Martin dhe Siehl, 1983).

Nga ana tjetër, klima e shkollës përfaqëson cilësinë e mjedisit shkollor dhe më së shpeshti reflektohet në cilësinë e marrëdhënieve ndërpersonale të perceptuara nga këndvështrimi i stafit të shkollës, nxënësve dhe prindërve. Në këtë kuptim, klima e shkollës është një tregues i "shëndetit organizativ" të shkollës (Hoy, 1990). Klima manifestohet ekskluzivisht në formën e besimeve dhe perceptimeve të anëtarëve të stafit për faktorët e cilësisë së marrëdhënieve ndërpersonale. Ndonëse nuk është arritur ndonjë konsensus për një përkufizim universal të klimës së shkollës, teoricienët bien dakord se klima e shkollës përcaktohet nga faktorët e sigurisë (p.sh., siguria fizike dhe socio-emocionale në shkollë), niveli i kohezionit social (p.sh., partneritetet dhe lidhjet në shkollë), procesi i të nxënësve dhe mësimdhënies akademike, zhvillimi profesional i stafit dhe karakteristikat organizative (p.sh., lidhshipi, struktura e shkollës, disponueshmëria e burimeve). Kultura, përveç elementeve "të padukshme" si: besimet, perceptimet dhe emocionet, përfshin elementë simbolikë të dukshëm, si: simbolet, strukturat, politikat, ritualet, mitet, heronjtë dhe modele të tjera të dukshme të sjelljes (Figura 2). Megjithatë kultura dhe klima shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, d.m.th., si sinonime, është e rëndësishme të theksohet se kultura e shkollës përcakton klimën, dhe kështu është një koncept më i gjerë se klima, siç ilustron Figura 1.




Figura 1.

Klasifikimi më gjithëpërfshirës i llojeve të kulturave shkollore është dhënë nga Fullan dhe Hargreaves (1996) dhe Deal dhe Peterson (1999), të cilët i klasifikojnë kulturat shkollore si: toksike, të fragmentuara, të

ballkanizuara, kultura të kolegjalitetit të dukshëm, kultura të kolegjalitetit të këndshëm dhe kultura bashkëpunuese.

Kulturat toksike janë specifike në energjinë e tyre që drejtohet kundrejt ndryshimit. Dështimet e mëparshme shfaqen vazhdimisht dhe komunikimi është i njëanshëm dhe hierarkik. Mësuesit cilësorë e perceptojnë një shkollë të tillë si një vend, nga i cili duan të largohen sa më shpejt që t'u krijohet mundësia. Mbizotëron një ndjenjë dëshpërimi dhe pesimizmi.

Kulturat e fragmentuara janë të pranishme në ato shkolla ku mësuesit janë të izoluar nga njëri-tjetri. Në këto shkolla glorifikohet individualizmi dhe dekurajohet çdo përpjekje për bashkëpunim dhe mbështetje nga jashtë. Mësuesit zakonisht nuk janë të njohur me praktikën e kolegëve të tyre. Autonomia vlerësohet dhe mësuesit lihen të kujdesen për veten e tyre. Dhënia e mbështetjes dhe e ndihmës perceptohet si arrogancë nga ana e atij që ofron mbështetje dhe si shenjë e paaftësisë së atij që e merr atë mbështetje.

Në **kulturat e shkollave të ballkanizuara**, bashkëpunimi zhvillohet vetëm brenda grupeve të njerëzve që kanë një mënyrë të ngjashme të menduarit dhe të vepruarit, d.m.th., në klanet e mësuesve dhe rrethet e miqve. Në këto kultura, shprehet prania e nënkulturave të forta të mësuesve që konkurrojnë për pozicione dhe burime. Grupe të tilla mund të jenë në formën e atyre që u japin mësim të rinjve dhe atyre që u japin mësim nxënësve adoleshentë në shkollat 9-vjeçare. Nuk ka konsensus brenda shkollës si e tërë. Kjo kulturë është specifike për komunikimin e dobët, indiferencën dhe grupet e mësuesve që kanë synime dhe aspirata të ndryshme.

Kulturat e kolegjalitetit të dukshëm janë krijime artificiale, në të cilat bashkëpunimi dhe struktura e marrëdhënieve përcaktohen nga lidhësi i shkollës. Drejtuesit e shkollave kërkojnë të përshpejtojnë procesin e ndryshimit, duke detyruar bashkëpunimin dhe duke kontrolluar faktorët që kontribuojnë në bashkëpunimin midis mësuesve, nxënësve dhe prindërve. Kultura e shkollës është e përqendruar në mbështetjen e qasjeve dhe teknikave të reja, por kjo qasje është sipërfaqësore në masën që zvogëlon motivimin e mësuesve për të bashkëpunuar përtej asaj që pritet. Kjo lloj kulture dekurajon kolegjalitetin e vërtetë.

Një **kulturë e kolegjalitetit/bashkëpunimit të këndshëm** është specifike në atë që mësuesit inkurajohen të kenë takime më të shpeshta për të diskutuar idetë e reja. Megjithatë, takime të tilla kufizohen në ofrimin e mbështetjes "së këndshme". Mendimi kritik mbahet në minimum ose nuk ekziston.

Në **kulturat bashkëpunuese** zhvillimi profesional i mësuesve bazohet në ndërvarësinë e tyre dhe në kushte ku ka një konsensus mbi vlerat morale dhe edukative. Ndihma, mbështetja, besimi, çiltërsia, refleksiviteti kolektiv dhe efikasiteti kolektiv janë në thelb të kulturës bashkëpunuese. Mësuesit ushqejnë kuriozitetin dhe kreativitetin, dhe janë të përkushtuar për të gjetur metoda të reja mësimdhënieje dhe forma të reja të të mësuarit. Fokusi i diskutimeve të mësuesve është tek përmirësimi i arritjeve të nxënësve. Mësuesit kalojnë kohë duke vëzhguar njëri-tjetrin me synimin për të dhënë një mendim dhe analizë kritike të metodave të mësimdhënies. Drejtuesit e shkollave ofrojnë mjaft mbështetje për forcimin e kapaciteteve kolektive, si edhe për zhvillimin individual të çdo mësuesi.



Figura 2: Aspekte të dukshme dhe të padukshme të kulturës

Elementet thelbësore të kulturës së shkollës janë misioni, qëllimi dhe vizioni i shkollës. Është e sigurt që misioni dhe vizioni janë katalizatorë të forcave të padukshme në shkolla dhe ato frymëzojnë ose demotivojnë mësuesit që të jenë mësues të shkëlqyer, frymëzojnë drejtuesit e shkollave të drejtojnë shkollat, fëmijët të mësojnë dhe prindërit dhe komunitetin lokal të kenë besim tek shkolla (Deal dhe Peterson, 2016). Vizioni lidhet me të ardhmen e shkollës, d.m.th., qëllimin përfundimtar që shkolla dëshiron të arrijë në të ardhmen, ndërsa misioni ofron informacion për të tashmen dhe hapat e nevojshëm për të arritur vizionin e një shkolle të së ardhmes më të mirë. Zhvillimi i misionit dhe vizionit është një proces sfidues, në të cilin duhet të përfshihen një numër i madh i aktorëve të shkollës dhe gjatë të cilit duhet të arrihet një konsensus mbi vlerat kyçe që përcaktojnë misionin dhe vizionin.

KULTURA DHE KLIMA E SHKOLLËS

Kultura duhet të jetë një çështje thelbësore në të gjitha aspektet e jetës së shkollës. Nëse drejtorët nuk i kushtojnë rëndësi kulturës së shkollës, kjo nuk do të thotë se kultura nuk ekziston. Rëndësia e kulturës si një mekanizëm specifik motivimi dhe kontrolli bëhet më e dukshme në kushtet kur shkolla është në transformim, ose kur shkolla apo autoriteti kompetent prezanton ndryshime rrënjësore që kërkojnë vlera kulturore të ndryshme ose të reja. Gjatë këtij sesi, ne do të fokusohemi në: (1) rëndësinë e kulturës dhe klimës në kontekstin e ndryshimit, (2) interpretimin e "sinjaleve" kulturore dhe mjeteve për identifikimin dhe analizimin e kulturës aktuale të shkollës, dhe (3) ofrimin e udhëzimeve praktike se si të maten dhe menaxhohen ndryshimet, si edhe kultura dhe klima e shkollës. Instrumentet dhe metodat e paraqitura për identifikimin e llojeve të kulturës do të mund të testohen/përdoren nga pjesëmarrësit në shkollat e tyre (p.sh., në një seancë të Këshillit të Mësuesve, ose në sesione dhe takime të veçanta tematike). Bazuar në të dhënat e marra duke përdorur këto teknika dhe mjete, drejtuesit e shkollës mund të ndërmarrin vendime dhe politika specifike të shkollës dhe të ndikojnë kështu drejtpërdrejt në menaxhimin e ndryshimeve, klimën dhe kulturën e shkollës si mekanizma organizativë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

Çdo ndryshim në mënyrë të pashmangshme kërkon që njerëzit të dalin nga zonat e tyre të rehatisë, veçanërisht ato ndryshime që ndryshojnë vlerat dhe kulturën. Në këtë drejtim, drejtorët e shkollave duhet të jenë të vetëdijshëm për kompleksitetin e ndryshimit në mënyrë që ta menaxhojnë me sukses ndryshimin, por gjithashtu të jenë të vetëdijshëm për sjelljet komplekse të mësuesve dhe stafit të shkollës në reagimet ndaj ndryshimit.

ROLI I LIDERSHIPIT NË KRIJIMIN DHE ZHVILLIMIN E KLIMËS DHE KULTURËS SË SHKOLLËS

“Ndryshimi është një thikë me dy presa. Ritmi i tij i pandalshëm ditët e sotme na impenjon shumë. Megjithatë, kur gjërat janë të ndryshueshme, ne mund të gjejmë mënyra të reja për të ecur përpara dhe për të depërtuar gjë që nuk është e mundshme në shoqëritë stanjative. Nëse u kërkon njerëzve të mendojnë fjalë për të përshkruar ndryshimin, ata dalin me një përzierje termash negativë dhe pozitivë. Nga njëra anë janë: frika, ankthi, humbja, rreziku, paniku; në anën tjetër janë: ngazëllimi, marrja e rrezikut, emocionimi, përmirësimet, energjia. Për mirë apo për keq, ndryshimi ngjall emocione dhe, kur emocionet intensifikohen, çelësi është lidhshipi”.

(Fullan, 2001, Leading in a Culture of Change, f. 1)

Të gjitha aspektet e jetës njerëzore ndikohen nga forcat politike, sociale dhe ekonomike në një botë të globalizuar. Për rrjedhojë, transformimet dhe ndryshimet në institucionet arsimore bëhen konstante që përcaktojnë sjelljen dhe veprimet e nxënësve dhe mësuesve. Në teorinë e lidhshipit të shkollës, por edhe në praktikë, vëmendja më e madhe i kushtohet lidhshipit mësimor dhe transformues dhe lidhjes së tyre me suksesin e nxënësve. Drejtorët e shkollave që praktikojnë lidhshipin transformues ndihmojnë në zhvillimin e kulturave bashkëpunuese të shkollës, duke krijuar një vizion të përbashkët, duke përmirësuar komunikimin dhe duke zhvilluar një sistem vendimmarrjeje cilësore të bazuar në bashkëpunimin me mësuesit, nxënësit dhe prindërit. Nga ana tjetër, lidhshipi mësimor fokusohet në thelbin teknologjik të shkollës, që do të thotë, në përcaktimin e synimeve dhe qëllimeve të shkollimit, sigurimin e burimeve në procesin mësimor, monitorimin dhe vlerësimin e punës së mësuesve, koordinimin e zhvillimit të stafit dhe krijimin e një klime të kolegjalitetit mes mësuesve. Gjatë këtij sesi, do të trajtojmë rëndësinë e drejtorëve si lidera/udhëheqës në procesin e zhvillimit të klimës dhe kulturës nga këndvështrimi i modelit të Leithwood të lidhshipit të shkollës, i cili përfshin praktikatat transformuese dhe mësimore.


FORMATE TË ANALIZËS SË KULTURËS DHE KLIMËS NË SHKOLLË

A1A. FLETË PUNE-TIPOLOGJIA E KULTURËS SË SHKOLLËS

Ju lutemi lexoni përshkrimin për secilin rresht. Ndajini 10 pikë për secilin rresht duke i dhënë pikët më të shumta shprehjes me të cilën jeni më shumë dakord dhe numrin më të vogël të pikëve ose asnjë pikë tek shprehja me të cilën nuk binin dakord. Për shembull, nëse, për mendimin tuaj, një shprehje është 100% e saktë, atëherë shënoni 10 pikë vetëm tek ajo shprehje, ose vendosni 5 pikë tek një shprehje dhe 5 pikë të tjera tek shprehjet e tjera sipas rëndësisë së tyre.

1. Suksesi i nxënësve	Shumica e mësuesve besojnë se kur nxënësit nuk arrijnë sukses të kënaqshëm, është faj i nxënësve.	Mësuesit zakonisht nuk diskutojnë çështje që lidhen me suksesin e nxënësve.	Shumica e diskutimeve mes mësuesve në lidhje me suksesin e nxënësve kufizohen në mbledhjet e shkollës, klanet e mësuesve ose miqësitë mes mësuesve.	Mësuesve u jepet kohë për të diskutuar mbi suksesin e nxënësve. Ata priten ta përdorin atë kohë ekskluzivisht për këtë qëllim.	Mësuesve u jepet kohë për të diskutuar suksesin e nxënësve, por pjesa më e madhe e kësaj kohe përdoret për të dhënë këshilla dhe për të ndarë "truket" e mësimdhënies
2. Kolegjaliteti	Shumica e mësuesve nuk duan t'ia dinë për praktikat e mira të mësuesve të tjerë.	Shumica e mësuesve nuk janë të vetëdijshëm për atë që bëjnë mësuesit e tjerë në orët/ klasat e tyre.	Shumica e mësuesve janë të vetëdijshëm për praktikat e mësimdhënies vetëm të atyre mësuesve me të cilët janë miq.	Drejtori i shkollës pret që mësuesit të dinë se çfarë bëjnë kolegjet e tyre në orët /klasat e tyre.	Mësuesit janë gjithmonë të etur për mundësinë për të vëzhguar dhe diskutuar atë që mësuesit e tjerë të shkollës bëjnë në klasat e tyre.
3. Vlerat e përbashkëta	Vlerat që ushqejnë shumica e mësuesve janë në kundërshtim me nevojat e nxënësve.	Ka pak konsensus mes mësuesve për vlerat e shkollës.	Ka grupe më të vogla mësuesish që ndajnë të njëjtat vlera.	Drejtori ka përgatitur një listë me vlerat e shkollës dhe ua ka shpërndarë të gjithë mësuesve.	Ka përkushtim dhe një konsensus të fortë mes mësuesve se cilat janë vlerat e shkollës.
4. Vendimmarrja	Vendimet janë shumë të lehta për t'u marrë, sepse shumica e mësuesve nuk shqetësohen për pjesëmarrjen në vendimmarrje.	Mësuesit zakonisht nuk janë të interesuar të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes që prek nxënësit.	Ka grupe më të vogla mësuesish që përpiqen të kontrollojnë vendimet që prekin nxënësit.	Drejtori pret që mësuesit të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në lidhje me nxënësit.	Është e natyrshme që mësuesit të marrin pjesë në vendimmarrjen që lidhet me nxënësit.
5. Marrja e risqeve	Shumica e mësuesve përpiqen ta mbrojnë mësimdhënien e tyre nga "risitë".	Shumica e mësuesve nuk eksperimentojnë me ide të reja.	Inovacionet në mësimdhënien zakonisht initiohen nga mësuesit brenda një klase ose aseti të vetëm.	Drejtori kërkon që mësuesit të zbatojnë risi në mësimdhënien e tyre.	Mësuesit janë vazhdimisht në kërkim të metodave inovative të mësimdhënies.
6. Besimi	Mësuesit flasin me njëri-tjetrin pas shpine.	Besimi mes mësuesve nuk është diçka që konsiderohet si e nevojshme në këtë shkollë.	Ka mësues që u besojnë vetëm disa kolegëve të caktuar.	Mësuesit janë të ekspozuar ndaj situatave që kërkojnë që ata t'i besojnë njëri-tjetrit.	Ka një ndërvarësi të fortë mes mësuesve në këtë shkollë.

7. Të qenit i hapur	Mësuesit që janë të përkushtuar ndaj nxënësve dhe të mësuarit shpesh kritikohen nga mësuesit e tjerë.	Kur bëhet fjalë për mësimdhënien, mësuesit zakonisht nuk janë të interesuar për sugjerimet e kolegëve të tyre.	Kur bëhet fjalë për mësimdhënien, mësuesit zakonisht i mbajnë mendimet dhe kështillat e tyre për një rreth të ngushtë mësuesish me të cilët janë të afërt.	Gjatë takimeve, mësuesit pritet të marrin pjesë në diskutime për mësimdhënien efektive.	Mësuesit janë herë pas here të hapur për të dhënë ose marrë kështilla në lidhje me mësimdhënien.	Mësuesit janë shumë të interesuar për mendimet e kolegëve.
8. Marrëdhëniet me prindërit	Shumica e mësuesve i shmangin prindërit sa herë që është e mundur.	Kur bëhet fjalë për procesin e mësimdhënies, mësuesit zakonisht nuk duan reagime nga prindërit.	Ka grupe mësuesish që prindërit i perceptojnë si "mësues më të mirë se të tjerët".	Drejtori kërkon që mësuesit të jenë në kontakt të rregullt me prindërit.	Shumica e mësuesve mbështesin prindërit që duan të përfshihen më shumë në praktikat e mësimdhënies.	Mësuesit kërkojnë që prindërit të përfshihen në praktikat e mësimdhënies.
9. Lidhshipi	Drejtori perceptohet si një kërcënim për rritjen dhe përparimin e shkollës.	Drejtori nuk është aq i dukshëm në shkollë dhe mbahet mënjane.	Drejtori shpesh viziton dhe/ose lavdëron të njëjtët mësues.	Drejtori monitoron rregullisht takimet që synojnë përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet mësuesve.	Drejtori informon hapur kur ka raste të praktikave të këqija të mësimdhënies dhe i inkurajon mësuesit të bëjnë të njëjtën gjë.	Drejtori informon hapur kur ka raste të praktikave të këqija të mësimdhënies dhe i inkurajon mësuesit të bëjnë të njëjtën gjë.
10. Komunikimi	Politikat e shkollës zvogëlojnë aftësinë e mësuesve për të diskutuar suksesin e nxënësve.	Komunikimi mes mësuesve nuk konsiderohet i rëndësishëm në këtë shkollë.	Është shumë e vështirë të kesh një dialog produktiv me grupe të caktuara mësuesish.	Komunikimi në shkollë përcaktohet nga hierarkia në shkollë.	Në këtë shkollë mbizotërojnë biseda të ngruhta dhe të këndshme mes mësuesve.	Çdo mësues mund të flasë me secilin mësues për praktikat e tyre të mësimdhënies.
11. Socializimi	Në një kohë shumë të shkurtër, mësuesit e rinj indoktrinohen joformalisht nga mësues toksikë.	Shumë shpejt mësuesit në këtë shkollë mësojnë se është "secili për vete".	Mësuesit e rinj zakonisht "etiketohen" joformalisht dhe më pas bashkohen me grupe të caktuara të mësuesve.	Ka takime për mësuesit e rinj që ata duhet të marrin pjesë.	Mësuesit e rinj inkurajohen të ndajnë përvojat e tyre me mësuesit e tjerë në shkollë.	Vetëkuptohet që të gjithë mësuesit kanë përgjegjësinë për t'i ndihmuar kolegët e rinj të përshtaten.
12. Historia e shkollës	Mësuesit përhapin shumë shpejt histori negative për shkollën.	Zakonisht konsiderohet dobësi profesionale kur mësuesit kërkojnë ndihmë nga mësuesit e tjerë.	Mësuesit në disa klasa, takime ose ekipe e shohin suksesin e tyre si suksesin personal të tyre, jo si suksesin e të gjithë shkollës.	Drejtori ka kontroll të fortë mbi shumicën e atyre që ndodhin në shkollë.	Kjo shkollë njihet për festimin e gjithçkaje.	Në këtë shkollë është e qartë për të gjithë se përparimi i shkollës është një përpjekje e vazhdueshme e komunitetit.
TOTALI	Kolona A:	Kolona B:	Kolona C:	Kolona D:	Kolona E:	Kolona F:



A1B. PËRSHKRIMI I KULTURAVE TË SHKOLLAVE

Kur të plotësoni fletën e punës "Tipologjia e kulturës së shkollës", shtoni numrin e pikëve për secilën kolonë. Numri i përgjithshëm i pikëve jep pamje të kulturës së shkollës suaj. Secila kolonë përfaqëson një lloj të veçantë kulture. Zakonisht, shkollat kanë një përzjerje të llojeve të shumta të kulturave, ku një ose dy lloje janë mbizotëruese. Merrni parasysh: a) sa të saktë e konsideroni llojin e kulturës së identifikuar dhe b) problemet që duhet të adresohen në shkollë për ta bërë kulturën më bashkëpunuese.

KOLONA A: KULTURA TOKSIKE - Në këtë kulturë, mësuesit janë të fokusuar në aspektet negative të jetës së shkollës. Energjia shpenzohet për të frenuar ndryshimin. Dështimet nga e kaluara dalin vazhdimisht në sipërfaqe. Mësuesit e kanë zakon t'i vënë nevojat e tyre mbi nevojat e nxënësve. Komunikimi është direktiv dhe i njëanshëm. Mësuesit cilësorë e perceptojnë këtë shkollë si një vend për t'u braktisur, ndërsa mësuesit mesatarë dhe të këqij mbeten në këtë shkollë. Mbizotëron një ndjenjë dëshpërimi dhe pesimizmi. Ceremonitë që duhet të festojnë suksesin e nxënësve duken sipërfaqësore dhe shpesh janë objekt talljeje.

KOLONA B: KULTURA E FRAGMENTUAR - Në këtë shkollë mësuesit janë të izoluar nga njëri-tjetri. Individualizmi ushqehet dhe çdo përpjekje për bashkëpunim dhe mbështetje të jashtme dekurajohet. Mësuesit shpesh nuk janë në dijeni të praktikës së kolegëve të tyre. Risitë nuk merren parasysh sepse stafi mësimdhënës është i kënaqur me praktikën ekzistuese të mësimdhënies. Drejtori rrallë është i disponueshëm. Dhënia e ndihmës për të tjerët perceptohet si arrogancë nga ana e atij që ofron ndihmë dhe si shenjë dobësie nga ana e atij që ka nevojë për ndihmë.

KOLONA C: KULTURA E BALLKANIZUAR - Në këtë shkollë, bashkëpunimi zhvillohet në grupin e mësuesve që ndajnë mendime të ngjashme ose që janë miq. Kjo kulturë gëlon nga nënkultura mësuesish që janë jashtëzakonisht të forta dhe konkurrojnë për pozicion, burime dhe territor. Këto grupe mësuesish mund të ndahen në ata që u mësojnë nxënësve të vegjël ose atyre adoleshentë. Shkollat si këto karakterizohen nga komunikim i dobët, indiferencë dhe grupe mësuesish që kanë qëllime të ndryshme.

KOLONA D: KULTURA E KOLEGJIALITETIT TË IMPONUAR - Drejtori e imponon bashkëpunimin mes mësuesve. Në këtë mënyrë, ai kërkon të shpejtojë proceset duke detyruar bashkëpunimin dhe duke kontrolluar situatat që kontribuojnë në bashkëpunim. Në një kulturë të tillë, sjellja e mësuesit bëhet e parashikueshme. Kjo kulturë synon të mbështesë qasje dhe teknika të reja në mësimdhënie, por në përgjithësi është shumë sipërfaqësore dhe, në realitet, ul motivimin e mësuesve për të bashkëpunuar përtej asaj që konsiderohet e detyrueshme. Përfundimisht, kjo kulturë çon në dekurajimin e bashkëpunimit real.

KOLONA E: KULTURA E KOLEGJIALITETIT/BASHKËPUNIMIT TË KËNDSHËM - Në këtë kulturë, mësuesit marrin pjesë në diskutime rreth çështjeve të mësimdhënies, por nuk bëjnë pyetje kritike dhe shpesh të sikletshme se si të përmirësohen proceset e mësimdhënies. Komunikimi në këto shkolla është i kufizuar në dhënien e këshillave dhe ndarjen e burimeve/materialeve mësimore. Mësuesit shpesh takohen për të diskutuar ide të reja, por bisedat kufizohen në tema të këndshme dhe mbështetje për njëri-tjetrin. Nuk ka mendim kritik.


KOLONA F: KULTURA BASHKËPUNUESE - Kjo është kultura e shkollës në të cilën zhvillimi i mësuesve realizohet nëpërmjet ndërvarësisë së tyre. Ekziston një konsensus për vlerat e shkollës. Mësuesit janë të përkushtuar ndaj ndryshimit dhe përmirësimit në të gjitha nivelet. Ndihma, mbështetja, besimi, çiltërsia, reflektimi kolektiv dhe efikasiteti kolektiv janë yjet udhërrëfyese të kësaj shkolle. Mësuesit janë kureshtarë dhe kërkojnë mënyra të reja për të përmirësuar proceset e mësimdhënies. Fokusi i diskutimeve të mësuesve është te sukcesi i nxënësve. Mësuesit kalojnë kohë duke vëzhguar njëri-tjetrin dhe duke analizuar në mënyrë kritike metodat e mësimdhënies. Drejtori/drejtoresha e kësaj shkolle është i/e vendosur të ekspozojë praktikën joefektive të mësimdhënies dhe inkurajon zhvillimin individual të çdo mësuesi.

Steve Gruenert & Jerry Valentine, Middle Level Leadership Center, 2000; revised 2006 Based on Fullan & Hargreaves (1996) and Deal & Peterson (1999)

A 2.1. PËRSHKRIMI I RRESHTAVE NË FLETËN E PUNËS PËR TIPOLOGJINË E KULTURAVE NË SHKOLLA

1. SUKSESI I NXËNËSVE	A janë mësuesit të gatshëm të diskutojnë për suksesin e nxënësve dhe a janë diskutime të tilla produktive në mënyrë që t'i inkurajojnë mësuesit të rishikojnë praktikatat e tyre
2. KOLEGJIALITETI	Gadishmëria e mësuesve për të investuar kohë dhe përpjekje në vëzhgimin e kolegëve të tyre me qëllim përmirësimin e përbashkët të praktikave të mësimdhënies
3. VLERAT E PËRBASHKËTA	Shkalla e konsensusit mes mësuesve lidhur me vlerat e shkollës
4. VENDIMMARRJA	Shkalla e përfshirjes së mësuesve në procesin e vendimmarrjes në çështjet që kanë të bëjnë me nxënësit
5. MARRJA E RISQEVË	Gadishmëria e mësuesve për të marrë pjesë në mënyrë të vazhduar në risitë në proceset e mësimdhënies
6. BESIMI	Deri në ç'masë demonstron besimi mes mësuesve?
7. TË QENIT IHAPUR	A pranohet përgjithësisht mbështetja e të tjerëve, që do të thotë, të marrësh mbështetje nga mësuesit e tjerë dhe deri në ç'masë?
8. MARRËDHËNIET ME PRINDËRIT	Në ç'masë konsiderohen prindërit si partnerë që kontribuojnë në procesin arsimor?
9. LIDERSHIPI	Deri në çfarë mase kontribuon drejtori në krijimin e një atmosfere bashkëpunimi në shkollën si e tërë?
10. KOMUNIKIMI	Në çfarë mase ndikojnë rregullat dhe pritshmëritë e shkruara dhe të pashkruara në komunikimin në shkollë?
11. SOCIALIZIMI	A janë të gatshëm mësuesit e shkollave të ofrojnë mbështetje në përshtatjen e mësuesve të rinj në mjedisin e ri të punës?
12. HISTORIA E SHKOLLËS	Deri në çfarë mase ndikon historia e shkollës (e shkruara) në të tashmen dhe të ardhmen e shkollës?

©Steve Gruenert& Jerry Valentine, Middle Level Leadership Center, 2000; revised 2006



SI TË SHKRUAJMË SË BASHKU VIZIONIN, MISIONIN DHE VLERAT E SHKOLLËS DHE SI T'Ë PROMOVOJMË ATO?

Zhvillimi dhe komunikimi efektiv i një vizioni dhe misioni të fortë mund t'i ndihmojë shkollat në përpjekjet e tyre për t'u kuptuar më mirë nga palët e interesuara ose aktorët e ndryshëm (p.sh., mësuesit, prindërit, komuniteti i gjerë, etj.). Misioni dhe vizioni i shkollës ofrojnë bazën për politikën, rregulloret dhe praktikën e shkollës.

Misioni dhe vizioni i shkollës janë kategori dinamike. Me kalimin e kohës, ato do të duhet të rishikohen. Në këtë kontekst, gjatë seancës do të shikojmë procesin e rishikimit të misionit dhe vizionit si dhe burimet e nevojshme për zbatimin e këtij procesi.

VIZIONI:

Shkolla në të cilën i jetojmë/mishërojmë vlerat, ushqejmë mendimin kritik dhe, në partneritet me familjet dhe komunitetin, ndërtojmë një rrjet mbështetës për çdo fëmijë.

Vizioni është një kombinim i përgjigjeve të tri pyetjeve kryesore:

- Pse ekzistojmë - cili është qëllimi ynë themelor?
- Cilat janë aspiratat tona - çfarë duam të bëhemi?
- Cilat janë vlerat tona thelbësore, diçka që është e pandryshueshme?

Misioni ekziston për të arritur qëllimet e dëshiruara, për të përmbushur synimin dhe për të ruajtur vlerat thelbësore. Misioni i përgjigjet pyetjes SI?

Ne besojmë se roli i shkollës është të:	Ndaj ne:	Ne i bazojmë veprimet tona në vlerat e mëposhtme:

ANALIZA E MISIONIT SIPAS KRITEREVE “QPOQ/PPOA”

Kriteret	Hapi 1: Përgjigjia juaj	Vlerat e shkollës	Krahasojini përgjigjet tuaja për pyetjet e bëra nga kriteret dhe vlerat e shkollës. A përfaqësohen vlerat e shkollës tek përgjigjet?	Hapi 2: Cilat vlera të shkollës përfaqësohen në këtë kriter?
QËLLIMI	Cili është qëllimi kryesor i shkollës? Cili është fokusi i shkollës?	Shkruani 5 vlera të shkollës këtu: Për shembull: - Suksesi, kreativiteti, kureshtja, diversiteti dhe puna në ekip	Nëse përgjigjja është PO, shkoni në hapin 2. Nëse përgjigjja është JO, kthehuni tek hapi 1 dhe ripërcaktojini përgjigjen tuaj për pyetjen brenda secilit kriter në mënyrë që vlerat të shihen nga përgjigjja.	
POZICIONI	Cila është filozofia e shkollës? A përpiqet shkolla për inovacion, përsosmëri, pritshmëri të larta dhe qëllime ambicioze? A është shkolla reaguese dhe ka qëndrim pasiv ndaj inovacionit? A ka skepticizëm, inerci, cinizëm dhe frikë nga ndryshimi? A ka konsensus dhe kohezion në stafin mësimdhënës? SHËNIM: kushtojini vëmendje llojit të identifikuar të kulturës së shkollës.			
ORIENTIMI	Cili është orientimi i shkollës dhe karta kryesore e fortë e saj? A janë, për shembull, stafi mësimor i motivuar, infrastruktura, teknologjia e disponueshme, nxënësit e motivuar, partneritetet e cilësishë së lartë me familjet, një komunitet lokal stimules?			
QËNDRIMI NDAJ KOMUNITETIT	Si i trajton shkolla grupet kryesore të interesit? A është shkolla e ndjeshme ndaj problemeve që ekzistojnë në komunitetin lokal, p.sh., çështjet sociale, gjithëpërfshirja, ndotja e mjedisit, demokracia, etika, etj.?			

ANALIZA E VIZIONIT TË SHKOLLËS

SHEMBULL I ANALIZËS SË VIZIONIT TË SHKOLLËS ABC

Ideologjia kryesore		Vizioni i shkollës	
Vlerat kryesore	Qëllimi (arsyeja e ekzistencës/ raison d'être)	BHAG*	Një e ardhme e parashikuar
Bëhemi pionierë (suksesi)	Ushqejmë gëzimin e fëmijërisë dhe nxisim kureshtjen tek çdo fëmijë.	Bëhuni një shkollë që do t'i zgjerojë kufijtë dhe do të vendosë tendenca në praktikat gjithëpërfshirëse të shkollës.	Përshkrim i gjallë BHAG
Përpigemi për inovacion/risi në arsim(kreativiteti)			
Inkurajojmëkureshtjen dhe talentet tek fëmijët dhe stafi (kurioziteti)			
Ushqejmë dhe pranojmë diversitetin (diversiteti/gjithëpërfshirja)			
E ndërtojmë dhe e zhvillojmë shkollën së bashku (puna në ekip)			

ANALIZA E VIZIONIT TUAJ

Ideologjia kryesore		Vizioni i shkollës	
Vlerat kryesore	Qëllimi (arsyeja e ekzistencës/ raison d'être)	BHAG*	Një e ardhme e parashikuar

*BHAG është një koncept i zhvilluar në librin Built to Last. A BHAG (shqiptuar "Bee Hag," forma e shkurtër për "Big Hairy Audacious Goal") është një mënyrë e fuqishme për të nxitur suksesin. ABHAG është i qartë dhe bindës, ka nevojë për pak shprehje; njerëzit e kuptojnë menjëherë. <https://www.jimcollins.com/concepts/bhag.html>

STANDARDET E SHKOLLËS

Standardet e shkollës që promovojnë vlerat dhe të menduarit kritik janë një grup treguesish që tregojnë parakushtet për krijimin e një kulture dhe klime që inkurajon krijimin e komunitetit, kujdesin për çdo fëmijë, zhvillimin e partneriteteve me familjet dhe komunitetin dhe ndihmon shkollën të monitorojë zhvillimin e saj dhe të vendosë synime për përmirësim.

STANDARDET OSE PARIMET CILËSORE TË SHKOLLËS ZBATOHEN NË GJASHTË FUSHAT E MËPOSHTME:

1. Një mision, vizion dhe vlera të përbashkëta
2. Ndjesi e zhvilluar e sigurisë dhe përkatësisë
3. Një plan i qartë zhvillimi dhe rezultatet e dëshiruara
4. Partneritetet me familjet dhe komunitetin
5. Praktikë efektive e mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të mësuesve
6. Politikat, rregullat dhe procedurat e shkollës

1. NJË MISION, VIZION DHE VLERA TË PËRBASHKËTA

Shkolla ka një vizion, mision dhe vlera të qarta që njihen nga të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës dhe punon çdo ditë për t'i zbatuar/mishëruar këto vlera.

Shkolla ka një mision, vizion dhe vlera që përcaktojnë klimën dhe kulturën e shkollës:

- Në përcaktimin e vizionit, misionit dhe vlerave të shkollës kanë marrë pjesë mësues dhe punonjës të tjerë të shkollës, përfaqësues të nxënësve, prindërve dhe komunitetit.
- Të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës (prindërit, nxënësit, mësuesit dhe i gjithë stafi i shkollës), si edhe anëtarët e komunitetit më të gjerë janë të informuar dhe janë dakord me misionin, vizionin dhe vlerat e shkollës.
- Vlerat thelbësore, misioni dhe vizioni i shkollës janë të dukshme (të afishuara në shkollë, të postuara në faqen e shkollës, në njoftimet që u dërgohen prindërve, në aktivitetet e shkollës, etj.)
- Vlerat janë formuluar në mënyrë që ato të shërbejnë si bazë për zhvillimin e rregullave, politikave dhe procedurave të shkollës - shpjegohen përmes një sërë sjelljesh të dukshme dhe të matshme.
- Stafi, nxënësit dhe prindërit mund të identifikojnë vlerat thelbësore dhe të qartësojnë rëndësinë e tyre.
- Drejtuesit e shkollës dhe të gjithë mësuesit modelojnë, mësojnë dhe inkurajojnë sjellje që burojnë nga vlerat e përbashkëta.
- Mbështetja e nxënësve në zhvillimin e të menduarit kritik është pjesë integrale e vizionit, misionit dhe vlerave të një shkolle.

2. NDJESIA E SIGURISË DHE E PËRKATËSISË

Shkolla ushqen një klimë dhe kulturë që inkurajon zhvillimin e një komuniteti ku të gjithë ndihen të sigurtë, të pranuar dhe të respektuar. Shkolla punon në mënyrë aktive në zhvillimin e klimës dhe kulturës së shkollës përmes aktiviteteve të planifikuara me kujdes që përfshijnë të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës dhe komunitetit më të gjerë.

Shkolla siguron që të gjithë nxënësit në shkollë të ndihen të sigurtë dhe të mbështetur:

- Shkolla ka një protokoll për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe dhunës mes bashkëmoshatarëve dhe i informon dhe i udhëzon në mënyrën e duhur të gjithë nxënësit dhe prindërit, si edhe anëtarët përkatës të komunitetit lokal.
- Të gjithë mësuesit i njohin rregullat dhe procedurat, si edhe rolet e tyre në mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës fizike dhe verbale.
- Shkolla ka rregulla uniforme për trajtimin e fëmijëve dhe procedurat edukative që zbatohen. Ka procedura

uniforme në lidhje me zgjidhjen e problemeve të mundshme, duke mbajtur gjithmonë parasysh interesat më të mira të çdo fëmije.

- Mësuesit dhe nxënësit kanë mundësinë të mësojnë dhe praktikojnë aftësitë e nevojshme për zgjidhjen e konflikteve pa dhunë, ndërmjetësimin dhe kthimin, dhe të zhvillojnë qëndrueshmërinë.
- Rregullat që lidhen me sjelljen dhe sigurinë e fëmijëve përcaktohen në shkollë dhe shkruhen me një gjuhë të kuptueshme për nxënësit dhe prindërit.
- Në çdo tregues/shenjë të çfarëdo forme dhune, shkolla përgjigjet menjëherë, duke përfshirë nxënësit dhe prindërit në dialog dhe në zgjidhjen e problemeve.
- Nxënësit ndjejnë se të gjithë anëtarët e stafit të shkollës kujdesen për ta dhe se ata janë të lirë t'u drejtohen atyre për ndihmë ose për të zgjidhur problemet me të cilat përballen.

Shkolla ka zhvilluar protokolle reagimi në të gjitha rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes, nxitjen e dhunës etj..

- Rregullat dhe protokollet e shkollës përcaktojnë qartë sjelljet e papranueshme që lidhen me paragjykimet, gjuhën e urrejtjes, nxitjen e dhunës etj.
- Mësuesit, nxënësit dhe prindërit i njohin rregullat dhe protokollet dhe kanë mundësinë të diskutojnë mbi këto tema.
- Në përputhje me protokollet, shkolla i përgjigjet menjëherë çdo formë të nxitjes së dhunës apo gjuhës së urrejtjes.
- Shkolla i mëson nxënësit dhe prindërit mbi fenomene të ngjashme në rrjetet sociale dhe si të mbrohen nga ndikimet e ndryshme.

Shkolla i ndihmon nxënësit të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë ndaj komunitetit të shkollës në përputhje me vlerat që ajo promovon:

- Shkolla ka moton e saj, simbolet, kodin e trajtimit të ndërsjellë etj.
- Çdo nxënës shkolle ka mundësi të marrë pjesë dhe të përfshihet në mënyrë të barabartë në aktivitetet e shkollës
- Shkolla organizon aktivitete që i ndihmojnë nxënësit të njihen me njëri-tjetrin, të ndihmojnë njëri-tjetrin, të bashkëpunojnë në aktivitete të ndryshme dhe të kenë mundësi të mësojnë nga njëri-tjetri.
- Shkolla realizon takime dhe organizime për t'iu mundësuar nxënësve që së bashku të festojnë dhe të gëzohen për sukseset dhe arritjet e çdo nxënësi, grupi apo shkolle.

Nxënësit kanë një rol të përshtatshëm me zhvillimin e tyre në organizimin e aktiviteteve dhe marrjen e vendimeve:

- Nxënësit marrin pjesë në krijimin e normave dhe rregullave të sjelljes, organizimin e takimeve në shkollë dhe programet për zgjidhjen e konflikteve nëpërmjet këshillit të nxënësve dhe në mënyra të tjera.
- Mendimet dhe nevojat e nxënësve merren parasysh dhe mirëqenia e secilit fëmije është pikënisja në marrjen e të gjitha vendimeve

3. PLANI I ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS DHE REZULTATET E DËSHIRUARA

Shkolla ka një plan zhvillimi afatgjatë të bazuar tek misioni, vizioni dhe vlerat:

Plani i zhvillimit të shkollës i përgjigjet pyetjes - si do ta arrijmë vizionin dhe misionin që kemi vendosur dhe të promovojmë vlerat dhe të menduarit kritik:

- Plani i zhvillimit përmban një përcaktim të qartë të qëllimeve dhe detyrave të matshme
- Plani përmban rezultate të përcaktuara që mund të monitorohen
- Plani përmban role, përgjegjësi dhe afate kohore të përcaktuara qartë

Plani i zhvillimit të shkollës bazohet në analizën e situatës dhe prioritetet e identifikuara për përmirësim:

- Shkolla ka zhvilluar një metodologji dhe instrumente për analizimin e situatës në lidhje me standardet dhe

qëllimet e përcaktuara.

- Shkolla mbledh dhe analizon të gjitha të dhënat përkatëse që kanë të bëjnë me përparimin, sigurinë, sjelljen e nxënësve në përputhje me vlerat dhe të dhëna të tjera sasiore dhe cilësore në lidhje me prioritetet e identifikuar në fushën e klimës dhe kulturës së shkollës.
- Në analizën e gjendjes së shkollës përfshihen të gjithë mësuesit dhe përfaqësuesit e nxënësve dhe prindërve.

Shkolla i monitoron dhe i vlerëson në mënyrë të vazhdueshme arritjet e saj dhe i rishikon planet afatgjata dhe afatshkurtra në përputhje me to:

- Mësuesit, nxënësit dhe prindërit përfshihen në monitorimin dhe vlerësimin e punës së shkollës
- Mendimet e nxënësve dhe prindërve vlerësohen dhe merren parasysh gjatë përcaktimit të qëllimeve
- Shkolla i informon mësuesit, prindërit dhe nxënësit dhe komunitetin lokal për rezultatet e vlerësimit

4. PARTNERITETI ME FAMILJET DHE KOMUNITETIN

Prindërit, anëtarët e komunitetit dhe profesionistë të ndryshëm kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të sigurt për fëmijët, përvetësimin e njohurive dhe aftësive, zhvillimin e një klime të mirë dhe një kulture të bazuar në vlera. Shkolla zhvillon partneritete me familjet dhe komunitetin për të siguruar një mjedis të sigurt për çdo fëmijë.

Drejtoria e shkollës krijon dhe zbaton një plan për zhvillimin e partneriteteve me familjet dhe komunitetin, i cili përfshin kanale komunikimi efektiv, mbështetje për familjet dhe fëmijët, përfshirjen e prindërve në vendimmarrje dhe përfshirjen e familjeve në aktivitetet brenda dhe jashtë shkollës.

- Prindërit dhe stafi i shkollës zhvillojnë një marrëdhënie besimi dhe respekti reciprok
- Prindërit, anëtarët e komunitetit dhe të ftuarit ndihen të mirëpritur në shkollë dhe shkolla ofron hapësirë për prindërit dhe forma të ndryshme të komunikimit të rregullt
- Prindërit përfshihen në marrjen e vendimeve të përshtatshme nëpërmjet Këshillit të Prindërve dhe në mënyra të tjera
- Prindërit janë burim njohurish dhe kapacitetet e tyre përdoren për të mbështetur të mësuarit e nxënësve, mësuesve dhe prindërve të tjerë

Shkolla përdor burime komunitare institucionale (shërbime, institucione kulturore) dhe jointucionale (OJQ) për një punë më të mirë të shkollës dhe përkujdesje më të mirë ndaj fëmijëve:

- Shkolla punon ngushtë me të gjitha institucionet publike (policinë, qendrat e punës sociale, institucionet e kujdesit shëndetësor) për të parandaluar çdo formë dhune apo ndikim tek fëmijët dhe për t'i mbrojtur ata nga të gjitha rreziqet.
- Shkolla bashkëpunon me institucione të tjera arsimore duke u mundësuar fëmijëve të njihen me njëri-tjetrin, të bëjnë miq dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin.
- Shkolla bashkëpunon me institucione kulturore, fetare dhe institucione të tjera për t'u ofruar fëmijëve mundësi të ndryshme për të mësuar, për shërbime, për vullnetarizëm, etj..
- Shkolla përdor burimet e komunitetit dhe kapacitetet e prindërve për të organizuar aktivitete që promovojnë vlerat dhe të menduarit kritik

5. PROCESI MËSIMOR DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I PUNONJËSVE

Mësuesit punojnë si një ekip, inicijojnë dhe marrin pjesë në aktivitete të ndryshme që kontribuojnë në zhvillimin e klimës dhe kulturës së shkollës dhe vazhdimisht punojnë për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor.

Mësuesit punojnë si një ekip dhe e mbështesin njëri-tjetrin:

- Mësuesit kanë vlera të përbashkëta dhe bien dakord për to
- Mësuesit ndihen të mbështetur në përpjekjet e tyre për të rinovuar dhe përmirësuar praktikën e tyre

- Mësuesit ndihen të mbështetur në përpjekjet e tyre për të përditësuar dhe përmirësuar praktikën e tyre
- Mësuesit përdorin mundësi formale dhe joformale për të diskutuar lirshëm barrierat ekzistuese në mësimdhënie dhe mënyrat për t'i kapërcyer ato
- Mësuesit mendojnë se procesi i vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm është i drejtë dhe i rëndësishëm për zhvillimin e tyre
- Mësuesit besojnë se mjedisi i punës është pozitiv dhe se kolegët e tyre janë mbështetës dhe të kujdesshëm

Procesi i mësimdhënies integron mësimdhënien e vlerave dhe të menduarit kritik:

- Mësuesit përdorin metoda dhe strategji për të inkurajuar të menduarit kritik, i lejojnë fëmijët të bëjnë pyetje, të eksplorojnë, të diskutojnë, të nxjerrin përfundime dhe të bëjnë gabime pa pasur frikë
- Mësuesit përdorin një sërë mundësish për t'iu mësuar fëmijëve vlerat dhe për t'i aftësuar ata të kuptojnë dhe të jetojnë sipas situatave të përditshme
- Mësuesit inkurajojnë diskutime dhe debate rreth pikëpyetjeve për vlerat, duke përdorur të menduarit kritik
- Mësuesit dhe fëmijët miratojnë rregullat dhe procedurat e klasës në lidhje me zgjidhjen e problemeve
- Mësuesit sigurojnë që fëmijët të mësojnë në një klimë që u lejon atyre të ndihen të pranuar, të sigurtë dhe kompetentë

Mësuesit i zhvillojnë vazhdimisht kompetencat e tyre:

- Plani i zhvillimit profesional të mësuesve është krijuar në përputhje me qëllimet e shkollës dhe të mësuesve
- Mësuesit formojnë një komunitet të nxëni të mbështetur nga drejtuesit e shkollës
- Mësuesit punojnë së bashku për zhvillimin e treguesve të cilësisë në lidhje me vizionin e shkollës
- Mësuesit menaxhojnë një portofol profesional dhe zhvillojnë një plan vjetor për zhvillimin e tyre profesional
- Mësuesit janë të vetëdijshëm për pikat e tyre të forta dhe pikat e dobëta profesionale
- Cilësia e procesit mësimor përmirësohet si rezultat i zhvillimit profesional të mësuesve
- Cilësia e zhvillimit profesional ndikon në motivimin dhe entuziazmin e mësuesve

6. RREGULORET/RREGULLAT DHE PROCEDURAT

Rregulloret dhe procedurat e shkollës sigurojnë sigurinë dhe mirëqenien e çdo fëmije dhe përcaktojnë rregulla dhe pritshmëri të qarta për të gjithë anëtarët e komunitetit:

- Rregulloret e shkollës përcaktohen në përputhje me vlerat dhe ofrojnë bazën për ndryshimin e veprimeve dhe sjelljeve
- Rregulloret e shkollës hartohen me pjesëmarrje dhe në konsultim me të gjithë anëtarët e komunitetit
- Rregulloret e shkollës përmbajnë gjithashtu udhëzime të qarta se si shkolla inkurajon dhe promovon vlerat mes fëmijëve, duke përfshirë shembuj të sjelljeve pozitive dhe mënyra për të zgjidhur problemet.
- Të gjithë nxënësit dhe prindërit prezantohen me rregullat e shkollës në mënyrë të kuptueshme dhe të përshtatshme
- Edukimi me pasoja logjike janë bazë për zbatimin e rregullores së shkollës
- Rregullorja e shkollës përmban një kod etike dhe protokoll për rastet e dhunës ndaj fëmijëve, si edhe të gjitha format e diskriminimit, neglizhencës etj.
- Kodi i sjelljes në shkollë pasqyrohet në rregullat e klasës
- Fëmijët kanë mundësinë të mësojnë se si t'i ndjekin rregullat, pse dhe çfarë të bëjnë në rast të shkeljes së rregullave



MODULI 3: PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE DHE SI TË KRIJOJMË PARTNERITETIN ME FAMILJET DHE KOMUNITETIN

Moduli i Partneritetit të shkollës me familjet dhe komunitetin synon të lidhë pjesën teorike me atë praktike, të motivojë sa më shumë mësues, drejtues, pedagogë, prindër dhe të gjithë ata që përfshihen në punën edukative të ndërtojnë në shkollat e tyre, sipas vizionit të tyre, “partneritetin e vet”, i cili nuk është dhe nuk mund të jetë universal. Çdo shkollë është unike dhe një burim i praktikave të mira e cilësore, të cilat mund të jenë shtysa të ndryshimit.

Një nga qëllimet kryesore të procesit të përmirësimit të shkollës është zhvillimi i partneriteteve me familjet dhe komunitetet dhe i aktiviteteve për fëmijët me status socio-ekonomik më të ulët. Qëllimi i modulit është të fuqizojë ekipet e shkollave të zhvillojnë një plan afatgjatë dhe operacional për të përmirësuar partneritetet në fusha të ndryshme - vendimmarrje, vullnetarizëm, mbështetje për nxënësit, etj. Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat në komunitet është një hap i rëndësishëm për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve dhe mundësitë për të krijuar njohje, për t’u zhvilluar dhe për të mësuar.

PËRMBAJTJA E MODULIT

- Analiza e formave ekzistuese të bashkëpunimit me familjet dhe komunitetin - sfidat dhe nevojat e shkollave
- Udhëzime për krijimin e partneriteteve me prindërit dhe komunitetin që synojnë promovimin e vlerave të shkollës
- Shembuj të modeleve të bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin
- Udhëzime për zhvillimin e aktiviteteve me familjet dhe komunitetet
- Shembuj të aktiviteteve me prindërit, duke përfshirë strategji pune që mund të realizohen edhe nga mësuesit
- Udhëzime për prezantimin e një plani pune me prindërit dhe komunitetin
- Udhëzime për krijimin e ndjesisë së përkatësisë në shkollë dhe promovimin e vlerave tek prindërit

REZULTATET/STANDARDET E MODULIT

- Shkolla zhvillon partneritete me familjet dhe komunitetin për të ofruar një mjedis të sigurt për çdo fëmijë:
- Drejtuesit e shkollës krijojnë dhe zbatojnë një plan për të zhvilluar partneritete me familjet dhe komunitetin, i cili përfshin kanale efektive komunikimi, mbështetje për familjet dhe fëmijët, përfshirjen e prindërve në vendimmarrje dhe përfshirjen e familjes në aktivitetet brenda dhe jashtë shkollës
 - Prindërit dhe stafi i shkollës zhvillojnë një marrëdhënie besimi dhe respekti reciprok
 - Prindërit, anëtarë të tjerë të komunitetit dhe të ftuar ndihen të mirëpritur në shkollë, përfshihen në aktivitetet e shkollës dhe në marrjen e vendimeve të përshtatshme
 - Shkolla përdor burimet institucionale (shërbime, institucionet kulturore) dhe jo institucionale (OJQ) të komunitetit për të përmirësuar punën në shkollë dhe procesin e mësimdhënies e mësimnxënies
 - Shkolla përdor burimet e komunitetit dhe kapacitetet prindërore për të organizuar aktivitete që promovojnë vlerat dhe të menduarit kritik

DETYRAT E SHKOLLËS PAS MODULIT

- Të krijojë një plan shkolle për zhvillimin e partneritetit mes familjeve dhe komunitetit, duke marrë parasysh problemet e përbashkëta dhe ato të veçanta në përputhje me vlerat e shkollës.
- Të gjejë mënyra për të motivuar prindërit dhe komunitetin për pjesëmarrje më aktive në punën e shkollës.
- Të hartojë strategji të ndryshme për komunikimin me prindërit dhe komunitetin - nëpërmjet e-mail-it, telefonit, letrës ose broshurës informuese të shkollës, diskutimeve në grup, takimeve në grup, workshopeve, Këshillit të Prindërve, etj..
- Të organizojë takime për të prezantuar planin e punës me prindërit dhe komunitetin
- Të zbatojë të paktën një aktivitet me familjet dhe komunitetet

ZHVILLIMI I PARTNERITETEVE FAMILJE, SHKOLLË DHE KOMUNITET

Muamer Tinjak

Kur flasim për familjen moderne, duhet të kemi parasysh se ajo ka role të shumëfishta. Më shpesh përmenden rolet riprodhuese, edukative, mbrojtëse, ekonomike dhe të tjera. Marrëdhëniet ndërpersonale, ndërveprimi, mbështetja nga anëtarët e familjes dhe komunikimi po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe ndikojnë në përfshirjen e familjes në komunitet. Familja u siguron fëmijëve mbrojtje, përmbushjen e nevojave emocionale, lidhjet, afërsinë dhe mbështetjen në përparimin personal dhe profesional. Në të njëjtën kohë, ajo i mundëson fëmijës të lidhet me komunitetin shoqëror dhe kulturën. Ajo i mëson fëmijës të kuptojë botën përreth tij/saj dhe si ta mbrojë dhe të kujdeset për të. Prindërit kanë një rol të pazëvendësueshëm dhe specifik në procesin e socializimit të fëmijës së tyre (Todoroviq, J., 2004: 55). Prindërimi duhet të mundësojë socializim cilësor, i cili bazohet në lidhjen e ngushtë me fëmijën, por edhe në autoritetin prindëror.

Familja duhet të jetë një mbështetje e fortë për fëmijën dhe të stimulojë zhvillimin e tij/saj të pavarur dhe të gjithanshëm, të sigurojë parakushtet dhe bazën për personalitetin e shëndoshë të fëmijës. Rritja dhe zhvillimi i fëmijës shoqërohet me sjellje që mbartin sfida të ndryshme. Të qenit i rritur dhe nevoja për pavarësi, shpesh e shtyjnë fëmijën të eksperimentojë me diçka që prindërit nuk janë dakord ose diçka që ata nuk e lejojnë. Në procesin e rritjes, ekziston një nevojë e vazhdueshme për të provuar role të ndryshme dhe për të ndryshuar sistemin e vlerave. Kurioziteti dhe agresiviteti shtohen dhe ka gjithmonë një përqindje të caktuar rreziku që të rinjtë ndonjëherë e gjejnë gabim. Kokëfortësia shpesh e pranishme manifestohet kryesisht si nevojë për të mbrojtur identitetin dhe pavarësinë e tyre (Todorović, 2004). Fëmijët nga familjet jo të plota dhe jofunksionale, fëmijët me sëmundje kronike ose me aftësi të kufizuara fizike janë më të cenueshëm ndaj rritjes së rrezikut.

Prindërit, si edukatorët e parë, pritet të kuptojnë vështirësitë në rrugën e zhvillimit të vendosmërisë, këmbënguljes, por edhe dashurisë së madhe për fëmijët. Suksesi i çdo marrëdhënieje është si rezultat i ndërveprimit, tek i cili mbështetet komunikimi i suksesshëm dhe stimulues që është i nevojshëm në procesin edukues si për prindërit ashtu edhe për fëmijët. Pete dhe Andrews (2006) gjetën prova të qëndrueshme të qarta dhe bindëse për sa vijon: “Anëtarët e familjes kanë një ndikim kryesor në suksesin e fëmijës në shkollë dhe arritjet në jetë. Kur shkolla, anëtarët e familjes dhe shoqëria i inkurajojnë fëmijët të mësojnë së bashku, ata janë më të mirë në shkollë, e vazhdojnë shkollën dhe e pëlqejnë atë më shumë.” (Dawn T. etj. 2011: 42)

Përfshirja aktive e prindërve në aspekte të ndryshme të jetës së shkollës është një komponent i rëndësishëm i procesit arsimor dhe lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e tij. Një fëmijë i lumtur dhe i kënaqur është interesi më i rëndësishëm i familjes dhe shkollës, parakushti për këtë është bashkëpunimi cilësor mes tyre. Faktorët e brendshëm që ndikojnë në suksesin dhe përfshirjen cilësore të nxënësve në sistemin shkollor përfshijnë të gjitha karakteristikat që nxënësi sjell në procesin arsimor dhe që mund të lidhen me arritjet shkollë, përkatësisht: aftësitë intelektuale, motivimi dhe vetëvlerësimi, qëndrimet personale, sistemi i vlerave të vetë nxënësit, pritshmëritë, njohuritë e mëparshme dhe përvojat e fituara. Përveç karakteristikave personale të nxënësit, arritjet në shkollë mund të ndikohen edhe nga faktorë të jashtëm. Më të rëndësishmit janë mjedisi familjar dhe kushtet e shkollës (Polovina, N., Bogunović, B., 2007: 424).

Sipas Henderson etj. (2007), ekzistojnë katër besime themelore të mësuesve që duhet të jenë baza për përfshirjen e familjes në kurrikullat e shkollës: “Mësuesit duhet të besojnë se të gjithë prindërit kanë ëndrra për fëmijët e tyre dhe jetën e tyre dhe u dëshirojnë atyre më të mirat; mësuesit duhet të besojnë se të gjithë prindërit kanë kapacitetin të mbështesin fëmijët e tyre të mësojnë; prindërit dhe stafi i shkollës duhet të jenë partnerë të barabartë; Përgjegjësia kryesore për ndërtimin e një partneriteti mes shkollës dhe familjes qëndron kryesisht tek stafi i shkollës” (Dawn T., etj, 2011: 42).

Sa më herët të përfshihen prindërit në edukimin/arsimimin e fëmijëve të tyre, aq më të mëdha janë efektet e kësaj përfshirjeje. Henderson dhe Mapp (2002) në rishikimin e tyre të rezultateve të kërkimit e konfirmuan këtë tezë. Ata argumentojnë se programet e edukimit të fëmijërisë së hershme, në të cilat prindërit janë të trajnuar

në mënyrë specifike për të punuar me fëmijët e tyre në shtëpi, kanë një efekt pozitiv edhe më të rëndësishëm në arritjet e atyre fëmijëve. Ky sukses lidhet drejtpërdrejt me kohëzgjatjen e trajnimeve për prindërit, ku përfshihet edukimi i prindërve në fushën e prindërimit, si dhe forcimi i kompetencave prindërore për të ndihmuar dhe mbështetur në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre. Kjo vërteton faktin se përfshirja e prindërve përmes roleve të ndryshme në jetën dhe punën e shkollës kontribuon në rezultate dhe përparim më të mirë të fëmijëve. Është e rëndësishme të shihet prindi si një partner që duhet të marrë pjesë në edukimin dhe arsimimin e fëmijës si një ent që ndihmon në këtë proces. Shkolla duhet të tregojë gadishmëri për të bashkëpunuar dhe trajtuar së bashku të gjitha çështjet për të arritur përparimin dhe suksesin e fëmijës.

Analiza e sistemit të edukimit institucional tregon një numër të pamjaftueshëm të programeve që lidhen me familjen dhe prindërimin e përgjegjshëm. Mungojnë gjithashtu programet e duhura në të cilat mësuesit do të mbështesnin zhvillimin e kompetencave prindërore për të arritur një partneritet cilësor ndërmjet familjes dhe shkollës. Këmbëngulja për marrëdhënie më të thella partneriteti, të cilat janë të detyrueshme në të njëjtën kohë, nënkupton mbështetje dhe një koncept e strategji të përcaktuar qartë të sistemit arsimor.

Familja moderne ka një rol pak më ndryshe dhe po kalon ndryshimet e veta që dikur ishin në formë krizash. Disa forma të krizës familjare janë: rritja e numrit të divorceve, shtimi i dhunës në familje, ulja e interesit për përfshirjen sociale, kërkimi i formave të reja dhe më novatore të martesës dhe familjes dhe sindroma e re kulturore që të qenit i pavarur do të thotë të jesh i vetë-mjaftueshëm/i vetëkënaqur dhe i pavarur. Të gjithë faktorët e përmendur përcaktojnë cilësinë e marrëdhënieve mes familjes dhe shkollës. Partneriteti familje-shkollë nënkupton ekzistencën e marrëdhënieve të shëndetshme familjare si parakusht për të gjitha marrëdhëniet shoqërore që lidhen me familjen dhe shkollën. Nuk ka asnjë model apo recetë ideale për një partneritet cilësor familje-shkollë. (Albright, M. I. dhe Weissberg, R. P., 2010: 247) Familja e sigurt krijon një mjedis të favorshëm për një marrëdhënie të mirë bashkëpunimi. Megjithatë, në kushtet e rënies së niveleve të sigurisë familjare, lumturisë, kënaqësisë dhe besimit, krijohet një kontekst negativ për zhvillimin dhe funksionimin e partneriteteve.

Sipas autorit McDermott (2008), advokuesit e parë të përfshirjes efektive të prindërve janë kryesisht edukatorët dhe bashkëpunëtorët profesionistë në kopshte dhe mësuesit në institucionet e arsimit special, të cilët e kanë kuptuar rëndësinë e investimit të përpjekjeve të tyre dhe ofrimit të mbështetjes së prindërve për mirëqenien e fëmijëve. Grupi i dytë i përkrahësve përbëhet nga organizata qeveritare dhe profesionale. Në udhëzuesit e tyre të përfshirjes së prindërve, ata theksojnë të mësuarit e të rriturve dhe komunikimin e dyanshëm me vendimmarrjen. Megjithatë, ata ende vazhdojnë ta përshkruajnë të mësuarit në aspektin e të mësuarit nga prindërit për fëmijët dhe shkollën për të mbështetur shkollën (McDermott, 2008: 5). Privilegjet më të mëdha të fëmijës dhe ushtrimi i të drejtave ka çuar në kërkesa dhe iniciativa më të mëdha të prindërve për të marrë pjesë, që do të thotë, për të zhvilluar një partneritet. Kjo marrëdhënie ndryshon jo vetëm shtrirjen, por edhe cilësinë e ndërveprimeve që çojnë në lidhje dhe marrëdhënie emocionale më të mëdha dhe më thelbësore. Prindërve iu është dhënë një rol i ri - nga një pjesëmarrës pasiv, roli i të cilit bazohej në informimin për suksesin dhe sjelljen e fëmijës, në një rol aktiv të një animatori, vullnetari dhe edukatori.

Si rrjedhojë, institucioneve arsimore iu dha një detyrë e re dhe një rol shumë i rëndësishëm për sa i përket edukimit të prindërve për të arritur edukimin, orientimin, inovacionin, komunikimin dhe bashkëpunimin e duhur. Kështu, në vend të nocionit të bashkëpunimit, nomenklatura e kësaj marrëdhënieje ka ndryshuar gjatë historisë, ndaj nocioni i bashkëpunimit është zëvendësuar me nocionin e partneritetit. Kjo mënyrë e përfshirjes së prindërve në jetën e shkollës është mbrojtur nga një grup i tretë teoricienësh dhe praktikuesish, të cilët, kohët e fundit, kanë mbrojtur zgjerimin e kufijve të përfshirjes së prindërve. Ata theksojnë se “mësuesit duhet të përpiqen t’i njohin dhe t’i kuptojnë prindërit dhe kontekstin e tyre socio-kulturor. Ata, gjithashtu, duhet të përpiqen të mësojnë nga prindërit” (McDermott, 2008: 11).

Ndryshimi i madh në përfshirjen e prindërve, ku prindërve u jepet një rol aktiv në jetën dhe punën e shkollës, buron nga ky grup advokuesish/përkrahësish. Ata e zhvendosin vëmendjen nga familja te mësuesit. Prindërit tani shihen si individë dhe jo thjesht si zbatues të rekomandimeve të shkollës. Ndoshta dikur mjaftonte që prindërit e nxënësve të vinin vetëm në konferencat dhe takimet e mësuesve me prindër. Kjo ndodhte më shpesh në klasat e ulëta të shkollës 9-vjeçare (nga klasa e parë deri në të katërtën), ndërsa në klasat e larta mendohej se nuk ishte e nevojshme të vinin prindërit as në takimet informuese me prindër, ose kjo bëhej nga prindërit e nxënësve me rezultate të shkëlqyera dhe sjellje shembullore.

Në të njëjtën kohë, mungonte prania e prindërve të nxënësve me sukses më të ulët në mësim dhe sjellje. Në shoqërinë moderne, ku të dy prindërit punojnë dhe nuk kanë kohë për t'iu kushtuar fëmijëve të tyre, detyra e shkollës është të eksplorojë dhe të ofrojë modele dhe forma të reja përfshirjeje të pranueshme nga prindërit, në mënyrë që ata të jenë më të pranishëm në shkollë dhe në jetën dhe detyrat e fëmijëve të tyre. Modelet e reja që mund të ofrohen janë pikërisht rolet e reja të prindërve. Tani niveli i bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes përmes konferencave dhe takimeve prindër-mësues do të kalojë në nivelin e partneritetit midis familjes dhe shkollës nëpërmjet vullnetarizmit, edukimit, workshopeve, mbështetjes dhe ndihmës për shkollën përmes veprimtarive humanitare, krijimit të një këndi për prindërit, etj..




Figura 2.1. Pamje e përgjithshme e rolit të prindërve në shkollat ku ka partneritet

Përfshirja aktive e prindërve në format e reja të partneritetit me shkollën (prindër, edukatorë, vullnetarë, pedagogë, këshilltarë profesionistë, ndihmës në mësimdhënie, pjesëmarrës në workshope/seminare, forume, leksione, autorë dhe bashkëautorë në hartimin e udhëzuesve, broshurave, etj.), i inkurajon dhe i orienton prindërit drejt një qëndrimi më serioz ndaj detyrimeve që u ngarkon arsimimi i fëmijëve. Ai përfundimisht ndikon në përmirësimin e marrëdhënies familje-shkollë, e cila rezulton të ketë kaluar nga niveli i bashkëpunimit në nivelin e partneritetit. Është e nevojshme që prindërve t'u mundësohet të marrin pjesë aktive në të gjitha aspektet e funksionimit të shkollës, që do të thotë, është e nevojshme që ata të pranohen dhe të përfshihen si anëtarë të barabartë të ekipit në institucion. Për të arritur këtë duhet punuar në zhvillimin e kompetencave pedagogjike të mësuesve. Autori Benson (2006) thekson: "Zhvillimi i ekipit kërkon njohuri më të thella në mësimin e të rriturve, por edhe kompetenca pedagogjike të edukatorëve/mësuesve, në mënyrë që prindërit të mund të përfshihen vërtet, jo vetëm zyrtarisht, të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të përmirësojnë realisht personalitetin dhe aftësitë e tyre prindërore" Benson, 2006: 286).

Përmirësimi i punës pedagogjike të shkollës është një proces afatgjatë ku të gjithë punonjësit duhet të punojnë së bashku dhe vetëm atëherë mund të pritet ndryshimi i dëshiruar. Kështu do të vijmë në një shkollë ku të gjithë fëmijët do të kenë të drejtën e arsimimit dhe trajnimit cilësor dhe ku mësimdhënia dhe procesi mësimor do të përshtaten me nevojat dhe aftësitë e nxënësve. Në kuadër të reformave në arsim, ka pasur përpjekje të ndryshme, të cilat kanë sjellë ndryshime, por nuk ka pasur ende ndryshime thelbësore.

Është e nevojshme përfshirja e të gjithë pjesëmarrësve në procesin arsimor, në proceset e reformës (nga përfaqësuesit e ministrive deri te zbatuesit e procesit mësimor, profesorët, mësuesit dhe prindërit). Vetëm kur të gjithë të jenë të përfshirë në vendimmarrje do të jetë e mundur të bëhen ndryshime. Nëse vendimet merren në nivel ministrish dhe zbatohen në shkolla, zbatimi i tyre do të jetë i vështirë, sepse ai përfshin një sistem imponimi. Sistemi i pranimit nëpërmjet vendimmarrjes së përbashkët dhe zbatimit të tyre është shumë më efikas.




Figura 2.2. Pamje e përgjithshme e faktorëve kryesorë të shkollave cilësore

Figura 2.2 tregon faktorët kryesorë të një shkolle cilësore. Nxënësit janë në qendër të procesit arsimor - ata janë subjekti i edukimit/arsimit. Në shkollë duhet të sigurohet një mjedis cilësor mësimor për ta në mënyrë që procesi mësimor të ecë sipas planit të planifikuar. Që proceset dhe mjedisi të jenë cilësorë, mësuesit dhe prindërit duhet të jenë të përfshirë dhe të bashkuar. Me ndihmën e komunitetit social dhe autoriteteve arsimore ata do të punojnë për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës, jetesës dhe të të nxënës.

Autorët Gossen D. dhe Anderson J. (1996), në librin Krijimi i kushteve për shkolla cilësore, deklarojnë se në procesin e zbatimit të ndryshimeve në shkollë, punonjësit duhet t'i plotësojnë nevojat e tyre në çdo fazë. Fazat e zhvillimit të procesit të ndryshimit janë: ndryshimi kognitiv, ndryshimi personal, ndryshimi i sistemit, ndryshimi i kulturës, ndryshimi i programit dhe ndryshimi i vazhdueshëm. Këto faza janë të ndërlydhura dhe përfaqësojnë një model që është në përputhje me teorinë e kontrollit, sepse e përqëndron vëmendjen në krijimin e një mjedisi në të cilin njerëzit mund të plotësojnë nevojat e tyre, ndërkohë që kalojnë nëpër faza të ndryshme shqetësimi (Gossen D., dhe Anderson J., 1996: 24).

Zhvillimi i partneriteteve kërkon aktivitete të reja, të cilave mësuesit ndonjëherë u rezistojnë për një sërë arsyes. Herë është frika nga e panjohura (A do të mund ta bëj?), herë mungesa e disa aftësive, shkathtësive e përvojave, herë janë arsye subjektive e herë objektive. Megjithatë, gjatë zhvillimit të partneritetit, është e nevojshme të kalohen të gjitha ndryshimet e mësipërme. Nuk është gjithmonë e thjeshtë, ndonjëherë jo të gjithë aktorët janë të gatshëm t'i zbatojnë ato dhe është e vështirë pa përfshirjen e të gjithëve.

FORCIMI I KOMPETENCAVE PËR BASHKËPUNIMIN ME PRINDËRIT

Në marrëdhëniet mes familjes dhe shkollës, komunikimi është një nga faktorët më të rëndësishëm vendimtarë të edukimit dhe arsimimit në familje dhe në shkollë.

Cilësia e marrëdhënieve dhe cilësia e komunikimit përcaktojnë drejtimin dhe ecurinë e mëtejshme, e cila krijon themelet për përvetësimin e mëtejshëm të njohurive në nivelin akademik. Marrëdhëniet komplekse brenda këtij koncepti të organizuar në mënyrë hierarkike të përgjegjësive dhe roli i padiskutueshëm i të gjithë faktorëve që çojnë në kompleksitetin dhe individualitetin e fenomenit imponojnë sfida të shumta profesionale dhe kërkojnë që studiuesit t'iu përgjigjen shumë pyetjeve. Fokusi është në përpjekjen për të përmirësuar bashkëpunimin familje-shkollë, duke ndërtuar partneritete midis mësuesve dhe prindërve të nxënësve. Kjo nënkupton veprim të përbashkët arsimor, të planifikuar dhe të orientuar drejt një qëllimi, të të dy faktorëve më të rëndësishëm të këtij procesi - prindërve dhe mësuesve.

Janë kryer studime të shumta që ilustrojnë qëndrimet e ndryshme dhe arsyet e mundshme të keqkuptimeve në marrëdhënien mësues-prind ose në përgjithësi në marrëdhënien familje-shkollë. Rezultatet tregojnë qartë nevojën për një qasje më serioze në rritjen dhe zhvillimin e këtyre marrëdhënieve.

Marrëdhëniet midis familjes dhe shkollës bazohen në njohuritë e teorisë moderne pedagogjike dhe praktikës, bashkëpunimi i të cilave ndikon në cilësinë e socializimit që kalojnë të rinjtë që në moshë të re dhe që i përcaktojnë ata në masë të madhe. Në kushtet moderne, familja dhe shkolla kanë pothuajse të njëjtën rëndësi dhe rol në socializim, por kjo nuk i bën ata automatikisht bashkëpunëtorë apo kundërshtarë të mirë në këtë proces. Marrëdhëniet e faktorëve më përgjegjës në familje (prindërit, kujdestarët dhe të afërmit e tjerë me ndikim) me faktorët më përgjegjës në shkollë (mësuesit, bashkëpunëtorët profesionistë, bashkëpunëtorët mësimdhënës, drejtuesit e shkollës) nënkuptojnë strategjinë dhe respektin reciprok, si edhe respektimin e autonomisë të secilit prej pjesëmarrësve. Faktorët që përcaktojnë në masë të madhe cilësinë e këtyre marrëdhënieve kanë gjithashtu një ndikim të rëndësishëm, përkatësisht karakteristikat individuale të mësuesve dhe prindërve, faktorët specifikë të familjes dhe shkollës dhe ndikimet sociale. Të gjithë faktorët e përmendur veprojnë në mënyrë sinergjike dhe përcaktojnë në mënyrë domethënëse rrjedhën dhe cilësinë e këtyre marrëdhënieve.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh ndikimin e mjedisit në të cilin proceset e tranzicionit sjellin rreziqe në të gjitha nivelet e veprimit shoqëror. Punimi në mënyrë indirekte vë në dukje rreziqet që reflektohen në këtë marrëdhënie përsa i përket ndikimit të tranzicionit të ngadaltë ekonomik dhe politik dhe procesit të transformimit të sistemit arsimor. Ne jetojmë në një kohë ndryshimesh të shpejta dhe të vazhdueshme në të gjitha fushat, në një kohë kur njohuritë e reja përmirësohen dhe plotësohen vazhdimisht. Në këtë drejtim, partneriteti i familjes dhe shkollës, si një marrëdhënie e gjallë, kërkon përparim dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Marrëdhënia mes familjes dhe shkollës kërkon një model të ri, të përmirësuar bashkëpunimi që mund të plotësojë kërkesat e sistemeve moderne arsimore. Edukimi i pjesëmarrësve në këto marrëdhënie imponohet si një drejtim i detyrueshëm i vizionit të arsimit. Ai presupozon dhe inkurajon promovimin e një sistemi të ri vlerash dhe stili jetese që do të përfshinte brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, duke zhvilluar ndërgjegjësimin për rëndësinë e partneriteteve të mira në të gjitha sferat e shoqërisë.

Partneriteti i mirë është i domosdoshëm, sepse një fëmijë i moshës shkollë zhvillohet në ndërveprimin e faktorëve të ndryshëm. Siç e kemi përmendur tashmë, familja dhe shkolla janë faktorët më të rëndësishëm. Megjithatë, në mungesë të bashkëpunimit cilësor, ndikimi pozitiv dobësohet dhe nuk jep rezultatet e pritura që lidhen drejtpërdrejt me procesin arsimor. Rezultatet e pritura do të mungojnë veçanërisht nëse këto pikëpamje kundërshtohen dhe nëse nuk ka bashkëpunim dhe komunikim të mirë ndërmjet faktorëve të përmendur. Prandaj, është e nevojshme që familja dhe shkolla të veprojnë në mënyrë të koordinuar - jo që njëri nga pjesëmarrësit të ketë përparësi apo autonomi të pavarur. Tendanca është që ky lloj partneriteti të zhvillohet dhe të degëzohet në një sërë formash të ndryshme. Duhet të ngrihet në nivelin e ndihmës reciproke dhe të veprimit konsensual për zgjidhjen e çështjeve të shumta dhe specifike në fushën e politikave arsimore.

Partneriteti ndërmjet familjes dhe shkollës ndihmon në përmirësimin e programeve shkollë, siguron një klimë të mirë sociale në shkollë, ofron ndihmë dhe mbështetje për familjen, rrit nivelin e socializimit, përmirëson

njohuritë dhe aftësitë e prindërve, lidh prindërit me punonjësit e shkollës dhe kështu vendos lidhje të reja shoqërore. Partnerët njohin efektet pozitive, njohin interesat dhe përgjegjësitë e përbashkëta kur bëhet fjalë për fëmijët dhe kështu punojnë së bashku për të ofruar kushtet më të mira të mundshme arsimore dhe mundësitë për të mësuar. Modeli i partneritetit modern e vendos nxënësin në qendër të interesit. Kërkimet dhe shembujt e fushës ndërdisiplinore të partneritetit familje-shkollë kanë një bazë - kujdesin ndaj fëmijëve, që është qëllimi ynë i përbashkët dhe i vetëm.

Ne jemi munduar t'i paraqesim në mënyra të ndryshme të gjitha arritjet dhe shembujt e praktikës së mirë të bashkëpunimit me prindërit. Ato do të shërbejnë si shembuj të aktiviteteve që kanë kontribuar në përmirësimin e cilësisë edukative të punës dhe arsimit në përgjithësi. Ne besojmë se suksesi dhe rezultatet e arritura në këtë fushë do të jenë një nxitje për të tjerët që të zbatojnë shembujt të tillë të praktikës së mirë në shkollat e tyre.

IDE DHE AKTIVITETE – SI TË KRIJOJMË NJË PARTNERITET TË SHKOLLËS ME FAMILJET DHE KOMUNITETIN

Beba Šarkinović

Zhvillimi i një partneriteti me familjet kërkon kohë, durim dhe një sërë strategjish. Edhe pse ndonjëherë mund të jetë kërkuese, si në aspektin organizativ ashtu edhe në kohë, në planin afatgjatë, mundi dhe investimi shpërblehen në shumë mënyra. Për të përmirësuar partneritetin, duhet të mësojmë nga praktika jonë, por edhe nga të tjerët, të ndajmë njohuritë në shkollë dhe komunitet dhe të eksperimentojmë vazhdimisht. Ne i bëjmë këto për të arritur qëllimet e përcaktuara dhe për t'i dhënë çdo fëmije një mundësi për të qenë të lumtur dhe të suksesshëm.

Përvojat e deritanishme në këtë fushë tregojnë se ka shumë profesionistë që besojnë vërtet në bashkëpunimin e ngushtë me prindërit dhe kanë arritur rezultate të jashtëzakonshme. Po kështu, në çdo shkollë ka nga ata mësues që ende nuk janë gati për të ndërtuar një partneritet të tillë. Prandaj, është e rëndësishme të shikohen qëndrimet e mësuesve ndaj programeve të partneritetit, si dhe bindjet e tyre për rëndësinë dhe efektet e përfshirjes së prindërve dhe partnerëve të tjerë të komunitetit në të gjitha fushat e punës së shkollës. Mësuesit duhet të zhvillojnë aftësitë e punës në grup/ekip, përndryshe nuk është e mundur të zbatohet një program partneriteti.

Për të ecur me të vërtetë drejt ndërtimit të partneriteteve familje-shkollë, ne kemi nevojë për pyetje të vazhdueshme, vlerësim dhe reflektim të përbashkët mbi marrëdhëniet aktuale në shkollë.

Para se të vendosni të aplikoni një qasje partneriteti në shkollën tuaj, duhet të analizoni kualifikimet dhe gatishmërinë e mësuesve dhe drejtuesve dhe të vendosni prioritetet. Meqenëse moduli është i strukturuar në atë mënyrë që synon rritjen e kompetencave të familjes, anëtarëve të komunitetit dhe stafit, është e rëndësishme të respektohen nevojat dhe kërkesat e të gjithë pjesëmarrësve, duke respektuar parimet e barazisë dhe respektit të ndërsjellë. Duke krijuar një organizim fleksibël të të mësuarit dhe veprimet brenda shkollës, përmirësohen mjetet dhe teknikat, si edhe komunikimet dhe aftësitë konstruktive dhe motivuese, në mënyrë që secili prej pjesëmarrësve të mund të reflektojë mbi veprimet e veta në procesin e krijimit të partneriteteve.

Fillojeni vitin shkollor duke qenë më të hapur ndaj familjes (prindërve/kujdestarëve të nxënësve tuaj). Përpiquni të motivoni sa më shumë nga stafi, prindër dhe partnerë të shkollës që të jetë e mundur për të ndihmuar në zhvillimin e partneriteteve me familjet, shkollën dhe komunitetin. Qëllimi është të zhvillohet një dialog profesional i partnerëve në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, prindërve dhe mësuesve, forcimin e kompetencave reciproke dhe qasjen ndaj kritereve të përbashkëta për të qenë një edukator, prind dhe mësues më i mirë dhe për të qenë sa më të suksesshëm në arsimimin e fëmijës/nxënësit tonë.

Kushtojini vëmendje të veçantë komunikimit me prindërit/kujdestarët e nxënësve tuaj. Ka shumë mënyra

dhe forma komunikimi - është e rëndësishme të përdoren mundësitë për të përfshirë në mënyrë kuptimplotë prindërit dhe për t'i respektuar ata si bashkëbisedues të barabartë.

Komunikimi ka një efekt pozitiv në shkallën e përfshirjes së familjes kur është:

- pozitiv dhe i hapur,
- respekton opinionin dhe nevojat e secilës familje,
- respekton kulturat e ndryshme të familjeve,
- fokusohet në përparimin dhe arritjet e nxënësve dhe mënyrat e punës së mëtejshme.

Si të komunikohet me prindërit:

- Filloni një bisedë me gjëra pozitive,
- Kushtojini vëmendje asaj që prindërit bëjnë mirë,
- Përdorni gjuhë të thjeshtë por mos e nënçmoni,,
- Çdo komunikim është i rëndësishëm dhe një mënyrë për të krijuar një partneritet,
- Krijoni besim,
- Model oni sjelljen,
- Mësoni të dëgjoni,
- Jini fleksibël,
- Relaksohuni dhe argëtohuni!

TEKNIKA E TË DËGJUARIT AKTIV

Ne përdorim:

- Reflektim mbi emocionet - Unë shoh që kjo ju ka shqetësuar ... ju ka mërzhitur...
- Parafrazim - për të kontrolluar nëse e kuptuam saktë ... E kishit fjalën ...
- Përmbledhje - për të kontrolluar se çfarë ramë dakord...
- Bërjen e pyetjeve sqaruese - a mund të më shpjegoni se çfarë ndodhi më parë, a ishit atëherë...
- Heshtje – e cila nuk është kërcënuese
- Shprehjet e fytyrës dhe gjuhën e trupit - Unë jam këtu për ju

RREGULLAT E TË DËGJUARIT KONSTRUKTIV

- Secili person do të flisë për tre minuta.
- Ju mund të përdorni edhe “Detyrën” e bllokut të udhëtimit për prindërit,...komunikim i rregullt midis prindërve dhe shkollës (arritjet akademike të nxënësit, etc.).
- Një person flet për një afat kohor të paracaktuar, ndërsa personi tjetër dëgjon.
- Dëgjuesi nuk duhet të flasë, por duhet të tregojë një interes aktiv, me gjuhën e trupit, për atë që thotë personi tjetër. Jepini partnerit tuaj vëmendjen e plotë, duke e çliruar mendjen nga mendimet tuaja. Jini të ndjeshëm ndaj nevojave të partnerit tuaj.
- Heshtja është e mirë. Kur flisni dhe keni nevojë për kohë për të menduar, do të ketë heshtje. Dëgjuesi do të qëndrojë në heshtje, do të presë dhe nuk do të tregojë asnjë padurim.
- Kur të jap një sinjal, ju do të ndërroni rolet. Dëgjuesi do të flasë, dhe anasjelltas.
- Çdo person do të flasë për tri minuta.
- Mund të përdorni edhe fletoren e udhëtimit “Detyra” për prindërit, komunikim i rregullt mes prindërve dhe shkollës (arritjet e nxënësve etj.).

ASSERTIVENESS: MESAZHET - UNË

Nëse nevojat dhe interesat e prindërve apo mësuesve rrezikohen dhe nuk njihen, mund të ketë konflikte dhe ndërprerje të bashkëpunimit. Assertiveness është aftësia e të shprehurit të qëndrimeve, nevojave dhe ndjenjave në një mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë në të cilën ne nuk e sulmojmë apo fajësojmë palën tjetër. Është e nevojshme të identifikohen interesat dhe nevojat e veta dhe të ngrihesh në mbrojtje të tyre pa shkelur të drejtat e të tjerëve. Ajo është një aftësi që mund të zhvillohet dhe, në komunikimin me të rekomandohet përdorimi i teknikës "Mesazhi - Unë" që përmban:

- Përshkrim neutral të veprimeve/sjelljes së personit tjetër

- Përshkrim të ndjenjave/reagimeve tona ndaj veprimit/sjelljes
- Propozim dërguar një personi tjetër (çfarë situatë duam).

Në vend të “mesazheve – ti/ju” që janë fyese dhe që provokojnë nevojën e bashkëbiseduesit për t'u mbrojtur nga kundërsulmi, i cili krijon pengesa në komunikim, duke përdorur mesazhet – unë, ne shprehim nevojat tona pa synuar të sulmojmë tjetrin dhe shpesh arrijmë në një zgjidhje të përbashkët.

Shembuj:

Mesazhet – Ti/Ju	Mesazhet – Unë
"Ju jeni vazhdimisht vonë; Ju jeni i papërgjegjshëm dhe i padisiplinuar. Mos lejoni që kjo të ndodhë përsëri!"	"Unë kam vënë re se kohët e fundit jeni vonuar shpesh në punë. Vonesa juaj ndikon negativisht në produktivitetin e kolegëve të tjerë dhe unë nuk ndihem mirë për këtë. Unë do të doja që të mos vonoheshit më."
Turp të kesh, ma ke lënë gjithçka përsëri!"	"Unë zemërohem/inatosem kur lini kaos në kuzhinë, dhe unë duhet të pastroj gjithçka vetë! Do të më ndihmonte nëse të gjithë vendosin enët e tyre në lavaman pas tyre."

STRATEGJITË E KOMUNIKIMIT ME PRINDËRIT NË SITUATA SFIDUESE DHE KËSHILLA PËR ARRITJEN E MARRËDHËNIEVE POZITIVE DHE KONSTRUKTIVE ME PRINDËRIT E NXËNËSVE NË KLASËN TUAJ

- Rrini të qete. Vetëm dialogu dhe mirëkuptimi mund të çojnë në gjetjen e një zgjidhjeje. Mos e merrni personalisht një shprehje të prindit me zë të lartë. Zakonisht është një mënyrë për të shfryrë emocionet negative ndaj një personi që sapo është ndodhur pranë.
- Krijoni besimin e prindërve. Prindërit duan të dëgjojnë për gjërat e mira që po ndodhin në klasë. Dërgojuni atyre një mesazh të shkurtër kur fëmija bën diçka të mirë. Në këtë mënyrë ata do ta kuptojnë se ju po i kushtoni vëmendje fëmijës në tërësi dhe do të pranoheni si dikush që kujdeset për fëmijën kur ai është në shkollë.
- Dilni në komunitet. Nxënësve u jepet mundësia të demonstrojnë aftësitë e tyre dhe të ndihmojnë të tjerët. Komuniteti e pranon dhe e vlerëson që të rinjtë kujdesen për atë që po ndodh në komunitet. Shkolla merr promovim mediatik dhe komuniteti fillon të njohë nevojat e shkollës.
- Tregoni që ju kujdeseni. Inkurajojini prindërit ta ndajnë shqetësimin me ju nëse janë të shqetësuar. Tregojuni atyre se jeni aty për fëmijët e tyre dhe se ata janë të mirëpritur të punojnë me ju.
- Tregoni vetëbesimin dhe autoritetin tuaj në situata të vështira duke parë drejtpërdrejt në sytë e bashkëbiseduesit tuaj. Në këtë mënyrë ju tregoni se jeni të interesuar për atë që ai/ajo thotë dhe se e respektoni atë.
- Flisni me një ton më të qetë. Prindërit shpesh mendojnë se fëmija i tyre është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe duan që situata të korrigjohet, pa dëgjuar se çfarë ka për të thënë mësuesi. Është krejtësisht normale të bëheni nervozë dhe të tingëlloni të pasigurt. Pra, ulni zërin tuaj në mënyrë që të tingëlloni më të sigurt dhe kjo do të bëjë që prindi juaj t'ju dëgjojë më me kujdes.
- Pranojeni se të gjithë gabojnë. Mësuesit kanë shumë përgjegjësi, ndaj ka shumë mundësi për të bërë gabime. Kur një prind tregon një gabim, procedura e duhur e shkollës është të jeni mirënjohës dhe të pranoni informacionin e ofruar. Duke pranuar se ekziston mundësia e gabimit, shkolla i bën të ditur prindit se i intereson dhe do të hetojë se për çfarë bëhet fjalë. Është e nevojshme të zbulohet sa më shpejt që të jetë e mundur nëse është bërë vërtet një gabim dhe më pas të komunikohen rezultatet me prindërit.
- Tregoni ndjeshmëri. “Më vjen shumë keq që kjo ndodhi” janë fjalët që kanë fuqi të madhe. Ato tregojnë se e keni dëgjuar atë që ju thanë dhe se ju do t'ju interesonte që gjithçka të ishte në rregull. Në të njëjtën kohë, ju hapni mundësinë e zgjidhjes së problemit së bashku. Duke vepruar kështu, ju i jepni përparësi situatës së re dhe përpiqeni të arrini një zgjidhje.

TAKIMET ME PRINDËR DHE ATO INFORMUESE

Takimet me prindër dhe ato informative janë forma më e zakonshme e komunikimit ndërmjet shkollës dhe familjes dhe duhet të modifikohen. Një qasje e modifikuar dhe e individualizuar ndaj takimeve me prindër kontribuon në përmirësimin dhe rritjen e partneritetit midis familjes dhe shkollës. Sa më shpejt të fillojmë të punojmë me familjet, aq më mirë. Takimet e para janë një mundësi për të njohur më mirë prindërit dhe për t'i udhëzuar ata në rrugën e punës së bashku, një mundësi për të shprehur pritshmëritë dhe dëshirat tuaja për çdo fëmijë, por edhe për të zbuluar pritshmëritë e familjeve.

Disa nga mënyrat për t'i bërë takimet e para më të relaksuara për prindërit dhe shokët e klasës/mësuesit kujdestarë:

- Krijoni një “bazë të dhënash fillestare” — për të krijuar një model partneriteti në klasë me prindërit, është e nevojshme të njihen nevojat dhe mundësitë e komunitetit të klasës.
- Prindërit duhet të njihen me rutinat dhe rregullat e shkollës. Sigurohuni që të ketë një atmosferë të mirë dhe që familjet të njihen me njëri-tjetrin.
- Historia e mësuesit kujdestar për takimin e tyre të parë me prindër (histori për përvojat e mëparshme, anekdota interesante, shfaqja e videove, fotove, portofoli, etj...).
- Shfaqja e video-mesazheve të përgatitura nga nxënësit për prindërit.
- Mësuesi kujdestar i përfshin nxënësit në planifikimin, përgatitjen dhe zbatimin e takimeve me prindër (nxënësit kontribuojnë në realizimin më të suksesshëm të mbledhjes me prindër; ndonjëherë nxënësit mund të zbatojnë një aktivitet të caktuar në fillim të mbledhjes me prindër, ndonjëherë në fund të saj..).
- Bëni përpjekje për të takuar familjet dhe ta bëni këtë në një mënyrë më pak formale, duke krijuar një atmosferë respekti dhe besimi reciprok.
- Shpjegoni pritshmëritë tuaja në fillim të vitit shkollor dhe tregojuni atyre se çfarë mund të presin nga ju - asgjë nuk merret si e mirëqenë.
- Tregoni interes për familjen dhe fëmijët - është e rëndësishme që ata të dinë se ju kujdeseni për ta.
- Mbroni privatësinë e familjes dhe mbani sekret informacionin e familjes dhe të fëmijëve.
- Përfshini prindërit dhe tregojuni se e vlerësoni kontributin e tyre — kështu ata do t'ju vlerësojnë më shumë.
- Komunikoni rregullisht me familjet dhe dërgoni mesazhe pozitive për fëmijët; kjo do të reduktojë stresin që lidhet me takimet.
- "Prindi-për-prindin" është lidhja e prindërve në mënyrë që ata të mund të mbështesin njëri-tjetrin, të shkëmbejnë informacion, të japin këshilla dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. Aktivitetet në grup mund të organizohen edhe si takime mbështetëse.
- Shkruajini një letër prindërve në fillim të vitit. Ofrojeni atyre një partneritet dhe një marrëdhënie të sinqertë të bazuar në çiltërsi dhe komunikim të mirë. Le të jetë ky hapi juaj i parë drejt një partneriteti shkollë-familje!
- Ofrojeni prindërve të nxënësve tuaj një marrëveshje partneriteti për vitin shkollor, në të cilën do të fokusoheni në prioritetet më të rëndësishme.
- Takoni nxënësit tuaj dhe prindërit e tyre. Zbuloni cilat janë vështirësitë dhe pengesat më të zakonshme në arritjen e një komunikimi të mirë me familjet. Inkurajojini prindërit t'ju tregojnë për fëmijën e tyre: (PËR FËMIJËN TUAJ 3, 2, 1 - 3 fjalë që përshkruajnë fëmijën tuaj, 2 gjëra që mendoni që unë duhet t'i di për fëmijën tuaj, 1 qëllim që ju keni për fëmijën tuaj këtë vit.)
- **Pyetini prindërit se si ndihen në shkollë; nëse përgjigja e tyre është kjo, ju keni bërë përparim:**

“Ne gjithmonë ndihemi të mirëpritur dhe jemi si në shtëpinë tonë në klasë.

Ndjejme se e gjithë kjo është e përbashkëta jonë dhe se ne ndajmë gjithçka dhe kjo do të thotë shumë për ne.

Mësuesi na respekton dhe respekton mendimin tonë.

Mësuesi dhe ne nuk kemi sekrete

Ne jemi partnerë.”

Forcimi i bashkëpunimit midis prindërve çon në forcimin dhe përmirësimin e kohezionit të klasës. Forca e grupit ndihmon në forcimin dhe udhëzimin e prindërve të tjerë për t'u përfshirë, për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje, për të pranuar përgjegjësi dhe për t'u kujdesur për njëri-tjetrin.

NDIHMUJINI PRINDËRIT TË:

- komunikojnë më mirë me fëmijët.
- zbatojnë proceduarat e duhura të edukimit.
- ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësi të mira sociale, vetëbesim dhe vetëvlerësim.
- fitojnë dhe zhvillojnë vetëkontroll.

KUR PËRGATITNI WORKSHOP-E PËR PRINDËRIT, MBANI PARASYSH QË PRINDËRIT:

- kanë njohuri dhe aftësi të ndryshme të mëparshme, por kanë ardhur këtu me një ide se çfarë duan të mësojnë dhe si duan të mësojnë.
- kanë stile të ndryshme të të nxëniet.
- kanë nevojë për kohë dhe "kurajo" për të ndarë përvojat e tyre me të tjerët.
- Sugjeroni tema për prindërit (jepuni prindërve mundësinë të shkruajnë se në cilat fusha kanë nevojë për edukim).

IDE PËR VEPRIME/VEPRIMTARI SHKOLLË, FAMILJE, KOMUNITET

1. PËRGATITJA PËR SHKOLLË

Program trajnimi dhe burime për prindërit e fëmijëve që do të shkojnë në shkollë vitin e ardhshëm. Organizimi i takimeve mujore (apo edhe javore) me prindërit, i lejon ata të ndihmojnë zhvillimin e fëmijës, të inkurajojnë aftësitë paralexuese dhe para-matematikore, të kuptojnë se si fëmija mëson dhe zhvillohet. Në çdo workshop, prindërit marrin detyra dhe materiale specifike për të punuar me fëmijët, dhe takimet i lejojnë ata të takohen, të shoqërohen dhe të kalojnë kohë të këndshme në shkollë. Fëmijët, prindërit e të cilëve e kanë kaluar këtë program, janë më të përgatitur për shkollën, kanë vetëbesim më të madh dhe aftësi më të mira sociale.

2. RRETHET E SHOKËVE/MIQVE

Rrethet e miqve përfaqësojnë një metodologji specifike që na ndihmon të ndërtojmë një rrjet mbështetës për çdo fëmijë përmes: promovimit të përfshirjes sociale të fëmijëve, inkurajimit të pranimit dhe mirëkuptimit në grupin e bashkëmoshatarëve, reduktimit të sjelljes sfiduese tek fëmijët, inkurajimit të fëmijës për t'u bashkuar me grupin dhe pranimin e rregullave të tij. , duke i ofruar mbështetje fëmijës për të përballuar me sukses disa ndryshime e duke e ndihmuar fëmijën të bëjë sa më shumë miq. Fëmijët që janë të tërhequr nga marrëdhëniet shoqërore, fëmijët që ndihen të izoluar dhe të vetmuar në një grup bashkëmoshatarësh, përfitojnë drejtpërdrejt nga Rrethi i Miqve.

3. KUR NDIHMOJ, NDIHEM MIRË

Ndihmojeni fëmijën të ndiejë gëzimin e dhurimit dhe ndihmës. Së bashku me fëmijët zgjidhni "gjëra të vogla të rëndësishme" dhe bëni një pako të vogël që do t'ia jepni një fëmije që ka nevojë për ndihmë (nga lagjja, shkolla, nga një vend tjetër ku fëmijët janë në rrezik). Lëreni fëmijën të vendosë se çfarë mendon se duhet të futet në pako, pyeteni atë se çfarë mendon se është e rëndësishme dhe e nevojshme për ata fëmijë dhe pse. Kërkojini fëmijës të zgjedhë një nga gjërat e tij/saj që mendon se do ta bëjnë një fëmijë tjetër të lumtur dhe vendoseni në pako. Ndihmojeni fëmijën tuaj të imagjinojë se si do të ndihet dikush që e hap pakon, sa i/e lumtur do të jetë dhe çfarë do të thotë kjo për të. Kërkojini fëmijës t'i shtojë një letër fëmijës në pako, ku ai ose ajo i drejtohet atij/asaj fëmije, nëse fëmija dëshiron të përgjigjet.

4. NJOHURITË NË KOMUNITET

Shfrytëzoni ambientet ekzistuese të komunitetit lokal, një klub apo qendër për fëmijë dhe organizoni asistencë vullnetare për fëmijët me mësimet e tyre. Kërkojuni miqve tuaj nga prejardhje të ndryshme të bashkohen me ju. Ftoni prindërit tuaj ose lidhuni me një qendër ose organizatë që mbledh së bashku pensionistët.

5. TË TAKOJMË KOMUNITETIN TONË

Njihuni me komunitetin tuaj. Disa fëmijë, së bashku me prindërit e tyre, bëjnë pak kërkime për njerëzit "e zakonshëm" në komunitetin e tyre që kanë bërë vepra të respektuara si qytetarë, për profesionet dhe rëndësinë e tyre për komunitetin. Lejojini të flasin për këta njerëz, të bëjnë broshura (p.sh., "Heronjtë nga lagjja"), të bëjnë një galeri fotografish (ata mund të përdorin celularë). Mbani mend - çdo anëtar i komunitetit është i rëndësishëm!

6. PRINDËRIT MUND TË JENË EDHE LEKTORË

Lejojini prindërit të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme shkollore në një mënyrë që pasqyron më së miri aftësitë dhe interesat e tyre. Statusi socio-ekonomik ose arsimor i prindërve dhe mundësitë e tyre nuk duhet të jenë pengesë, por më tepër një mundësi për prindërit e tjerë dhe të gjithë fëmijët për të mësuar diçka të re. Çdo përvojë dhe njohuri është e rëndësishme dhe çdo prind ka një të tillë. Ju mund të organizoni që prindërit të drejtojnë workshope në komunitetin e klasës për një temë që ata sugjerojnë (ata mund të flasin për profesionet e tyre, hobi, aftësi të tilla si: kopshtaria, gatimi, sporti, etj.). Përveç kësaj, prindërit mund të përgatisin leksione, workshope, kurse për prindër të tjerë. Sigurohuni që t'u ofroni prindërve ndihmë me përgatitjet, të shpjegoni se çfarë pritet prej tyre, si t'u prezantohen fëmijëve, t'u ofroni ide dhe ndihmë. Nxitini fëmijët të mendojnë rreth pyetjeve për miqtë/të ftuarit. Falënderojini të gjithë prindërit për pjesëmarrjen dhe ndihmën e tyre dhe vendosni shënimet e falënderimit në një vend të dukshëm në shkollë dhe/ose në klasë.

7. EDHE PRINDËRIT SHKOJNË NË SHKOLLË

Disa muaj, apo edhe një vit para se fëmijët të fillojnë klasën e parë, ftojini prindërit dhe nxënësit e ardhshëm në shkollë. Njihuni me njëri-tjetrin për të krijuar një ndjenjë të mbështetjes reciproke dhe për të lidhur prindërit, fëmijët e të cilëve janë bashkëmoshatarë. Gjatë periudhës së ardhshme mund të organizoni workshope të ndryshme për prindërit, të cilat do t'i ndihmojnë ata të krijojnë një mjedis të mirë për fëmijët dhe të nxisin zhvillimin e aftësive përpara se të shkojnë në shkollë. Krijoni një bibliotekë të vogël për prindërit për t'i inkurajuar ata të lexojnë më shumë për fëmijët dhe të flasin me ta. Workshopet mund të organizohen për të dy prindërit, por edhe vetëm për nënat, ose tema të veçanta vetëm për baballarët. Temat e workshopeve mund të lidhen me mbështetjen e zhvillimit të fëmijës, komunikimin e ndërsjellë, dhënien e komenteve ndaj fëmijës, forcimin e vetëbesimit dhe vetëvlerësimit të fëmijës, metodat e disiplinës pozitive, zhvillimin e përgjegjësisë së fëmijëve, rolin dhe stilet e prindërimit, marrëdhëniet nënë-baba, shëndeti, etj..

8. JEMI TË GJITHË PJESË E KOMUNITETIT TË SHKOLLËS SONË

Në sallën ose korridoret e shkollës ndani një hapësirë të përbashkët në mur që mund të rregullohet në mënyrë alternative, për shembull çdo muaj, nga nxënës dhe prindër të klasave të ndryshme. Lëri në vendosin vetë se si do ta modifikojnë atë, le të prezantojnë aktivitetet e tyre të përbashkëta të regjistruara në fotografi, çfarë arritën, cilat ishin aktivitetet e tyre të preferuara, për çfarë krenohen në mënyrë të veçantë, etj..

9. LIBRI YNË I VEPRIMTARIVE

Prindërit mund të jenë mbështetja më e madhe për fëmijët në të mësuarit në shtëpi duke përdorur burime nga mjedisi. Nxënësit dhe prindërit hartojnë detyra matematikore, bëjnë ilustrime, shkruajnë detyra teksti dhe kanë mundësinë të prezantojnë punën e tyre në klasë, gjatë muajit, duke përshkruar procedurën dhe mënyrën e krijimit të detyrave të matematikës. Pas ca kohësh, kur të kenë mbledhur mjaftueshëm material të shkruar, mund të botoni (prindërit, fëmijët dhe mësuesi) koleksionet e matematikës si librin e tyre të veprimtarive.

10. LIBËRTHAT/BROSHURAT E PRINDËRVE

Është e rëndësishme që të gjithë nxënësit të marrin pjesë në krijimin dhe hartimin e broshurës së prindërve. Në broshurë, nxënësit mund të shkruajnë për angazhimin e prindërve të tyre, përkushtimin, ardhjen në shkollë, mbështetjen e tyre në mësim, aktivitetet jashtëshkollore/ekstra kurrikulare dhe se sa domethënie kanë për ta, etj. Nxënësit ua shpërndajnë broshurat prindërve në baza tremujore ose semestrale në takimet formale të prindërve të planifikuara nga mësuesit dhe nxënësit së bashku me një program të përgatitur siç duhet. Detyra e nxënësve është të hartojnë ftesa dhe të përgatisin një program për prindërit. Në këtë mënyrë arrijmë që të rritet përfshirja e prindërve dhe motivimi për të qenë aktivë gjatë gjithë vitit shkollor.

11. KONKURSET E PRINDËRVE TË SHKOLLËS

aktivitete të ndryshme, sporte apo gara në këngë, vallëzim, recitim, gatim, rregullim të ambjentit të shkollës, etj.

12. MBUROJA FAMILJARE

Nëpërmjet këtij aktiviteti inkurajojmë prindërit të kujtojnë momente të rëndësishme në familjen e tyre, të flasin hapur dhe lirshëm për dëshirat, arritjet, sfidat, marrëdhëniet dhe qëndrimet e tyre për të arritur besimin dhe lirshmërinë e komunikimit në grup. Është e dëshirueshme që mësuesi të shkruajë ose të vizatojë mburojën e familjes së tij në të njëjtën kohë me prindërit. Vizatoni një "mburojë" në letër me gjashtë fusha bosh që prindërit do t'i plotësojnë me vizatime ose fjalë:

- Suksesi im më i madh

- Momenti më i lumtur i këtij viti

- Suksesi më i madh në familje

- Suksesi im më i madh në biznes

- Jam krenare si prind i...,

- Motoja ime e jetës

13. NJË KUTI PËR GJITHËSECILIN

Në fillim të klasës së parë, udhëzohet prindërit të përdorin kutinë e klasës dhe të shpjegojnë rëndësinë e ekzistencës së saj. Prindërit kanë mundësinë të zgjedhin nëse do ta nënshkruajnë letrën e tyre ose nëse do ta mbajnë në një kuti në mënyrë anonime. Në këtë mënyrë mund të shqyrtohen qëndrimet e prindërve nga disa fusha, të cilat do ta ndihmojnë mësuesin të analizojë punën e tyre, të shohë të mirat dhe të këqijat e takimeve me prindër, të mësojë për cilësinë e komunikimit, mundësinë e kërkimit të ndihmës apo ndonjë lloj mbështetjeje prej prindërve nga shkolla (financiare, arsimore, mbështetje në sjelljen dhe kthimin e fëmijëve në shkollë, etj.).

14. EKIPET MBËSHTETËS TË PRINDËRVE

Është e rëndësishme që të formohen ekipet e prindërve duke respektuar afinitetet, njohuritë, aftësitë dhe kohën e lirë të prindërve. Në këtë mënyrë përmirësohet komunikimi mes prindërve, fëmijëve dhe mësuesve dhe, duke miratuar një plan konkret zhvillimi të komunitetit të klasës, ndajmë përgjegjësinë, veprojmë në mënyrë parandaluese, mbështesim njëri-tjetrin dhe gjejmë mënyra për të kapërcyer vështirësitë (disiplina, ecuria në mësim, zakonet e punës. ...). Ekipet për të mbështetur mësuesit dhe nxënësit në zbatimin e aktiviteteve jashtëshkollore dhe mësimore mund të jenë për: aktivitete sportive (futboll, basketboll, atletikë, volejbol, not, vallëzim), lexim dhe shkrim (të marrin pjesë në krijimin e një biblioteke klase, duke shkuar në bibliotekën e qytetit, panairë libri, festimi i Ditës së Librit, Dita e shkrim-leximit, shkrimi i tregimeve dhe poezive, organizimi i ardhjes së shkrimtarëve ...), arti (kostume, objekte në skenë, shkuarja në teatër, muze, kinema, shfaqje), ekologji (këndi ekologjik, shëtitjet në mal, rregullimi i oborrit të shkollës, shënimi i datave të rëndësishme si Dita e Tokës, Dita e Ujit...), ekipi për kulturën e të jetuarit, etj..

MËNYRAT E PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE NJË AMBJENT PËR PRINDËRIT

BËNI NJË BULETIN/TABELË PËR PRINDËRIT:

- Informacion: Plan pune-orar aktivitetesh, aktivitete ekstrakurrikulare, projekte, evente të rëndësishme
- Rregullat dhe vlerat e shkollës –gjuhë e përshtatshme për prindërit
- Ftesa për gjithëpërfshirje dhe vullnetarizëm
- Krijoni një hapësirë për të biseduar me prindërit: Këndi i Prindërve. Këtu prindërit duhet të kenë hapësirë për veten e tyre dhe të jenë në gjendje të gjejnë burime të ndryshme në lidhje me prindërimin, zhvillimin e fëmijëve, shërbimet në komunitet dhe kjo mund t'i ndihmojë ata të punojnë me fëmijën e tyre në shtëpi sipas klasës dhe lëndës. Duhet të jetë një kënd/dhomë komode, me ngjyra të këndshme, mobilje komode dhe me akses në kompjuter dhe internet. Brenda këndit mund të organizoni një hapësirë me një koleksion librash, artikujsh, materiale video dhe audio interesante që prindërit mund t'i huazojnë.
- Informacion i rëndësishëm për kontakte
- Foto, mirënjohje për prindërit – vullnetarët
- Informacion i lidhur me sigurinë
- Informacion mbi takimet e Këshillit të Prindërve
- Lejojini prindërit të njihen me njëri-tjetrin
- Lejojini prindërit të njihen me drejtuesit, bordin dhe të gjithë mësuesit
- Prezantoni prindërit me rregullat dhe procedurat që lidhen me sigurinë, parandalimin e dhunës dhe vlerat
- Prezantoni misionin dhe vizionin
- Dërgoni një letër tek prindërit para fillimit të vitit shkollor
- Bëni postera të vegjël për rëndësinë e përfshirjes së të gjitha familjeve (p.sh. distinktivë, çanta prej kanavace, kartolina, mesazhe) dhe shpërndajini ato tek të gjithë prindërit në shkollë.

TË MËSUARIT NË SHTËPI

- Rregullimi/Përgatitja për detyrat e shtëpisë
- Koha për lexim/koha për të mësuar
- Kriteret e vlerësimit - monitorimi i përparimit të fëmijëve
- Portofoli i fëmijëve
- “Detyrat” për prindërit: Lidhja e asaj që kanë mësuar me aktivitetet në shtëpi dhe situata të tjera joformale
- Njoftimet për temat e trajtuara dhe mundësitë për përfshirjen e prindërve
- Prindërit – mësuesit në klasë ose në komunitet
- Materiale konkrete për të punuar me fëmijët

- Për çfarë jam krenar - çfarë ka mësuar fëmija im - një përmbledhje e suksesit
- Huazimi i librave, materialeve - çantë shpine "udhëtimi" (lexim, matematikë...)
- Të mësojmë si të mësojmë – mbështetje për

prindërit

- Në vend të një shfaqjeje ose përsëritjeje - Fëmijët u prezantojnë prindërve atë që kanë mësuar - pas çdo fushe kryesore

VULLNETARIZMI

- Pyetësor për vullnetarë
- Plani i punës me prindërit – vullnetarë
- Mirënjohje për vullnetarët
- Mundësi të ndryshme për vullnetarizëm - në shkollë, klasë, komunitet, në punë, në fshat ...
- Përfshirja e prindërve – përshtatja e kohës, mënyrës, rolit, shkallës së angazhimit
- Mbështetje–prindërit për prindërit
- Ditët e aftësimi për jetën - një grup workshopesh për nxënësit nga prindërit (gatim, ndërrim gomash; bërja e sendeve të ndryshme; kujdesi për kafshët, kultivimi i perimeve, etj.)

- Nata e talenteve; nata e shkencës; artet - fëmijët dhe prindërit
- Organizim i mbremjes së filmit për familjet
- Dita kushtuar temave që studiohen - fëmijët prezantojnë atë që kanë mësuar
- Prindërit marrin pjesë në evente/aktivitete - drejtpërdrejt ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë
- Organizimi i mbrëmjeve të filmit me prindër, nxënës dhe mësues në ambientet e shkollës
- Organizimi një herë në muaj i një mbrëmjeje letrare, në të cilën prindërit në shkollë lexojnë një nga temat e paracaktuara

KOMUNIKIMI

- Aftësitë e kërkuara: Aftësi për të dëgjuar; Si të përcillni mesazhin
- Format e komunikimit: teknologjia, fletorja "udhëtuese"; Viber, e-mail, Facebook
- Mesazhe pozitive, falënderime, mesazhet e frigoriferit
- Fotografi, video ... (përputhja me rregullat e sigurisë së fëmijëve, leje për të publikuar ...)
- Broshura, tekste të dobishme
- Tabela e buletinit - temat e muajit (vlerat) - çfarë

mund të bëjnë prindërit në shtëpi

- Letra informuese e shkollës - një faqe me informacion aktual
- Forma të ndryshme të takimeve - prindër të përfshirë në planifikim; të ulur në grupe; në një rreth; diskutime dhe debate për tema specifike; organizues grafikë
- Organizimi i webinarëve ose prezantime video për prindërit që nuk mund të vijnë në shkollë

MARRJA E VENDIMEVE

- Aftësitë e kërkuara: Aftësi për të dëgjuar; Si të përcillni mesazhin
- Format e komunikimit: teknologjia, fletore "udhëtuese"; Viber,
- Informacion se si funksionon Këshilli i Prindërve - përfshini prindërit më me përvojë në informimin e të rinjve.
- Raportet e takimeve për të gjithë prindërit
- Përfshirja e prindërve në vendimmarrje në të gjitha nivelet
- Pyetësorë; tabelë njoftimesh; pyetje të shkurtra përmes Viber ose email
- Përfshirja e prindërve në hartimin e rregullave - rregullave të shtëpisë dhe politikave të tjera

përkatëse

- Përfshirja e të gjitha grupeve të prindërve
- Përfshirja e prindërve në hartimin e planit të zhvillimit të shkollës dhe planit të punës me familjet
- Mbështetja e familjeve në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet shkolla - avokimi në komunitet
- Mënyrat që prindërit të shprehin publikisht ose në mënyrë anonime shqetësimet e tyre ose të bëjnë një pyetje
- Përfshirja e prindërve në vlerësimin e punës së shkollës

LIDHJA/BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN

- Identifikimi dhe përdorimi i burimeve në komunitet: arsimore, kulturore, sociale, njerëzore, ekonomike, materiale ...) për të ofruar mbështetje për prindërit dhe fëmijët

- Mbështetja e prindërve për të marrë shërbimin komunitar
- Inkurajimi i bashkëpunimit me organizatat dhe institucionet në komunitet – komunikim i rregullt
- Inkurajimi i përfaqësuesve të komunitetit për të marrë pjesë në punët e shkollës – mbështetje në mësim, vullnetarizëm etj.
- Shfrytëzimi i hapësirës së shkollës për aktivitete që i nevojiten komunitetit
- Angazhimi i arsimtarëve në pension dhe pensionistëve të tjerë
- Inkurajimi i nxënësve për të marrë pjesë në aktivitete të komunitetit – vullnetarizëm, aksione, angazhim nëpër kompani ,etj..

MBËSHTETJE PËR FAMILJET E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, FAMILJET E GRUPEVE MINORITARE TË MARGJINALIZUARA, PRINDËR TË VETËM

- | | |
|--|--|
| • Analiza e gjendjes - të dhëna të sakta | • rastit |
| • Analiza e nevojave | • Lidhja me shërbimet komunitare |
| • Mundësia për të punësuar ekspertë dhe vullnetarë | • Krijimi i një klimetë ndjeshme dhe gjithëpërfshirëse |
| • Grupet mbështetëse, mbështetja e kolegëve | • forcimi i solidaritetit, zhvillimi i empatisë |
| • Mbështetje e vazhdueshme - jo vetëm veprime të | • Edukimi dhe forma të tjera të fuqizimit të familjes |

NE KEMI NEVOJË PËR NDIHMËN TUAJ! Vullnetarizmi është i rëndësishëm!

Të dashur prindër / kujdestarë!

Përfshirja juaj në punën e shkollës është e paçmueshme si për ne mësuesit ashtu edhe për fëmijët. Është shumë e rëndësishme që fëmijët tuaj të shohin prindërit e tyre (vëllezërit, motrat, gjyshërit, gjyshet dhe anëtarët e tjerë të familjes) në shkollën e tyre, t'ju prezantojnë me miqtë e tyre, mësuesit dhe hapësirën, në të cilën ata jetojnë. Nëse mendoni se arsimit nuk është profesioni juaj dhe se nuk keni çfarë të kontribuoni, gaboheni. Ka shumë mënyra që ju të kontribuoni në punën e shkollës dhe të ndani me ne njohuritë, përvojat, idetë, talentet dhe hobet tuaja. Kjo do t'i lejojë fëmijët të mësojnë diçka "nga burimi parësor", të shijojnë punën së bashku dhe shoqërimin, të ndjehen krenarë për bashkëmoshatarët e tyre, të pranojnë dhe të kuptojnë rëndësinë e punës dhe të të mësuarit.

Ne e dimë që shumica prej jush jeni shumë të zënë, por jemi të sigurtë që do të gjeni një moment kur të mund të bashkoheni me ne dhe fëmijët. Ju gjithashtu mund të bëni disa aktivitete ose të ndihmoni në shtëpi ose në punë.

Emri dhe mbiemri: _____

Numri i telefonit për kontaktim: _____

Ju lutemi specifikoni një ose më shumë data kur jeni më të lirë për të kryer disa nga aktivitetet e ofruara:

Dita:	Gjatë: paradites / pasdites
<input type="checkbox"/> Prezantimin e profesionit/hobit tuaj <input type="checkbox"/> Ndhimë për të mësuarit (fusha: _____) <input type="checkbox"/> Aktivitete sportive <input type="checkbox"/> Rregullimin e klasës <input type="checkbox"/> Diçka tjetër: _____ <input type="checkbox"/> Organizimin e eventeve/shfaqjeve	<input type="checkbox"/> Unë nuk e kam të mundur të vij në shkollë, por unë mund të ndihmoj nga shtëpia <input type="checkbox"/> Bërjen e standave të afishimit, posterave, materialeve mësimore <input type="checkbox"/> Fotokopje materialesh <input type="checkbox"/> Aktivitete muzikore

Komente shtesë / sugjerime:

Ne presim me padurim t'ju takojmë dhe të mësojmë prej njëri-tjetrit!

DISA IDE SHITESË PËR T'U PËRFSHIRË:

Faqja e mëposhtme rendit ide shtesë se si ju, si prind/kujdestar, mund të përfshihen në aktivitetet e shkollës dhe të kontribuoni për një edukim më të mirë për nxënësit.

1. Lexoni ose na tregoni histori (që ju i doni, që ju janë treguar, që jeni duke shkruar)
2. Na ndihmoni të bëjmë libra me figura, të bëjmë gazeta dhe koleksione
3. A gatvani mirë? Na ndihmoni dhe na mësoni diçka për përgatitjen e ushqimeve dimërore, llojet e pjatave për raste të veçanta, na tregoni se çfarë hanë njerëzit në zona të ndryshme të vendit dhe botës, etj.
4. A jeni mirë në sport? Përfshihuni në lojëra sportive ose na tregoni lojëra nga fëmijëria juaj
5. Na ndihmoni të vizitojmë vendin tuaj të punës si pjesë e një teme specifike
6. Ndani me ne, në shkollën tonë, informacione për profesionin tuaj, na tregoni produktet, mjetet që përdorni; na shpjegoni pse e doni punën tuaj dhe pse është e rëndësishme
7. Ju jeni të mirë në krijimin e mjeteve ndihmëse vizuale - tabela afishimi, postera për të mësuar, etj.
8. Ju ju pëlqen të punoni me bimë, lule dhe aktivitete të tjera që lidhen me natyrën (shëtitje, mbledhja e bimëve medicinale, përgatitja e çajrave, rritja e perimeve ...)
9. Sillni kafshën tuaj shtëpiake dhe na prezantoni me karakteristikat e asaj specieje, sjelljen, dietën, etj.
10. A keni një hobi - na tregoni koleksionin tuaj, mjetet, etj.
11. Ju keni duar të arta - ju qepni, thurni, bëni me grep, përdorni çekiçin dhe qepni mirë me makinë
12. Ju mund të na mësoni diçka tjetër _____
13. Shpjegoni idenë tuaj:

SHPESH NE KEMI NEVOJA TË TJERA PËR TË CILAT KEMI NEVOJË PËR NDIHMË

14. Fotokopjimin e materialeve tona mësimore
15. Ndihmë me transportin për në teatër, në një ekspozitë, udhëtim
16. Rregullimin e diçkaje në shkollë
17. Rregullimin e peizazhit
18. Sillni materiale të mbetura që mund t'i përdorim në punë (letër, dru, pëlhura, paketim...)
19. Shpjegoni idenë tuaj:

NDONJËHERË, EDHE PRINDËRIT KANË NEVOJË PËR NDIHMË

A keni preferenca për ndonjë prej aktiviteteve të mëposhtme?

20. Koordinimi i punës me prindërit e tjerë
21. Ofrimi i asistencës ligjore, konsulencës, ose ndonjë lloj tjetër asistence për prindërit e tjerë
22. Planifikoni ose realizoni leksione ose workshope për prindërit
23. Ndihmoni me riparimin e shtëpisë
24. Çuarja e fëmijëve të prindërve të tjerë nënjë event/aktivitet
25. 6. Diçka tjetër _____
26. Shpjegoni idenë tuaj:

PLANI I VEPRIMIT TË PARTNERITETIT SHKOLLË, FAMILJE, KOMUNITET PËR VITIN 20 __ / __.

KUR KRIJONI NJË PLAN VEPRIMI, PËRDORNI BAZËN TEORIKE TË DHËNË NË "LLOJET E PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE".

Emri i shkollës:	
Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës:	
NJË HAP PËR TË KRIJUAR PARTNERITETIN FAMILJE-SHKOLLË	IDETË E MIA PËR AKTIVITETE
Mjedisi-Aktivite përgatitore	
Prindërimi	
Të mësuarit në shtëpi	
Vullnetarizmi	
Komunikimi	
Marrja e vendimeve	
Lidhja/Bashkëpunimi me komunitetin	
Mbështetje për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, familjet e grupeve minoritare dhe të marginalizuara, prindër të vetëm...	

PLANI I AKTIVITETEVE SIPAS MUAJVE:		
MUAJI	DETYRAT	AKTIVITETET PËR PËRMBUSHJEN E DETYRAVE
SHTATOR		
TETOR		
NËNTOR		
DHJETOR		
JANAR		
SHKURT		
MARS		
PRILL		
MAJ		
QERSHOR		
KORRIK		
GUSHT		

Detyra: Vendosni prioritetet për zhvillimin e partneriteteve me familjet dhe komunitetin deri në fund të vitit shkollor. Ju mund t'i bëni të gjitha aktivitetet që lidhen me fushën e partneritetit si ekip, gjatë takimeve, në një klasë ose në nivel shkolle. Nëse keni shembuj dhe ide që keni zbatuar në departament ose në nivel shkolle në fushën e partneritetit me familjet dhe komunitetin që nga shtatori, ndajini ato me ne. Që kur filloni të planifikoni në shkurt, duhet të planifikoni aktivitetet dhe rezultatet për pesë muajt e ardhshëm. Dokumentoni të gjitha aktivitetet e realizuara, fotografi, viedo të regjistruara, prezantime etj.. Ju urojmë fat!

IDE PËR AKTIVITETE

Krijoni idenë tuaj, ose ndani një ide tashmë të provuar dhe të testuar që do të ndihmojë në forcimin e partneritetit midis familjes dhe shkollës:

IDE PËR AKTIVITETE						
Emërtimi i aktivitetit:						
Muaji:						
Ku: (ju mund të shënoni disa fusha)	Nxënësit më të vegjël	Nxënësit adoleshentë	Gjatë gjithë shkollimit të tyre	Në sallën e mësuesve / stafit	Në shtëpi	Në komunitet
Si do të zbulojnë/mësojnë të tjerët: (Metoda e prezantimit)						
Objectivi i aktivitetit:						
Rezultatet e aktivitetit						
Përshkrimi i aktivitetit:						
Metoda e monitorimit dhe vlerësimit						

MODULI 4: KU JEMI TANI DHE KU DUAM TË JEMI VETËVLERËSIMI DHE PËRCAKTIMI I QËLLIMIT DHE PRIORITETEVE

Përmbajtja e këtij moduli lidhet me harmonizimin e përdorimit të standardeve dhe treguesve që kanë të bëjnë me klimën dhe kulturën e shkollave, me qëllim që të analizohet gjendja aktuale, të përcaktohen prioritetet për përmirësim, si dhe monitorimi dhe vlerësimi i progresit dhe arritjeve. Procesi i vetëvlerësimit i mundëson shkollat të përcaktojnë më qartë qëllimet dhe detyrat që lidhen me përmirësimin e klimës dhe kulturës së shkollës, duke punuar me fëmijë me status të ndryshëm socio-ekonomik, për t'i përfshirë në planin e tyre të zhvillimit.

PËRMBAJTJA E MODULIT

- Praktikak më të mira të shkollës për mbledhjen e të dhënave për SSE e nxënësve në shkolla
- Një udhëzues se si të përdoren të dhënat e analizuara të shkollës për të përcaktuar fushat prioritare të punës së shkollës
- Një shembull i një lidhjeje të mirë dhe qartësisht të dukshme ndërmjet të dhënave të mbledhura, prioriteteve të përcaktuara dhe vlerave të shkollës
- Shembuj të qëllimeve dhe treguesve të performancës të përcaktuar mirë
- Udhëzime për zhvillimin e një plani veprimi/zhvillimi të shkollës

REZULTATET/STANDARDET E MODULIT

- Shkolla ka një plan zhvillimi afatgjatë të bazuar në misionin, vizionin dhe vlerat
- Plani i zhvillimit të shkollës i përgjigjet pyetjes - si do ta arrijmë vizionin dhe misionin e vendosur - për të ndërtuar një shkollë që promovon eliminimin e ndikimit të SSE në arritjet e nxënësve
- Plani i zhvillimit të shkollës bazohet në një analizë të situatës dhe në prioritetet e identifikuara për përmirësim
- Shkolla ka zhvilluar një metodologji dhe instrumente për analizimin e situatës në lidhje me standardet dhe qëllimet e përcaktuara.
- Planet e shkollës përmbajnë aktivitete që mundësojnë të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës:
 - të takohen
 - të bashkëpunojnë në aktivitete të larmishme
 - të marrin vendime, të bëjnë pyetje, diskutojnë dhe debatojnë
 - t'i dallojnë dhe t'u rezistojnë ndikimeve negative, paragjykimeve dhe stereotipeve
 - të kenë mundësi të mësojnë nga njëri-tjetri
 - të festojnë së bashku dhe të gëzojnë për të gjitha sukseset dhe arritjet
 - të kujdesen për njëri-tjetrin dhe të zgjidhin problemet në mënyrë jo të dhunshme
 - të marrin vendime, të bëjnë pyetje, të diskutojnë dhe të debatojnë
 - të njohin dhe t'i rezistojnë ndikimeve negative, paragjykimeve dhe stereotipeve
- Shkolla monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme arritjet e saj dhe, në përputhje me rrethanat, rishikon planet afatgjata dhe afatshkurtra.

DETYRAT E SHKOLLËS PAS MODULIT

- Përdorimi i të dhënave të mbledhura për statusin socio-ekonomik të nxënësve në shkollë për hartimin e draftit të parë të Planit të Veprimit të Shkollës (Zhvillimit), i cili përfshin fushat prioritare të punës së shkollës.
- Përfshirja në Planin e Veprimit/Zhvillimit të Shkollës e masave në lidhje me eliminimin e ndikimit të SES të ulët të nxënësve në arritjet arsimore
- Përcaktimi i qëllimeve SMART dhe detyrave për fushat prioritare
- Përcaktimi dhe zhvillimi i planeve të veprimit për qëllimet e përcaktuara të shkollës duke treguar qartë se si e promovon shkolla uljen e ndikimit të SSE të ulët në suksesin e nxënësve
- Identifikimi i treguesve për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të arritura

NJË PLAN PËR TË ARRITUR NJË SHKOLLË TË BAZUAR NË VLERA DHE NË MENDIMIN KRITIK

Ivona Čelebić and Amna Hodžić

ÇFARË ËSHTË PLANIFIKIMI?

"Mënyra më e mirë për të parashikuar të ardhmen është ta krijosh atë." Peter Drucker

Planifikimi është një proces që na lejon të zgjedhim nga opsionet ekzistuese dhe me burimet në dispozicion, për një periudhë të caktuar kohore, ato masa dhe hapa që do të na drejtojnë në mënyrën më të mirë në arritjen e qëllimit. Zgjedhja e masave dhe hapave si dhe radha e zbatimit të tyre, e cila duhet të jetë në funksion të prioriteteve të identifikuar që janë marrë në konsideratë më parë në procesin e analizës së situatës, është pjesë përbërëse e planifikimit. Në këtë rast, bëhet fjalë për një analizë të situatës në raport me qëllimet e shkollës bazuar në vlera dhe në mendimin kritik.

Planifikimi do të na lejojë të:

- përqëndrohemi tek qëllimet;
- të menaxhojmë një proces të strukturuar që përfshin një përshtatje fleksibël ndaj rrethanave që ndryshojnë;
- të kemi kontroll mbi arritjen e qëllimeve/detyrave

PLANIFIKIMI NUK ËSHTË VETËM NJË QËLLIM NË VETVETE, POR EDHE NJË MJET

Mjeti bazë për planifikimin e shkollës është plani i zhvillimit të shkollës. Planin e zhvillimit të shkollës bëhet në bazë të vlerësimit të nevojave dhe prioriteteve të marra përmes hulumtimit me pjesëmarrje.

Planin e zhvillimit të Shkollës bën të mundur:

- të bëhet një analizë të strukturuar të punës së shkollës,
- të iniciohet procesi i vetëvlerësimit të shkollës dhe përcaktimit të vazhdueshëm të prioriteteve për zhvillim,
- të mbledhen përvoja dhe mendime të të gjithë aktorëve përkatës në arsim për nevojat e shkollës dhe mënyrat për përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Planin e zhvillimit të shkollës shërben si udhërrëfyes për arritjen e qëllimeve të dëshiruara, si mjet i planifikimit të zhvillimit dhe si masë e zhvillimit sistematik dhe të vazhdueshëm të shkollës në një periudhë të caktuar kohore. Krijimi i zhvillimit të shkollës fillon pas një vetë-analize të detajuar dhe përcaktimit të prioriteteve të zhvillimit të shkollës, dhe përfshin mendimet e mbledhura të fëmijëve, prindërve/kujdestarëve, punonjësve të shkollës si edhe përfaqësuesve të komunitetit lokal ku ndodhet shkolla. Në procesin e vetëvlerësimit të situatës në shkollë, klima dhe kultura e shkollës janë parimet orientuese për përzgjedhjen e prioriteteve për zhvillim. Qëllimet e përcaktuara në planifikim lidhen me fushat prioritare të zhvillimit të shkollës. Ato duhet të shprehën qartë dhe të jenë lehtësisht të kuptueshme, specifike, të arritshme dhe të matshme. Përfundimisht, planin duhet të sigurojë një përmbledhje të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar të synimeve dhe aktiviteteve që duhen ndërmarrë për të përmirësuar kulturën, politikën dhe praktikën e shkollës, për të përfshirë të gjithë fëmijët në procesin arsimor dhe për të zhvilluar vazhdimisht cilësinë e arsimit. Në kontekstin e tij, ai mund të përmbajë një strategji afatgjatë (shumë-vjeçare) dhe afatshkurtër (një-vjeçare) të zhvillimit të shkollës.

Pse është i rëndësishëm planifikimi i zhvillimit të shkollës?

- shkollat kanë nevojë për një qasje sistematike ndaj planifikimit;
- shkollat janë organizata shumë komplekse;
- ndryshimi është sfida më e madhe për shkollat;
- Shkollat duan atë që është më e mira për nxënësit, stafin dhe komunitetin e gjerë


Planifikimi i zhvillimit të shkollës promovon:

- efikasitetin e shkollës;
- përmirësimin e shkollës;
- përmirësimin e cilësisë së punës në shkollë;
- zhvillimin e burimeve njerëzore;
- partneritet;
- përdorimin efikas të burimeve në dispozicion;
- Menaxhimin e ndryshimit;
- Përmirësimin e qëllimeve dhe prioriteteve të strategjive kombëtare të arsimit

Plani i zhvillimit të shkollës është një dokument zyrtar i shkollës, kështu që procesi i krijimit të tij është një proces zyrtar që duhet t'i jepet mandat nga Bordi i Shkollës. Prandaj, do të ishte e dëshirueshme të krijohej një dokument që do t'i informonte anëtarët e bordit të shkollës për procesin dhe arsyet pse u realizua ai. Planifikimi i zhvillimit të shkollës kryhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë një periudhe kohore dhe zakonisht ndahet në disa njësi të veçanta që përbëjnë Planin e Zhvillimit të Shkollës dhe kërkon disa hapa gradualë në zhvillimin e tij. Zgjidhjet sistematike në arsimin tonë, duke përfshirë futjen e planifikimit të zhvillimit të shkollës, hapësirën e hapur për iniciativat e shkollës, qëllimet e të cilave janë: inkurajimi dhe (ose) monitorimi i programeve të reja, cilësia e mësuesve, klima dhe kultura në shkollë në tërësi dhe përcaktimi i qëllimeve specifike strategjike dhe i politikave të shkollës.

Planifikimi i zhvillimit të shkollës është një proces që përcakton drejtimit, qëllimet, mënyrat dhe mjetet për arritjen e ndryshimeve të dëshiruara në nivel shkollë. Produkti i planifikimit të zhvillimit të shkollës është një dokument: Plani i zhvillimit të shkollës. Plani i zhvillimit të shkollës është një grup vendimesh se cilat aktivitete të qëllimshme do të ndërmerren dhe si do të zbatohen ato. Planifikimi cilësor është jashtëzakonisht i rëndësishëm sepse shumë shpesh ndodh që në shkolla të ndërmerren aktivitete të shumta pa arritur rezultate apo efekte veçanërisht të vlefshme. Planifikimi është gjithashtu i rëndësishëm për efikasitetin e burimeve. Më shumë kosto shpesh nuk garantojnë një rezultat më të mirë (Bezinović, 2010).

HAPAT NË PROCESIN E KRIJIMIT TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS



Ekipi i zhvillimit të shkollës

Faza përgatitore për hartimin e një plani të zhvillimit të shkollës bazuar në vlerat dhe mendimin kritik, si bazë për krijimin e një klime pozitive, dhe kulturës së shkollës, si hap i parë, përfshin formimin e Ekipit të Zhvillimit të Shkollës. Është e nevojshme të trajnohet ekipi i zhvillimit të shkollës për aktivitetet që kërkon plani i zhvillimit të shkollës.

Kush e përbën Ekipin e Zhvillimit të Shkollës

Përcaktimi i vizionit, analiza e palëve të interesuara dhe përcaktimi i qëllimeve strategjike janë disa nga çështjet që mund të kërkojnë përfshirjen e ekspertëve nga fusha të ndryshme. Ju mund t'i delegoni ata nga anëtarët e Bordit të Shkollës, përfaqësuesit e prindërve ose anëtarët e institucioneve brenda komunitetit lokal.

- Drejtori/Drejtoresha e shkollës
- Stafi profesional i shkollës (edukator/psikolog, sekretar i shkollës, Personi përgjegjës për përgatitjen e planit financiar të shkollës/buxhetit të shkollës) Stafi mësimor
- Një përfaqësues i prindërve
- Përfaqësues i Qeverisë së Nxënësve
- Përfaqësues i komunës/vetëqeverisjes lokale përgjegjës për arsimin
- Përfaqësues i komunitetit lokal

Përgatitja e ekipit të zhvillimit të shkollës

Në fillim, duhet të jetë e qartë se përse po krijohet/rishikohet Plan i Zhvillimit të Shkollës. Duhet të përcaktohet edhe ndarja e roleve dhe hapat e qartë në krijimin e këtij dokumenti të rëndësishëm. Është e nevojshme të përcaktohet një kornizë kohore e qartë dhe produktet e këtij procesi. Përgatitja e Ekipit të Zhvillimit të Shkollës duhet të përcaktojë qartë:

- Rolin e secilit anëtar të ekipit në lidhje me detyrat dhe aktivitetet specifike
- Vendimmarrjen brenda Ekipit të Zhvillimit të Shkollës
- Marrëveshje konfidencialiteti
- Marrëveshje për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të mundshme
- Mënyrat në të cilat rezultatet e planifikimit do të integrohen në dokumentet zyrtare të shkollës

ANALIZA E SITUATËS

Analiza është një mënyrë për të përfutur pamjen më të plotë dhe të saktë të realitetit. Analiza përfshin kërkime që do të japin përgjigje specifike për pyetje specifike (kërkim/studim parësor), anketa dhe intervista me përfaqësues të palëve të interesuara që do të shërbejnë për marrjen e informacionit për pozicionin e tyre, si dhe mbledhjen dhe përpunimin e statistikave dhe raporteve nga burime të ndryshme (kërkim/studim dytësor).

Është e nevojshme të fillohet planifikimi i zhvillimit të shkollës me një vlerësim diagnostik, që do të thotë, një analizë të situatës ekzistuese. Në këtë mënyrë merren parasysh gjendja aktuale e burimeve shkollë, avantazhet dhe disavantazhet e shkollës, mundësitë e zhvillimit dhe pengesat që mund ose nuk mund të kapërcehen. Gjetjet e kësaj analize përdoren për të formuluar politikën e zhvillimit dhe për të përcaktuar qëllimet dhe drejtimit e mundshme të zhvillimit. Planifikimi i aktiviteteve është zbatimi i politikave të zhvillimit, opsioneve dhe strategjive në aktivitete konkrete dhe të matshme. Ai specifikon qëllimet, rezultatet e dëshiruara, strategjitë, zbatuesit dhe afatet kohore.

Analiza e situatës nënkupton gjetje, që do të thotë, njohuri që shërbejnë si pikënisje e nevojshme në përcaktimin e Planit të Zhvillimit të Shkollës dhe të cilat arrihen me zbatimin e metodave të caktuara. Gjetjet e marra në këtë mënyrë integrohen në plan përmes qëllimeve, të cilat i përcaktojmë si gjendjen e ndryshuar të dëshiruar.

Analiza shërben:

- për të identifikuar problemet dhe për të fituar njohuri për atë që duhet të ndryshojmë;
- për qëllimin e (ri)përcaktimit të arsytimit të qëllimit;
- për përcaktimin e aktiviteteve specifike që duhet të zbatohen për të arritur objektivat;
- si referencë (ndoshta një fjalë tjetër) në planifikimin e mëtejshëm

Komponentët e mundshëm, por jo të vetmit, të analizës së situatës janë:

- analiza e palëve të interesuara
- analiza e situatës (shkollat dhe mjediset)
- Analiza SWOT
- analiza e problemit (pema e problemeve)

Në praktikë, këto analiza u paraprijnë të gjithë hapave të tjerë dhe duhet të kryhen në të njëjtën kohë në mënyrë shumë gjithëpërfshirëse në drejtim të përfshirjes së sa më shumë palëve të interesuara në proces. Analiza e problemit merr si pikënisje një ose më shumë aspekte negative të perceptuara të situatës aktuale. Në lidhje me çdo problem të identifikuar në këtë mënyrë, palët e interesuara përcaktojnë shkaqet dhe pasojat dhe kështu përcaktojnë së bashku problemin kryesor. Analizat që përdoren si opsion janë analiza e situatës, e cila tregon gjendjen aktuale të çdo fushe, analiza e kapaciteteve dhe burimeve, tendencave dhe palëve të interesuara dhe analiza e çështjeve të përgjithshme të secilës fushë në nivel shkollë.

Rezultatet e analizës japin një pasqyrë të funksionimit të shkollës, pikave të forta, të dobëta dhe burimeve të saj nga këndvështrime të ndryshme (mësues, prindër, nxënës, përfaqësues të komunitetit lokal) në të gjitha fushat në fillim të periudhës së zhvillimit dhe në mësimdhënie dhe aktivitete jashtëshkollore, trajnimi i mësuesve, organizimi i punës, menaxhimi, atmosfera dhe komunikimi, bashkëpunimi me komunitetin lokal. Rezultati i rishikimit të gjendjes aktuale është parakusht për identifikimin e nevojave të shkollës dhe mundëson përcaktimin e drejtimeve prioritare për zhvillimin e shkollës. Analiza SWOT mund të përdoret gjithashtu për të përcaktuar fushat prioritare. Prioritetet e zhvillimit të shkollës përcaktohen në lidhje me rëndësinë e tyre për zhvillimin e shkollës, në dritën e të gjithë faktorëve kontekstualë (të jashtëm, të brendshëm) dhe burimeve shkollore të disponueshme, të nevojshme për realizimin e tyre (financiare, materiale, njerëzore). Gjatë zgjedhjes së prioriteteve të zhvillimit të shkollës, duhet të merren parasysh nevojat e nxënësve, specifikat e shkollës, pikat e forta të shkollës, burimet që disponon, etj. Në zgjedhjen e prioriteteve të zhvillimit të shkollës, është i nevojshëm sigurimi i vazhdimësisë me praktikën e kaluar dhe atë të tashme dhe nivelin e zhvillimit, për të mundësuar stabilitet, i cili është themeli i zhvillimit të ardhshëm të shkollës. Për më tepër, kur vendoset për prioritetet ose përmirësimet e zhvillimit, Ekipi i Planifikimit të Zhvillimit të Shkollës duhet gjithashtu të marrë parasysh:

- pikat e forta të shkollës dhe fushat për përmirësim të identifikuar më parë në shkollë;
- fushat për përmirësim gjatë përcaktimit të jashtëm të cilësisë së punës arsimore të shkollës nga institucioni kompetent;
- fushat që lidhen me iniciativat lokale;
- një fushë me interes të veçantë për shoqërinë

ANALIZA E AKTORËVE/PALËVE TË INTERESUARA

Të gjithë nxënësit dhe mësuesit janë aktorë/palë të interesuara, por mund të jetë edhe çdo individ, grup njerëzish, shoqata, organizata, institucione dhe biznese që në një mënyrë kanë interes të drejtpërdrejtë ose jotë drejtpërdrejtë në punën e shkollës. Aktorët/Palët e interesuara mund të ndahen në dy grupe:

- Përdoruesit finalë (ata që përfitojnë drejtpërdrejt nga shërbimet e ofruara nga shkolla);
- Partnerët kryesorë (ata që në një mënyrë të caktuar marrin pjesë, kontribuojnë, ndikojnë ose kanë interes në ofrimin e shërbimeve për përdoruesit finalë së bashku me shkollën).

Procedura që duhet të zbatohet vazhdimisht në analizën e aktorëve/palëve të interesuara përbëhet nga fazat e mëposhtme:


- identifikimi i aktorëve/palëve të interesuara;
- kategorizimi i aktorëve/palëve të interesuara;
- hartimi i një metodologjie për mbledhjen e të dhënave për nevojat e aktorëve/ palëve të interesuara
- mbledhja e të dhënave;
- analiza e të dhënave të mbledhura - priorizimi i nevojave;
- përcaktimi me cilat grupe ose organizata bashkëpunon ose duhet të bashkëpunojë shkolla;
- përcaktimi se cilat janë modalitetet e atij bashkëpunimi dhe nëse ato janë të kënaqshme;
- përcaktimi nëse ka iniciativa dhe/ose projekte që po zbatohen me to ose do të zbatohen;

HAPAT NË PROCESIN E ANALIZËS SË AKTORËVE/PALËVE TË INTERESUARA

Identifikimi dhe kategorizimi i aktorëve/palëve të interesuara

Kushti i zhvillimit me pjesëmarrje është që palët e interesuara të kenë të drejtën për t'u përfshirë në planifikim dhe që mospërfshirja e tyre shpesh nënkupton dështimin e zhvillimit, sepse nuk do të marrin pjesë ose sepse

programi nuk ka gjasa të jetë i plotë nëse formulohet pa pjesëmarrjen e tyre. Bazuar në përkufizimin e aktorëve/palëve të interesuara, çdo shkollë bën një listë të palëve të interesuara dhe i identifikon ata. Për të kategorizuar aktorët/palët e interesuara, është e nevojshme që ata të identifikohen paraprakisht dhe të analizohen interesat, kufizimet dhe strategjitë e tyre të përfshirjes.



Ekipi i zhvillimit të shkollës plotëson një tabelë në të cilën fut të dhëna të përmbledhura për aktorët/palët e interesuara të identifikuar dhe të kategorizuara të shkollës.

Analiza e palëve të interesuara përfshin përcaktimin e:

- *Interesave të aktorëve/palëve të interesuara:*
 - Për të marrë pjesë në procesin e planifikimit të zhvillimit të shkollës në përgjithësi (p.sh., afirmimi i palës së interesuar brenda mjedisit shkollor; realizimi i ndikimit të palëve të interesuara në nivel shkollor ose komuniteti lokal; krijimi i një partneriteti me shkollën në të ardhmen; etj.)
 - për përfitimet që do të realizohen nga zbatimi i planit të zhvillimit të shkollës (p.sh., gjendja më e mirë e infrastrukturës në shkollë dhe mjedisi më i gjerë i saj; kompetenca më të larta të nxënësve pas diplomimit; siguri më e mirë në mjedisin shkollor; reduktim i kostove për përdorimin e burimeve; etj.)
- *Kufizimet që kanë aktorët/palët e interesuara:*
 - Interes i pamjaftueshëm
 - Kufizime në materiale

- Niveli i ulët i njohurive dhe aftësive
- Kufizime ligjore dhe institucionale
- Kundërshtim i mundshëm i interesit strategjik të palës së interesuar me procesin e hartimit të CSR-së
- *Strategjitë e përfshirjes:*
 - Në varësi të interesave dhe kufizimeve të listuara, duhet të përcaktohen një ose maksimumi dy strategji të përfshirjes së palëve të interesuara, të cilat mund të ndikojnë në shprehjen e interesave ose në heqjen e kufizimeve të palëve të interesuara, në mënyrë që të përfshihen në procesin e planifikimit strategjik.

Shtojca 1: Analiza e palëve të interesuara

Pjesëmarrësit	Interesat	Kufizimet	Strategjitë e gjithëpërfshirjes
...

Gjatë kategorizimit është e nevojshme të merren parasysh mendimet e vetë palëve të interesuara nëse dhe në çfarë mase është përshtatshme për ta veprimtaria e vetë shkollës. Kjo duhet mbajtur parasysh kur formuloni një pyetësor për nevojat e palëve të interesuara dhe të përfshini këtë lloj pyetjeje në pyetësor.

METODOLOGJIA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE MBI NEVOJAT E AKTORËVE TË NDRYSHËM/PALËVE TË INTERESUARA DHE DINAMIKËN E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Në kuadrin e zbatimit të konceptit të aktorëve/ palëve të interesuara në nivel shkolle, të gjithë qytetarët dhe të gjitha institucionet shfaqen, në fund të fundit, si palë të interesuara në punën e shkollës dhe si partnerë dhe/ose përdorues të shërbimeve të ofruara nga shkolla brenda kompetencave të saj. Megjithatë teorikisht një kategori e palëve të interesuara nuk duhet të jetë vendimtare në përcaktimin nëse do të bëhet apo jo një analizë e nevojave të atij grupi të interesuar, për qëllimet praktike të zhvillimit të një Plani Zhvillimi të Shkollës, palët e nevojshme të interesit kanë prioritet.

Palët e interesuara duhet të kuptojnë rolin e tyre dhe lidhjet shkakësore institucionale, domethënë të kuptojnë se ata kanë një interes konkret në punën e shkollës dhe se mund të kenë ndikim në atë punë. Vetëm kur të kuptojnë interesin e tyre, d.m.th. të përcaktojnë nevojat për të cilat institucioni i caktuar duhet të kontribuojë, dhe nga ana tjetër, qëllimet, kapacitetet dhe kufizimet e shkollës, të interesuarit mund të dalin me propozime realiste dhe konstruktive për të arritur një qëllim të përbashkët. Këto propozime më vonë në procesin e hartimit të Planit të Zhvillimit të Shkollës, përpunohen metodologjikisht në nivel qëllimesh dhe/ose aktiviteteve.

ANALIZA E SITUATËS (SHKOLLA DHE MJEDISI)

Duke përdorur metoda të tilla si analiza SWOT, analiza e situatës së shkollës, analiza organizative, funksionale

dhe të tjera, të dhënat mblidhen dhe analizohen me qëllim që të merren të dhëna në mënyrë objektive për gjendjen aktuale të shkollës dhe mjedisin në të gjitha aspektet e nevojshme për planifikimin operacional.

Analiza e gjendjes së shkollës dhe e mjedisit përdoret për të marrë parasysh:

- kapacitetin e shkollës në lidhje me qëllimin afatgjatë të përcaktuar dhe kompetencën e shkollës;
- mjediset në të cilat funksionon shkolla, d.m.th., mundësia që shkolla të pozicionohet në raport me tendencat lokale, por edhe me trendet globale, rajonale dhe kombëtare që mund të kenë ndikim në aktivitetet brenda kompetencës së institucionit.

ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një proces i identifikimit të pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe rreziqeve dhe shërben për të vlerësuar gjendjen dhe perspektivat e shkollës dhe gjendjen e mjedisit në të cilin shkolla funksionon. Rezultatet e analizës SWOT ndihmojnë për përcaktimin e qëllimeve. Është e nevojshme të shfrytëzohen avantazhet dhe mundësitë që organizata tashmë i ka. Qëllimet e planifikuara duhet të jenë të shkruara qartë, koncize dhe të kuptueshme për punonjësit dhe komunitetin e gjerë.

Analiza SWOT është një teknikë që vlerëson dhe percepton në mënyrë reale pikat e forta (përparësitë) dhe dobësitë/pikat për përmirësim të shkollës dhe mundësitë dhe rreziqet e jashtme (kërcënimet) për të parë mënyrat e mundshme për të kapërcyer dobësitë individuale, duke përdorur pikat e forta (përparësitë) dhe duke reduktuar rreziqet individuale (kërcënimet) duke shfrytëzuar mundësitë.

Çështjet që lidhen me pikat e forta (përparësitë) duhet të merren parasysh nga perspektiva juaj (shkolla, nxënësit, punonjësit, prindërit) dhe nga këndvështrimi i atyre me të cilët punoni (aktorët kryesorë) dhe të bëni një listë të karakteristikave tuaja sa më realiste;

Çështjet që lidhen me dobësitë duhet të konsiderohen edhe nga këndvështrimi i brendshme edhe i jashtëm. Duhet të jeni realistë në njohjen e të dy grupeve.

Disa nga pyetjet e përdorura gjatë rishikimit të pikave të forta dhe atyre për përmirësim janë:

- A shohin të tjerët tek ju dobësi që ju nuk i shihni vetë?
- Çfarë mund të rregulloni?
- Çfarë nuk po bëni siç duhet?
- Çfarë duhet të shmangni?

Pikat e forta dhe të dobëta përfaqësojnë aspektet ose karakteristikat e brendshme të shkollës dhe lidhen me të tashmen.

Mundësitë dhe rreziqet tregojnë faktorë të jashtëm që mund të ndikojnë në shkollë në një të ardhme të parashikueshme dhe që shkolla duhet t'i ketë parasysh kur planifikon aktivitetet e saj.

Disa nga pyetjet e përdorura gjatë shqyrtimit të mundësive janë:

- Çfarë shihni si mundësi të mira?
- Çfarë tendencash pozitive keni vënë re në mjedis?

Pyetjet bazë që përdoren zakonisht në perceptimin e rreziqeve janë:

- Çfarë vështirësish hasni?
- A mund të kërcënojnë ndryshimet në shoqërinë e gjerë statusin aktual të shkollës suaj? Cila dhe në çfarë mase?

Prilog 2: SWOT analiza

Tabela për analizën SWOT përfshin të gjitha pikat tona të forta dhe të dobëta, të shprehura saktësisht dhe spontanisht, pa (vetë) censurë midis anëtarëve të ekipit, në mënyrë që të shmangen gabimet e mëposhtme:

- Kur njohim pikat e forta, disa cilësi merren si të mirëqena, ato janë aty dhe ,me kalimin e kohës, nuk i regjistrojmë dhe nuk i vlerësojmë më, i përdorim gjithnjë e më pak dhe i anashkalojmë.
- Kur i njohim dobësitë, disa fshihen, injorohen ose askush nuk flet për to.

<p>PIKAT E FORTA</p> <p>Nën kontrollin tonë</p> <p>Burimet (kapacitetet) që kemi në dispozicion dhe i përfshijmë në Planin tonë të ZHVillimit të Shkollës. Ato mund të jenë njerëzore, materiale, financiare.</p> <p>P.sh., përvoja dhe njohuritë në punën me grupe të caktuara të synuara (përcaktoni saktësisht se cilat njohuri dhe cilat grupe të synuara) marrëdhënie e mirë me prindërit, nxënësit, komunitetin lokal, hapësira e punës, pajisjet, fondet për zbatimin e disa aktiviteteve që shkolla planifikon të zbatojë.</p>	<p>DOBËSITË/PIKAT PËR PËRMIRËSIM</p> <p>Nën kontrollin tonë</p> <p>Ato që na mungojnë në kapacitete dhe burime dhe duhet të ndryshojnë (p.sh., duke mësuar) ...</p> <p>P.sh., njohuri shtesë që do të përmirësonin cilësinë e punës në shkollë, numri i bashkëpunëtorëve profesionalë shtesë, pajisjet që mungojnë, shpenzimet që është e pamundur të përballohen.</p>
<p>OPORTUNITETET (mundësitë)</p> <p>Ato nuk janë nën kontrollin tonë</p> <p>Përfitimet/supozimet në mjedis, të cilat mund t'i përdorim në veçanti për të mbledhur më tej informacionin e nevojshëm, zbatimin me sukses i aktiviteteve të planifikuara. P.sh., proceset reformuese në arsim që mundësojnë inovacion, bashkëpunimi me sektorin e OJQ-ve krijon mundësi të reja për akses në fonde të tjera dhe zëvendësim të burimeve.</p>	<p>PENGESAT (kërcënimet)</p> <p>Ato nuk janë nën kontrollin tonë</p> <p>Rreziqe që duhet t'i kemi parasysh, sepse mund të rrezikojnë planin ose projektin tonë. P.sh. Mungesa ose heqja e fondeve, ndryshimi i autoriteteve vendore, etj.</p>

Pikat e forta dhe të dobëta janë sigurisht nën kontrollin tonë: ne i vëmë në funksion të plotë pikat e forta dhe për dobësitë ne e dimë se çfarë veprimesh duhen ndërmarrë për t'i zbutur ose eliminuar ato. Kur mendojmë për mundësitë dhe pengesat, duhet të kemi kujdes që të mos i supozojmë gjërat në mjedis, qofshin ato si mundësi apo si pengesa. Kjo analizë mund ta inkurajojë ekipin të hartojë aktivitete që mund të zvogëlojnë rreziqet e mundshme në mjedis.

ANALIZA E PROBLEMIT (PEMA E PROBLEMIT)

Analiza e problemit është një parakusht për përcaktimin e saktë të qëllimeve dhe rrjedhimisht një parakusht për arritjen e suksesshme të tyre. Për qëllime analize, një pemë e problemeve përdoret për të ndihmuar në gjetjen e zgjidhjeve për një problem duke hartuar anatominë e shkakut dhe pasojave që lidhen me një problem.

Qasja e zgjidhjes së problemit duke zgjidhur këtë metodë ka disa përparësi:

- problemi mund të ndahet në pjesë më të vogla,
- përfitohet një kuptim më i qartë i problemit dhe shkaqeve të tij
- ndihmon në identifikimin e problemeve bazë dhe argumentet e tyre
- në rastin e pjesëve të paqarta të problemit, tregon nevojën për informacion, prova ose burime shtesë për të zhvilluar një zgjidhje të qartë
- zgjidhen problemet aktuale, jo ato nga e kaluara apo e ardhmja
- procesi i analizës së problemit kontribuon në të kuptuarin më të mirë të tij.

Analiza e problemit është më efektive kur punohet në grupe të vogla, ku hapi i parë është gjithmonë diskutimi dhe identifikimi i problemit që do të analizohet. Pas identifikimit të problemit kryesor, vijon identifikimi i shkaqeve që përfaqësojnë rrënjët e pemëve. Së fundmi, identifikohen pasojat e problemit, që janë degët e pemës. Një paraqitje e tillë grafike na lejon të kuptojmë problemin si një marrëdhënie shkak-pasojë e lidhur me problemin kryesor. Mjeti bazë që përdor grupi gjatë shqyrtimit të problemeve dhe marrëdhënieve shkak-pasojë është diskutimi, i cili lind pas dakordësimit mbi shkaqet dhe pasojat.

Pyetjet bazë që përdoren zakonisht kur krijohet një pemë problemi janë:

- Cilat janë shkaqet kryesore të problemit?
- Cilat janë shkaqet kryesore të problemit?
- Cilat janë pasojat e këtij problemi?

Problemi është ai që perceptohet si burim pakënaqësie apo efikasiteti të ulët, pengesë për përmbushjen e qëllimeve/detyrave të dëshiruara.


Analiza e problemit–baza për përcaktimin e qëllimeve

Analiza e problemit merr si pikënisje një ose më shumë aspekte negative të perceptuara të situatës aktuale. Analiza e problemit përfshin:

- Përcaktimin e kornizës dhesubjektit të analizës
- Identifikimin e problemeve bazë me të cilat përballen grupet e synuara dhe përdoruesit
- Vizualizimin e problemit në formën e një diagrame, të njohur si pema e problemit
- Në lidhje me çdo problem të identifikuar në këtë mënyrë, palët e interesuara përcaktojnë shkaqet dhe pasojat dhe së bashku identifikojnë problemin kryesor.


Hapat në realizimin e analizës së problemit:

- Përcaktoni një çështje kyç për të zhvilluar analizën;
- Diskutoni çështje që palët e interesuara kanë identifikuar dhe që lidhen me problemin e përcaktuar më sipër;
- Filloni të krijoni një lidhje midis shkakut të problemit dhe pasojave që ai shkakton duke renditur problemet që shkaktojnë drejtpërdrejt problemin kyç “në rrënjë” dhe problemet që lindin si rezultat i problemit kyç “kurore”.
- Përgjigjuni pyetjes: “Cili është shkakut i asaj që ndodhi?” duke vazhduar të ndiqni problemet në të njëjtën linjë logjike;



- Problemet më pas lidhimi me shigjeta me pasojat e tyre;
- Kur të përfundojë përkufizimi i problemit, e gjithë pema e problemit shndërrohet në një pemë qëllimi. Në këtë mënyrë, në pjesën e poshtme të pemës do të kemi të përcaktuara qëllime më të përgjithshme (strategjike), kurse në pjesën e sipërme rezultatet që arrihen me arritjen e qëllimit të caktuar.
- Rezultati i ushtrimit, i paraqitur grafikisht si e ashtuquajtura “pemë e problemit” ofron një pamje të fortë por të shjeshtë të realitetit dhe pema synon një pamje të situatës së dëshiruar.

Shtojca 3: Një shembull i analizës së problemit nëpërmjet teknikës së “pemës së problemit”



PËRCAKTIMI I FUSHAVE TË PRIORITETIT

Suksesi i funksionimit të shkollave varet nga një sërë faktorësh dhe aktivitetet që veprojnë në to. Analiza SWOT e gjendjes dhe e mundësive për zhvillim të shkollës e bën të lehtë identifikimin e avantazheve, disavantazheve, mundësive dhe vështirësive me të cilat përballen shkollat në funksionimin e tyre aktual. Duke identifikuar fushat prioritare për përmirësim, fillon procesi i zhvillimit të një plani zhvillimi të shkollës. Prioritetet e zhvillimit të shkollës përcaktohen në lidhje me rëndësinë e tyre për zhvillimin e shkollës, në dritën e të gjithë faktorëve kontekstualë (të jashtëm, të brendshëm) dhe burimeve shkollore të disponueshme, të nevojshme për realizimin e tyre (financiare, materiale, njerëzore). Gjatë zgjedhjes së prioritetit të zhvillimit të shkollës, duhet të merren parasysh nevojat e nxënësve, specifikat e shkollës, pikat e forta të shkollës, burimet që disponon, etj. Kur vendoset për prioritetet e zhvillimit ose përmirësimet, Ekipi i Planit të Zhvillimit të Shkollës duhet të marrë parasysh gjithashtu:

- pikat e forta të shkollës dhe fushat për përmirësim të identifikuar më parë në shkollë;
- të identifikojë fushat për përmirësim gjatë vlerësimit të jashtëm të cilësisë së punës së shkollës nga institucioni kompetent;
- fushat që lidhen me iniciativat kombëtare ose lokale;
- fushat me interes të veçantë për shoqërinë, si fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, fëmijët në nevojë etj.

Fushat e prioritetit janë njësi tematike në të cilat shkollat duhet të iniciojnë ndryshime. Përcaktimi i fushave të prioritetit është pikënisja për planifikimin strategjik të zhvillimit të ardhshëm të shkollës. Pas përcaktimit të fushave të prioritetit, shkolla vendos një qëllim të përgjithshëm për atë fushë dhe një ose më shumë synime/detyra specifike brenda saj.

Shtojca 4: Paraqitja e matricës së Planit të Zhvillimit të Shkollës**EMRI I SHKOLLËS:**

Logoja / imazh i shkollës

**PLANI I VEPRIMIT / ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS
202__-202__.
KLIMA DHE KULTURA****Punonjësit e shkollës**

Profili profesional	Numri
Stafi mësimdhënës	
Shërbimi profesional i shkollës (pedagogë / psychologë/ punonjës socialë/ edukator special ...)	
Staf administrativ dhe financiar	
Staf teknik ndihmës	
Të tjerë(specifikoni)	
Numri total i punonjësve	

Nxënësit

Të dhënat	Viti shkollor 20__/__			Sviti shkollor 20__/__			Viti shkollor 20__/__		
Numri total i nxënësve									
Numri i nxënësve që e kanë përfunduar shkollën:									
Numri i nxënësve të regjistruar									
Numri i nxënësve në shkollat vartëse									
Numri i klasave në 202_/202_	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Numri i departamenteve në 202_/202_									


Na kontaktoni:

Emri i plotë i shkollës	
Shkollat vartëse	
Adresa:	
Telefon / Fax:	
Web-site:	
E-mail:	

PËRMBAJTJA

LETËR NGA DREJTORI	3
Anëtarët e Ekipit të Zhvillimit të Shkollës.....	3
VIZIONI I SHKOLLËS- çfarë lloj shkolle duam të krijojmë.....	4
MISIONI I SHKOLLËS - çfarë bëjmë për të realizuar vizionin tonë.....	4
VLERAT E SHKOLLËS- vlerat kryesore që promovon shkolla	4
Konteksti.....	5
Të dhëna specifike.....	5
ARRRITJET NË PERIUDHËN E MËPARSHME.....	6
ANALIZA E SITUATËS.....	7
STANDARDET E KLIMËS DHE KULTURËS.....	8 - 14
PRIORITETET KRYESORE.....	14
PLANI I VEPRIMIT.....	16

LETËR NGA DREJTORI/DREJTORESHA



ANËTARËT E EKIPIT TË VEPRIMIT/ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS

1. ...
2. ...
3. ...
4. ...
5. ...
6. ...
7. ...
8. ...
9. ...



VIZIONI I SHKOLLËS – një pamje e së ardhmes së dëshiruar

MISIONI I SHKOLLËS - Çfarë bëjmë për të realizuar vizionin tonë

VLERAT E SHKOLLËS – vlerat kryesore që promovon shkolla

KONTEKSTI – karakteristikat e komunitetit dhe të dhëna nga shkolla

KARAKTERISTIKA TË KOMUNITETIT KU NDODHET SHKOLLA:

Informacion specifik për shkollën (viti shkollor 202_/2_):

Fusha	Të dhëna	Koment
Arritjet akademike (nota mesatare):		
Numri i nxënësve që përsërisin klasën		
Numri i nxënësve që ndjekin PEI (Planet e Edukimit Individual) në shkollë		
Numri i nxënësve që marrin asistencë sociale		
Numri i fëmijëve me një prind ose të dy prindërit të papunësuar		
Numri i fëmijëve pa kujdesin prindëror		
Numri i fëmijëve që kanë braktisur shkollën		
Numri total i mungesave:		
Numri i mungesave pa arsye		
Numri i masave disiplinore të marra:		
Numri i aktiviteteve jashtëshkollore/ ekstrakurrikulare:		
Numri i nxënësve të përfshirë në aktivitete jashtëshkollore/ ekstrakurrikulare		

ARRITJET NË PERIUdhËN E MËPARSHME

Arritjet/sukseset më të rëndësishme të shkollës:



ANALIZA E SITUATËS

KLIMA DHE KULTURA

Fushat për t'u analizuar:

- I. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT E PËRBASHKËTA TË SHKOLLËS**
- II. NDJENJA E SIGURISË DHE E PËRKATËSISË NË KOMUNITETIN E SHKOLLËS**
- III. PLANI I PUNËS I BAZUAR NË MONITORIM DHE VLERËSIM**
- IV. PARTNERITETI ME FAMILJET DHE KOMUNITETIN**
- V. TPROCESI I MËSIMDHËNIES DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE**
- VI. RREGULLAT DHE PROCEDURAT QË DREJTOJNË KLIMËN DHE KULTURËN**

REZULTATET E PËRMBLEDHURA:

FUSHA 1: MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT E PËRBASHKËTA TË SHKOLLËS

Pikat tona të forta:

Fushat për përmirësim:

Informacion shtesë që na duhet:

Aktivitete të mundshme:

FUSHA 2: NDJESIA E SIGURISË DHE PËRKATËSISË NË SHKOLLË

Pikat tona të forta:

Fushat për përmirësim:

Informacion shtesë që na duhet:

Aktivitete të mundshme:

FUSHA 3: PLANI I PUNËS I BAZUAR NË MONITORIM DHE VLERËSIM

Pikat tona të forta:

Fushat për përmirësim:

Informacion shtesë që na duhet:

Aktivitete të mundshme:

FUSHA 4: PARTNERITETI ME FAMILJET DHE KOMUNITETIN

Pikat tona të forta:

Fushat për përmirësim:

Informacion shtesë që na duhet:

Aktivitete të mundshme:

FUSHA 5: PROCESI I MËSIMDHËNIES DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE

Pikat tona të forta:

Fushat për përmirësim:

Informacion shtesë që na duhet:

Aktivitete të mundshme:

AREA 6: REGULLAT DHE PROCEDURAT QË DREJTOJNË KLIMËN DHE KULTURËN

Pikat tona të forta:

Fushat për përmirësim:

Informacion shtesë që na duhet:

Aktivitete të mundshme:



FUSHAT E PRIORITETEVE

FUSHT DHE PRIORITETET	
I.	MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT E PËRBASHKËTA TË SHKOLLËS
PRIORITETI:	
II.	NDJENJA E SIGURISË DHE PËRKATËSISË NË KOMUNITETIN E SHKOLLËS
PRIORITETI:	
III.	PLANI I PUNËS I BAZUAR NË MONITORIM DHE VLERËSIM
PRIORITETI:	
IV.	PARTNERITETI ME FAMILJET DHE KOMUNITETIN
PRIORITETI:	
V.	PROCESI I MËSIMDHËNIES DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE
PRIORITETI:	
VI.	RREGULLAT DHE PROCEDURAT QË DREJTOJNË KLIMËN DHE KULTURËN
PRIORITETI:	

PRIORITETET NË VITIN SHKOLLOR 202_ / 202_

	Prioritetet	Fushat
Prioriteti 1		
Prioriteti 2		

ANALIZA E PRIORITETEVE

PRIORITETI 1:			
ÇËSHTJET KYÇE / PROBLEMET NË KËTË FUSHË:			
SHKAKU I PROBLEMIT	PASOJAT E PROBLEMIT	Çfarë na duhet të dimë tjetër për këtë problem?	Si do t'i mbledhim të dhënat shtesë dhe nga kush?

PLANI I VEPRIMIT TË ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS: SI DHE MBI Ç'BAZË T'I PËRCAKTOJMË QËLLIMET?

Në bazë të prioriteteve të përcaktuara, përcaktohen synimet/qëllimet afatgjata dhe afatshkurtra, të cilat duhet të tregojnë se çfarë duhet të arrihet dhe çfarë po përmirësohet. Objektivat duhet të jenë të qarta, të matshme, të synojnë përmirësimin e klimës dhe kulturës, ose më konkretisht, cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve dhe përmirësimin e arritjeve të nxënësve, me përfshirjen e mësuesve, nxënësve dhe prindërve. Procesi i planifikimit fillon me përcaktimin e qëllimit si një deklaratë e gjendjes së ndryshuar të dëshiruar, të cilën ne e aspirojmë dhe në realizimin e së cilës varen të gjithë parametrat e tjerë të planit.

PLANI I VEPRIMIT

Për të arritur qëllimet afatgjata dhe afatshkurtra, zhvillohen planet e veprimit. Plani i veprimit tregon: QËLLIMIN AFATGJATË - çfarë duam të arrijmë për një periudhë më të gjatë kohore; QËLLIMI / DETYRAT SPECIFIKE - çfarë duam të arrijmë në një periudhë më të shkurtër kohore; AKTIVITET - çfarë duhet të bëjmë për të arritur një qëllim të caktuar; KORNIZA KOHORE - për secilin nga aktivitetet; PËRGJEGJËSIA - kush është përgjegjës për secilin nga aktivitetet; KORNIZA KOHORE - kur të punohet për secilin nga qëllimet; BURIMET - çfarë burimesh na nevojiten për të arritur qëllimet tona.

Në funksion të përgjithësisë dhe specifikës:

- ka një synim të përgjithshëm ku vetëm shkolla kontribuon në realizimin e tij, por së bashku me të gjithë aktorët e tjerë;
- ekziston një qëllim specifik, realizimi i të cilit varet ekskluzivisht nga shkolla.

Qëllimet (detyrat) afatgjata dhe afatshkurtra të përcaktuara S.M.A.R.T

Secili nga prioritetet e zhvillimit të shkollës duhet të përcaktojë një ose më shumë synime që shkolla dëshiron t'i arrijë brenda asaj fushe. Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe kohën, qëllimet mund të jenë afatgjata dhe afatshkurtra (të quajtura edhe qëllime ose detyra specifike). Është e rëndësishme të theksohet se qëllimet specifike të shkollës duhet të harmonizohen me qëllimin afatgjatë të shkollës dhe se realizimi i qëllimit specifik kontribuon në realizimin e qëllimit strategjik afatgjatë të shkollës. Qëllimet afatshkurtra/specifike tregojnë ndryshimet që ndodhin në një interval më të shkurtër kohor. Parimet themelore të krijimit të qëllimit të duhur:

S.M.A.R.T

Kur vendosni secilin qëllim, duhet t'i kushtohet vëmendje parametrave që i japin përgjigje të mëposhtme:

A është **S**pecifik?

A është i **M**atshëm?

A është i **A**rritshëm?

A është **R**elevant/ i përshtatshëm?

A është (**T**ime-bound)i kufizuar në kohë?

Gjatë krijimit të qëllimeve, është e nevojshme të merren parasysh rezultatet e analizës. Të drejtuar nga parimi i S.M.A.R.T. çdo qëllim duhet të përfshijë të paktën tri nga këto pesë karakteristika në përkufizimin e tij. Do të ishte e dëshirueshme që qëllimet të renditeshin sipas rendit kronologjik dhe logjik, duke pasur parasysh se përgjegjësia për realizimin e qëllimit është e shkollës.

Qëllimet e përcaktuara siç duhet u përgjigjen pyetjeve se cilat ndryshime dhe përmirësime duhet të arrihen, cilat janë rezultatet e pritshme të këtyre ndryshimeve dhe si do të ndikojnë këto ndryshime në zhvillimin e shkollës në tërësi.

Qëllimet specifike të shkollës duhet të jenë në përputhje me qëllimin (ose qëllimet) afatgjatë të shkollës dhe nëpërmjet tij, me prioritetet dhe ligjet vendore të përcaktuara nga kompetencat.

Për të arritur qëllimet, është e nevojshme të hartohen aktivitete, grupi i të cilave përfundimisht do të çojë në arritjen e qëllimit të dëshiruar.

Aktivitetet janë një serë hapash që duhet të kryhen për të realizuar një qëllim/detyrë specifike.

Operacionalizimi i treguesve të qëllimeve të arritura me sukses

Treguesit e suksesit janë parametra që shërbejnë për të përshkruar qëllimet/detyrat specifike në një mënyrë të matshme operacionale (sasi, cilësi, kohë). Ata përcaktohen në nivelin e qëllimit/objektivit specifik (treguesit e synuar) duke përcaktuar një ose më shumë tregues për çdo qëllim dhe në nivel aktivitetesh (treguesit e procesit dhe/ose rezultateve). Treguesit përdoren gjatë zbatimit të planit të zhvillimit të shkollës (monitorimi) për të monitoruar shkallën e realizimit të një qëllimi/detyrë të caktuar dhe për të përcaktuar nëse qëllimi është arritur dhe/ose në çfarë mase është arritur.

TREGUESIT E SUKSESIT

Treguesit janë shënues, fakte, informacione, masa, të cilat shërbejnë për të përshkruar qëllimet dhe aktivitetet e planit në mënyrë të matshme operacionale (sasi, cilësi, kohë), për të matur në mënyrë cilësore (përshkruese) dhe sasiore (në mënyrë të matshme) situatën e ndryshuar, aktivitetet e përfunduara dhe arritjen e qëllimeve.

Ata janë formuluar në përgjigje të pyetjeve të mëposhtme:

- Si do ta kuptojmë nëse ajo që kemi planifikuar po realizohet vërtet apo jo?
- Deri në çfarë mase është arritur?

Funksioni themelor i treguesit është:

- Vlerësimi (matja) e progresit në arritjen e qëllimit apo qëllimeve të përcaktuara
- Lehtësimi i komunikimit për arritjet pozitive ose negative në arritjen e qëllimeve të përcaktuara me bartësit e vendimmarrjes (politike), administratën, komunitetin shkencor.
- Ofrimi i udhëzimeve thelbësore për procesin e vendimmarrjes

Llojet e treguesve:

- Treguesit e rezultateve - na lejojnë të vlerësojmë qëllimet e arritura në lidhje me atë që është investuar, p.sh., numrin dhe llojin e mekanizmave të vendosur për bashkëpunimin me prindërit.
- Treguesit e ndikimit - na tregojnë një rezultat më të gjerë/afatgjatë të masave të marra, p.sh., përqindja e nxënësve me arritje mbi mesataren në testin kombëtar në matematikë;
- Treguesit e procesit - na lejojnë të shohim se çfarë masash dhe aktivitetesh janë ndërmarrë, për shembull: Formimi i ekipit për zhvillimin e shkollës, miratimi i planit të zhvillimit të shkollës për periudhën e ardhshme pesë-vjeçare;
- Treguesit e synuar - na lejojnë të përcaktojmë dhe të shohim qëllimet/detyrat, p.sh., 50% e mësuesve të trajnuar për të zhvilluar të menduarit kritik tek fëmijët deri në fund të vitit shkollor 2021

Treguesi i synuar / Targeti/Synimi - Përfaqëson rezultatin që presim të marrim në fund të programit ose aktivitetit. Është vendosur në lidhje me qëllimin.

Në mënyrë që treguesi të përcaktohet SMART, duhet të përcaktohet burimi i të dhënave dhe burimi i verifikimit, duhet të përcaktohet dinamika e mbledhjes së të dhënave, përcaktimi i përgjegjësive dhe përcaktimi i burimeve të nevojshme.

IDENTIFIKIMI I BURIMEVE TË NEVOJSHME PËR TË ARRITUR QËLLIMET

Shkurtimisht, do të kalojë nëpër llojet e burimeve të nevojshme për të arritur qëllimet (njerëzore, financiare, materiale, e të tjera). Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të kuptojnë pse është e nevojshme të identifikohen burimet e financimit për aktivitete të caktuara, të përcaktojnë nëse ato janë vërtet të disponueshme dhe nëse ato mund të vihen në dispozicion.

Shtojca 5: Plani i Veprimit

Prioriteti 1:								
Qëllimi i përgjithshëm (rezultatet që duam të arrijmë):								
	Gjendja Aktuale Nga ku fillojmë?	Akrivitetet dhe metodat Çfarë do të bëjmë?	Detyrat Kush?	Afatet kohore Kur?	Burimet e nevojshme Për çfarë kemi nevojë?	Treguesit e performancës Çfarë do të tregojë që e kemi arritur qëllimin?	Si ta monitorojmë dhe ta dokumentojmë? Si do ta regjistrojmë/shënojmë progresin?	
Objektivi specifik 1 (hapi për arritjen e qëllimit)								
Objektivi specifik 2								

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PROGRESIT DHE ARRITJEVE TË SHKOLLËS

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Zhvillimit të Shkollës

Në këtë kapitull dhe pjesët e tij trajtohen objektivat e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit të zhvillimit të shkollës, metodat dhe teknikat, si edhe përdorimin e rezultateve të këtyre dy proceseve.

Është shumë e rëndësishme që i gjithë procesi i zbatimit të planit të zhvillimit të shkollës të monitorohet dhe kontrollohet përmes procesit të monitorimit dhe vlerësimit. Për këtë arsye, monitorimi dhe vlerësimi përfaqësojnë fazën shoqëruese dhe përfundimtare që ndikon në cilësinë e zbatimit të këtij procesi. Në këtë mënyrë, menaxhimi i planit të zhvillimit të shkollës zbatohet në mënyrë shumë komplekse, por duke përmirësuar cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet në mënyrë efikase dhe efektive.

Çdo aktivitet duhet të matet saktë për të arritur cilësi. Niveli i cilësisë duhet të përcaktohet përmes organizatës/institucionit. Dëshmia e cilësisë duhet të deklarohet dhe secila nga aspektet e saj, dhe më pas të reagohet aty ku është e nevojshme. Mund të përdoren një sërë mënyrash për të matur zbatimin e aktiviteteve dhe procedurave të Planit të Zhvillimit të Shkollës. Formalizimi i sistemit të matjesrealizon monitorimin dhe matjen e vazhdueshme të suksesit dhe aftësinë për të reaguar, përpara se të ndodhë dështimi (Farooq, 2007).

PËRKUFIZIMI, OBJEKTIVAT DHE RËNDËSIA E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit të zhvillimit të shkollës është mbledhja sistematike e të dhënave, monitorimi dhe mbikëqyrja e procesit të zbatimit të tij dhe vlerësimi i suksesit të planit të zhvillimit nga pikëpamja e arritjes së qëllimeve të përcaktuara strategjike dhe prioritare. Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit është të monitorohet progresi, përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të CSR-së, por edhe të propozohen ndryshime në aktivitete bazuar në gjetjet dhe vlerësimet.

Monitorimi dhe vlerësimi, zbatimi i planit të zhvillimit të shkollës, përfshijnë një pamje gjithëpërfshirëse të përmbushjes së aktiviteteve, detyrave dhe qëllimeve specifike, qëllimeve strategjike dhe specifike si më poshtë:

- Monitorimi i procesit të zbatimit të planit të veprimit (nëse janë zbatuar aktivitetet e planifikuara dhe nëse burimet janë alokuar dhe përdorur në mënyrë efektive);
- Monitorimi i rezultateve të aktiviteteve (efektet- rezultatet e aktiviteteve në lidhje me burimet e investuara);
- Vlerësimi i progresit në arritjen e qëllimit (misioni dhe qëllimet strategjike të strategjisë);
- Vlerësoni ndikimin e planit të zhvillimit tek nxënësit, prindërit, mësuesit dhe komuniteti lokal.

Monitorimi

Kjo është një mënyrë për të kontrolluar dhe për të përcaktuar nëse plani është duke u zbatuar dhe për të vlerësuar se sa mirë po zbatohet ai, në mënyrë që veprimet korrigjuese të mund të ndërmerren sa më shpejt që të jetë e nevojshme. Monitorimi mund të zvogëlojë humbjen e kohës dhe përpjekjeve. Monitorimi çon në përshtatjen, plotësimin dhe korrigjimin e të gjitha aspekteve të planit. Procedurat e monitorimit përfshijnë:

- takime rishqyrtimi (të gjithë punonjësit ose grupet e vogla) për të diskutuar progresin mbi kriteret e suksesit, për të theksuar vështirësitë, për të propozuar zgjidhje për problemet;
- diskutime joformale ose diskutime formale me pjesëmarrësit e shkollës ose partnerët e interesuar jashtë shkollës, me qëllim për të marrë komente mbi aktivitetet, vonesat, burimet e nevojshme dhe afatet e takimit;
- vëzhgimin nga një "mik-kritik" (një "i huaj" me përvojën përkatëse);
- përdorimin e i instrumenteve të pranuar të vlerësimit në nivele të përcaktuara brenda kornizës kohore në plan.

Në fazën e zbatimit kryhen aktivitetet e përcaktuara në planin e veprimit; vendosen procedura që do të mundësojnë ofrimin e mbështetjes për mësuesit dhe personat e tjerë të përfshirë në aktivitete të caktuara në kuadër të detyrave. Në fazën e zbatimit, monitorimi është i rëndësishëm për të siguruar zbatimin efektiv. Monitorimi vlerëson gjithashtu nëse zbatimi i Planit po ecën sipas planit dhe nëse ka nevojë për korrigjime në

drejtim të plotësisht apo ndryshimit të disa elementeve të Planit.

Vlerësimi

Në fund të ciklit të zbatimit të zhvillimit të shkollës, është e rëndësishme që komuniteti i shkollës të vlerësojë suksesin e zbatimit në arritjen e qëllimeve dhe qasjen ndaj nevojave të zhvillimit të shkollës. Procesi i vlerësimit vlerëson shkallën në të cilën ka qenë e mundur të arrihen ose të realizohen qëllimet e renditura në secilën nga fushat prioritare të zhvillimit.

Monitorimi i zbatimit të planit të zhvillimit të shkollës

Monitorimi i zbatimit të planit të zhvillimit të shkollës është një mënyrë për të kontrolluar dhe përcaktuar nëse plani është duke u zbatuar dhe sa mirë po zbatohet ai në mënyrë që të ndërmerren menjëherë aktivitetet e nevojshme për korigjim. Raportet e monitorimit do të bazohen në:

- Takime për të diskutuar rezultatet e arritura, për të theksuar vështirësitë, për të sugjeruar aktivitete për zgjidhjen e problemeve;
- Diskutim me pjesëmarrës nga shkolla ose me partnerë jashtë shkollës për të marrë komente;
- Përdorimi i instrumenteve të pranuar të vlerësimit në nivele të përcaktuara brenda kornizës kohore në plan.

Monitorimi (si proces sistematik i mbledhjes së të dhënave) duhet të kryhet vazhdimisht gjatë periudhës së vlefshmërisë së Planit të Zhvillimit të Shkollës.

Vlerësimi i zbatimit të planit të zhvillimit të shkollës

Procesi i vlerësimit vlerëson shkallën në të cilën ishte e mundur të arriheshin qëllimet e renditura në secilën nga fushat prioritare të zhvillimit: plotësisht, pjesërisht ose pa arritje të rëndësishme. Rezultati i vlerësimit është baza për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ciklit të mëposhtëm të planifikimit të zhvillimit:

- Projektet që janë zbatuar mund të integrohen në jetën e shkollës;
- Projektet, qëllimet e të cilave janë arritur pjesërisht, mund të vazhdojnë edhe në ciklin e ardhshëm, me ndryshime të mundshme, si rezultat i identifikimit të vështirësive dhe pengesave drejt suksesit;
- Projektet, qëllimet e të cilave nuk janë arritur në mënyrë të konsiderueshme, mund të rishikohen rrënjësisht ose të zëvendësohen me projekte të reja, të cilat do të kenë një pamje më të mirë (shanse më të larta) për realizim më të suksesshëm në kuadër të prioriteteve të caktuara të zhvillimit.

Procesi i vlerësimit merr parasysh përvojën e të gjithë të përfshirëve në zbatimin e planit. Në këtë proces, vëmendje e veçantë i kushtohet mbledhjes së provave apo të dhënave në lidhje me treguesit apo kriteret e suksesit, me formulimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Sipas përvojës personale të autorëve, rekomandohet që provat të mund të mblidhen përmes:

- Pyetësorëve, anketave;
- Dokumenteve dhe protokolleve;
- Diskutimeve;
- Intervistave;
- Depërtimit në punën e nxënësve;
- Procesit të vëzhgimit

Vlerësimi (siç është analiza e të dhënave dhe vlerësimi i performancës) kryhet në mënyrë periodike - dhe ndjek faza të caktuara të zbatimit. Vlerësimet e suksesit të zbatimit do të kryhen një herë në vit, në fund të vitit shkollor, dhe raporti i vlerësimit është pjesë përbërëse e raportit vjetor për punën e shkollës. Mund të realizohet një shembull se si vlerësimi i aktiviteteve është paraparë nga Plani i Zhvillimit të Shkollës.

Metodat, teknikat dhe instrumentet për monitorim dhe vlerësim

Për të monitoruar dhe vlerësuar me sukses zbatimin e Planit të Zhvillimit të Shkollës, mund të përdoren mjete

standarde për mbledhjen e të dhënave, si: shënimeve e përdoruesve dhe shërbimeve, pyetësorët, intervistat, anketat, aksesit i drejtpërdrejtë në dokumentacion, etj..

Provat mund të mblidhen nëpërmjet:

- pyetësorëve;
- dokumenteve
- shënimeve të takimeve dhe protokolleve;
- diskutimeve;
- intervistave;
- punës së nxënësve;
- procesit të vëzhgimit;
- raporteve të vlerësimeve të pavarura dhe instrumenteve të tjera.

Mbajtësit e procesit të monitorimit dhe vlerësimit

Koordinatori i aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit është drejtori në bashkëpunim me Ekipin e Zhvillimit të Shkollës i cili përzgjedh treguesit dhe teknikat për matjen e tyre.

Përdorimi dhe shpërndarja e të dhënave të monitorimit dhe vlerësimit të Planit

Qëllimi kryesor i mbledhjes së të dhënave dhe bërjes së vlerësimeve të progresit dhe suksesit është të kontrollohet vlefshmëria dhe realizmi i SRS, dhe në këtë drejtim të korrigjohen qëllimet dhe detyrat, nëse është e nevojshme. Në fund të vitit shkollor, bazuar në rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të këtij plani, jepen rekomandime për përgatitjen e një aneksi/shtojcë të planit të veprimit të Planit të Zhvillimit të Shkollës.

Ndarja e rezultateve

1. Zhvilloni një plan për ndarjen e të dhënave, i cili përfshin: qëllimin e shkëmbimit të të dhënave, audiencën me të cilën ato ndahen, llojin e të dhënave që do të ndahen, mënyrat se si prezantohen të dhënat, vendet/institucionet në të cilat prezantohen dhe kush i ndan ato.

Mënyra në të cilat mund të prezantohen të dhënat janë:

- raporte
- broshura/fletëpalosja
- përshkrim i përmbledhur
- abstrakte kyçe
- artikuj në gazetë
- video
- PDF
- Prezantim në Power Point
- materiale promociionale

Vlerësimi është i rëndësishëm për të përcaktuar shkallën në të cilën është përmbushur Plani dhe është gjithashtu baza për planifikimin e ciklit të ardhshëm të planifikimit.

Shtojca 6: Plani për zbatimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit/Zhvillimit të Shkollës

AKTIVITETET	E përfun- duara	Në për- gatitje	Të papër- funduara	Komente
GJATË VITIT SHKOLLOR 20__/20__:				
FAZA PËRGATITORE				
Ekipi i Zhvillimit të shkollës i krijuar				
Vizioni dhe misioni i shkollës i hartuar/ zhvilluar				
Të gjithë e njohin misionin dhe vizionin e shkollës				
NË FUND TË VITIT SHKOLLOR 20__/20__ - QERSHOR / GUSHT:				
ANALIZA E SITUATËS – Mbledhja e të dhënave				
Të dhënat lidhur me rezultatet e shkollës në fund të vitit shkollor - të mbledhura				
Vetëvlerësimi/vlerësimi i bërë në fund të vitit shkollor				
Prindërit dhe nxënësit të përfshirë në vetëvlerësim në mënyrën e duhur				
ANALIZA E TË DHËNAVE				
Çështjet kryesore nga të dhënat e mbledhura – të identifikuar				
Shkaqet dhe faktorët e mundshëm që kontribuojnë në këto probleme – të identifikuar				
Të dhëna shtesë të mbledhura për të përcaktuar shkaqet e sakta të problemit				
Konsultime për prioritetet (fragment nga aktorët/palët e interesuara)				
FILLIMI I VITIT SHKOLLOR 20__/20__ - NGA FUNDI I SHTATORIT (DËRGONI VERSIONIN E PARË TË PLANIT)				
QËLLIMET AFATGJATA DHE AFATSHKURTRA				
Në bazë të problemeve të identifikuar, janë përcaktuar qëllime dhe detyra kryesore strategjike të caktuara				

Strategjitë dhe aktivitetet më të mira për realizimin e secilit prej qëllimeve dhe detyrave - të identifikuar					
Ekiye/individë të caktuar përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve					
Identifikimi i nevojave për trajnime shtesë profesionale, në mënyrë që të realizohen aktivitetet e planifikuara					
Plani strategjik afatgjatë i zhvilluar					
PLANI VJETOR					
Prioritetet (detyrat) për vitin e parë-të identifikuar					
Është hartuar një plan vjetor me afatin e saktë kohor të aktiviteteve dhe përgjegjësitë për vitin e ardhshëm shkollor					

GJATË VITIT SHKOLLOR 20__ /20__					
ZBATIMI I PLANIT					
Plan i zhvilluar për të takuar dhe përfshirë gjithësecilin në zbatimin e planit					
Takime të rregullta të ekipit					
Rishikimi i planit dhe ndryshimet (nëse është e nevojshme)					

MONITORIMI DHE VLERËSIMI					
Kohë dhe aktivitete të përcaktuara për monitorim					
Personat për monitorim dhe mbledhjen e të dhënave					
Monitorim dhe analizë e rregullt e të dhënave					



MODULI 5: SI TA ZBATOJMË PLANIN E VEPRIMIT/ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS

Për të siguruar zbatimin me sukses të aktiviteteve të planifikuara të Planit të Veprimit të Shkollave, është e nevojshme të shihet plani nga disa aspekte që ndikojnë në zbatimin e tij dhe të fillohet duke ofruar mbështetje ndaj (f)aktorëve kryesorë që lidhen me shkollën. Mbështetja e advokimit do të forcojë ekipet e shkollave, kryesisht drejtuesit e shkollës, për të promovuar idetë bazë të shkollës për planet e veprimit për të reduktuar ndikimin e SSE të nxënësve në suksesin e shkollës, në shkollat e tjera dhe nga vendimmarrësit në zonat/fushat e tyre.

PËRMBAJTJA E MODULIT

- Përmbledhja e rezultateve të procesit të të nxënësve në Programin e Zhvillimit të Shkollës dhe plotësimi i drafteve të Planit të Zhvillimit/Veprimit të Shkollës bazuar në mësimet e nxjerra.
- Rishikimi nga kolegët i planeve të hartuara të zhvillimit/veprimit të shkollës (ditar i dyfishtë)
- Mjetet e analizës së kontekstit dhe advokimi për zbatimin e Planit të Zhvillimit /të Veprimit - Harta e pushtetit, - Analiza e interesave të aktorëve kryesorë - Modeli pro-pro - Modeli i komunikimit strategjik

REZULTATET E MODULIT

Zhvillimi/planet e veprimit të shkollës:

- Plotësuar nga Ekipet e Veprimit të Shkollës me njohuri dhe ide të reja
- Rishikuar nga pjesëmarrësit e tjerë për të përmirësuar dhe gjeneruar ide të reja
- Të përgatitur për të filluar zbatimin e tyre, duke analizuar pengesat e mundshme dhe duke hartëzuar aleatët në procesin e zbatimit

DETYRAT E SHKOLLËS PAS MODULIT

- Dokumenti i parapërgatitur parafinal i Planit të Zhvillimit/ Veprimit të Shkollës, i cili do të rishikohet përfundimisht nga trajneri/mentori
- Nisja e procesit të zbatimit të Planit të Zhvillimit/Veprimit të Shkollës drejt trajtimit të nevojave të nxënësve me SSE të ulët

MJETI I ADVOKACISË PËR EKIPET E VEPRIMIT/ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS

Adnan Pripoljac

HARTAT E FUQISË/PUSHTETIT

Mendoni dhe përmendni të gjitha institucionet dhe individët që kanë ose do të kishin interes për problemin që po advokoni - interesa pozitive dhe negative. Paraqisni secilin person ose grup njerëzish të identifikuar me një simbol në një vend të përshtatshëm në hartë që pasqyron pozicionin e tij/saj në lidhje me problemin tuaj që advokoni (mbështet, neutralizon, kundërshton).

- Merrni parasysh pjesëmarrësit potencialë tradicionalë dhe jotradicionalë në procesin e avokimit, duke përfshirë krerët e qeverive, njerëz të famshëm, njerëz të biznesit etj.
- Shprehni kreativitet në zgjedhjen e një simboli për pjesëmarrësit individualë në proces: nëse ndikimi i atij pjesëmarrësi është më i madh, atëherë paraqiteni atë si një simbol më të madh dhe anasjelltas.
- Nëse pjesëmarrësi në proces është fort në anën e mbështetjes, simboli i tij duhet të jetë në anën e majtë të Hartës së Fuqisë/Pushtetit, d.m.th., nëse ai është fort kundër, simboli duhet të jetë në skajin e djathtë. Linja e neutralitetit është në mes të Hartës së Fuqisë/Pushtetit.
- Nëse veprimet e dy pjesëmarrësve në procesin e avokimit janë të lidhura ngushtë, simbolet e tyre mund të lidhen në Hartë, etj.

Pas krijimit të hartës, për të kuptuar më mirë marrëdhënien e pushtetit përsa i përket problemit, për zgjidhjen e të cilit po advokojmë, mund të bëjmë disa nga pyetjet e mëposhtme:


- A ka aleatë apo kundërshtarë shtesë për fushatat tona të avokimit, cilët janë ata?
- Ku gjendet në hartë fuqia më e madhe e ndikimit të vendimmarrësi për problemin?
- Në përputhje me fuqinë relative, si do t'i drejtonit përpjekjet tuaja advokuese: do të forconit mbështetjen, do të neutralizonit kundërshtarët apo do të përpiqeshit të bindnit të pavendosurit?

Së fundi, duhet theksuar se Harta e Fuqisë/Pushtetit mund të shërbejë si një imazh lëvizës i procesit të avokimit, d.m.th., simbolet e atyre pjesëmarrësve që lëvizin nga njëra anë në tjetrën gjatë procesit të avokimit mund të zhvendosen përgjatë hartës dhe kështu të pasqyrojnë rezultatet e avokimit.

HARTA E FUQISË/PUSHTETIT

Qëllimi i Advokimit publik:

Audienca e synuar:




MODELI I KOMUNIKIMIT STRATEGJIK

Advokimi efektiv varet nga aftësia e atyre që e udhëheqin atë për të bindur vendimmarrësin ose për ta detyruar atë të ndërmarrë veprime të caktuara. "Komunikimi strategjik është çdo aktivitet i planifikuar komunikimi që tenton të arrijë disa nga qëllimet e mëposhtme të komunikimit: Të Informoni, Bindni, Motivoni, Inkurajoni veprimin".

Një faktor kyç në komunikimin strategjik është të kuptuarit e mirë të audiencës së synuar dhe vështrimi i gjërave nga perspektiva e tyre. Advokuesi duhet të mendojë se çfarë do ta motivojë audiencën e synuar që të tregojnë mbështetjen e tyre për problemin. Kjo është ndoshta sfida më e madhe e komunikimit strategjik, duke e vënë veten në pozicionin e audiencës suaj dhe duke kuptuar se si do të përfitojnë ata nga mbështetja e problemit tuaj. Mendoni për rreziqet dhe përfitimet e mundshme me të cilat do të përballet audiencia e synuar duke bashkuar forcat me ju. Komunikimi strategjik i suksesshëm përmes informacionit, motivimit dhe bindjes duhet të çojë në veprimin e audiencës së synuar dhe në këtë mënyrë në arritjen e qëllimit të fushatës advokuese.

Një pjesë integrale e procesit të komunikimit strategjik është zhvillimi i një mesazhi efektiv që duhet ta inkurajojë marrësin të veprojë. Për të zhvilluar një mesazh efektiv në përputhje me modelin e komunikimit strategjik, është e nevojshme të zhvillohen disa pjesë thelbësore të të njëjtit.

1. Audiencia e synuar (të cilës i drejtohem);
2. Veprimi që dëshironi të ndërmarrë audiencia e synuar (nëse thjesht duam të informojmë/dhe motivojmë, dhe/ose bindim dhe/ose inkurajojmë audiencën të ndërmarrë veprime);
3. Përmbajtja (ideja qëndrore e mesazhit, cila është gjëja më e rëndësishme që dëshironi t'i përcillni audiencës, me çfarë ideje unike po komunikoni);
4. Fjalori (i referohet fjalorit që përdorni në një mesazh, nëse fjalët janë të qarta ose mund të interpretohen ndryshe nga audiencia të ndryshme, nëse zhargoni është i përshtatur me audiencën e synuar);
5. Transmetuesi i mesazhit (personi që do ta transmetojë mesazhin; nëse transmetuesi i mesazhit ka besueshmëri tek audiencia juaj e synuar);
6. Forma (kanali i komunikimit që përdorni për të përcjellë mesazhin tek audiencia e synuar, mund të jetë nënshkrimi i një peticioni, një takim i drejtpërdrejtë, një shfaqje televizive, etj.);
7. Koha dhe vendi (kur dhe ku do ta dërgoni mesazhin e fushatës suaj, nëse vendimmarrësi do t'ju dëgjojë më me kujdes në periudhën parazgjedhore, nëse mund të përdorni ndonjë datë të rëndësishme për t'u lidhur me strategjinë tuaj të komunikimit).



Modeli i komunikimit strategjik

QASJA PRO-PRO

Të menduarit integrues është një disiplinë dhe metodologji për zgjidhjen e problemeve komplekse. Teoria u zhvillua nga Roger Martin (Universiteti i Torontos). Martin e përkufizon të menduarit integrues si "aftësia për të shfrytëzuar në mënyrë konstruktive tensionin midis dy modeleve të kundërta dhe, në vend që të zgjidhet një në kurriz të tjetrit, të krijohet një zgjidhje e re krijuese që përmban elementë të të dy modeleve që është superiore ndaj të dyjave". Mendimi integrues na lejon të kuptojmë se mendimi ynë për problemin, ose zgjidhja e mundshme, është vetëm një pjesë e të gjithë tablosë dhe se për zgjidhjen është e nevojshme të shikojmë dhe të marrim parasysh mënyrën se si njerëzit e tjerë e shohin dhe interpretojnë të njëjtën situatë. Mendimi integrues na bën të mësojmë nga njerëz që kanë një mendim të ndryshëm nga i yni dhe, në vend që të zgjedhim një të zgjidhje apo zgjidhjen tjetër të kundërt, të gjejmë një pasqyrë krejtësisht të re dhe një qasje origjinale

në perceptimin e saj. Nga aspekti metodologjik, të menduarit integrues na mëson strategji, në të cilat kalojmë nga një qasje pro-kundër në një qasje dhe qëndrim pro-pro, duke përdorur më nga afër midis modeleve për të menduarit e ri.

HAPAT: Përcaktoni problemin që duhet zgjidhur: p.sh., mënyra se si vishen nxënësit në shkollë

Hapi 1: Përcaktoni modele të kundërta të zgjidhjes së të njëjtit problem

Për shembull, lejoni lirinë në zgjedhjen e veshjes në shkollë në krahasim me futjen e uniformave shkollore (ose p.sh., përdorimin e energjisë diellore në krahasim me përdorimin e naftës; OMGJ kundrejt ushqimit organik; përdorimi i qeseve plastike ...). Nisja nga dy zgjidhje të kundërta na lejon të shmangim kërkimin e një zgjidhjeje që do të ishte një kompromis.

Hapi 2: Hulumtoni modelet

Diskutoni dhe përshkruani në detaje të dy modelet - çfarë kuptimi kanë, si duket në praktikë. Kërkojuni nxënësve të eksplorojnë të dy modelet në thellësi, pavarësisht nëse janë dakord apo jo. Është e rëndësishme të përpiqeni të gjeni të gjitha avantazhet e të dy modeleve ose zgjidhjeve.

Hapi 3: Analizoni këndvështrimet e ndryshme

Për secilin prej modeleve, përcaktoni grupet kyçe që do të mbuloreshin nga ai model ose ajo zgjidhje - të gjithë ata që mund të kenë disa pasoja, të përfitojnë ose të jenë të interesuar për problemin (në rastin e veshjes në shkollë mund të jenë nxënësit, prindërit, mësuesit, ose dikush në komunitet ...).

Hapi 4: Përcaktoni arsyet

Për secilin prej modeleve, ndani letrën flipchart në aq kolona sa numri i grupeve, këndvështrimin e të cilëve po analizoni (si fillim mund të jenë tre grupe) dhe për secilin nga grupet përcaktoni emërtimin e tre arsyeve për të cilat modeli është i mirë për ta - çfarë përfitimesh kanë ose mund të kenë, në mënyrë që aplikimi i atij modeli të mund të ndikojë pozitivisht tek ta.

Hapi 5: Lidhja midis modeleve

Grupet analizojnë së bashku modelet dhe përfitimet për grupet, duke u përpjekur të gjejnë nevoja të përbashkëta që trajtohen në mënyra të ndryshme dhe vërejnë ngjashmëri dhe kuriozitete të tjera midis grupeve. Përmbledhni gjithçka, përdorimet dhe avantazhet e modelit me një fjalë - emër.

Hapi 6: Riformuloni problemin

Rivendoseni problemin në mënyrë që të përmbajë të dyja fjalët kyçe nga modeli. Nëse fjalët kyçe janë p.sh., individualizmi (pa uniforma) dhe barazia (me uniforma), një formulim i ri i problemit tdo të jetë: Si mund ta trajtojmë çështjen e veshjes në shkollë duke ruajtur individualitetin dhe duke nxitur barazinë?

Hapi 7: Gjeni një zgjidhje të re

Vëri nxënësit në grup të diskutojnë se si të përpiqen të gjejnë një zgjidhje të re krijuese për problemin që dot'i kënaqë të dyja palët. Analizojini të gjitha zgjidhjet dhe përpiquni të sugjeroni një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe prezantoheni atë p.sh., në këshillin e mësuesve ose këshillin e prindërve. Modeli shkakësor mund të përdoret për të analizuar veprimet e personazheve në libër, për të analizuar ndikimin e formave të ndryshme, industrinë e ndotjes së mjedisit, etj.

HAPI 8: Testoni prototipin

Mendoni për hapat dhe të gjitha supozimet e nevojshme për ta bërë modelin tuaj të zbatueshëm. Krijoni një plan veprimi.

Ju mund të përdorni fleta ose këto skeda për të analizuar këndvështrime të ndryshme:

Ky model është i mirë, sepse ai lejon të:

Nga:

Ky model është i mirë, sepse ai lejon të:

Nga:

Ju gjithashtu mund ta përdorni modelin PRO-PRO për të analizuar problemin me të cilin përballet një personazh në një histori, një problem jetësor në përgjithësi, si edhe kur merrni vendime të rëndësishme ku ka zgjidhje të kundërta, etj.

BIBLIOGRAPHY

- Albright, M. I., & Weissberg, R. P. (2010). School-family partnerships to promote social and emotional learning. U S. L. Christenson, & A. L. Reschly, Handbook of school-family partnerships for promoting student competence (str. 246-265). New York: Routledge.
- Benson, P. L. (2006). All kids are our kids: What communities must do to raise caring and responsible children and adolescents. Jossey-Bass.
- Bezinović, P. (2010). Samovrednovanje škola. Zagreb: Agencija za odgoj i obrazovanje i Institut za društvena istraživanja.
- Bogunović, B., & Polovina, N. (2007). Obrazovno-materijalni kontekst porodice i odnos učenika prema školovanju. Zbornik Instituta za pedagoška istraživanja.
- Deal, T. E., & Peterson, K. D. (1999). Shaping school culture: The heart of leadership. San Francisco, CA: Jossey-Bass.
- Deal, T. E., & Peterson, K. D. (2016). Shaping School Culture, Third Edition. John Wiley & Sons, Inc.
- Dearing, E. (2008). Psychological Costs of Growing Up Poor. Reducing the Impact of Poverty on Health and Human Development: Scientific Approaches, 324-332.
- Djajkowska, B., Joshevska, M., Kirandziska, S., Kožić Komar, V., & Vranješević, J. (2019). Suzbijanje društvenih tabua o siromaštvu: Kreativne ideje za ublažavanje posljedica siromaštva na djecu i mlade: aktivnosti za rad u školi. Zagreb: Mreža centara za obrazovne politike (MCOP).
- Eccles, J. S., & Barber, B. L. (1999). Student council, volunteering, basketball, or marching band: What kind of extracurricular involvement matters? Journal of Adolescent Research, 10-43.
- Engle, P. L., & Black, M. M. (2008). The Effect of Poverty on Child Development and Educational Outcomes. Impact of Poverty on Health and Human Development: Scientific Approaches, 243-256.
- Farooq, M. A. (2007). Application of total quality management in education. Journal of Quality and Technology Management, str. 87-97.
- Fredricks, J. A., & Eccles, J. S. (2006). Is extracurricular participation associated with beneficial outcomes? Concurrent and longitudinal relations. Developmental Psychology, 42(4), 698-713.
- Fullan, M. (2001). Leading in a culture of change. Jossey-Bass.
- Fullan, M., & Hargreaves, A. (1996). What's Worth Fighting for in Your School? New York: Teachers College Press.
- Gossen, D., & Anderson, J. (1996). Stvaranje uvjeta za kvalitetne škole. Zagreb: Alinea.
- Henderson, A. T., & Mapp, K. L. (2002). A New Wave of Evidence: The Impact of School, Family, and Community Connections on Student Achievement. Austin: National Center for Family & Community Connections with Schools, Southwest Educational Development Laboratory.
- Henderson, A. T., Mapp, K. L., Johnson, V. R., & Daves, D. (2007). Beyond the bake sale, The essential guide to family - school partnerships. New York: New Press.
- Hoy, W. K. (1990). Organizational climate and culture: A conceptual analysis of the school workplace. Journal of Educational Psychology Consultation, 1, 149-168.
- Krajišnik, N. (2019). Škola vrijednosti. Sarajevo: Centar za obrazovne inicijative Step by Step.
- Mahoney, J. L., & Cairns, R. B. (1997). Do extracurricular activities protect against early school dropout? Developmental Psychology, 33(2), 241-253.
- Martin, J., & Siehl, C. (1983). Organizational culture and counterculture: An uneasy symbiosis. Organizational Dynamics, 12(2), str. 52-64.
- Martin, R. (2007). The Opposable Mind.
- McDemot, D. (2008). Developing Caring Relationships Among Parents, children, schools, and Communities. Sage Publications Inc.
- Mlekuž, A., Veladin, M., & Haugas, S. (2018). Education and Socio-Economic Status - Estonian Case. Zagreb: Network of Education Policy Centers (NEPC).
- Narayan, D., & Petesch, P. (2007). Moving Out of Poverty : Volume 1. Cross-Disciplinary Perspectives on Mobility. Washington, DC: World Bank and Palgrave Macmillan.
- Prosser, J. (1999). The Evolution of School Culture Research. London: Paul Chapman Publishing Ltd.
- Seligman, M. E. (2011). Flourish: A Visionary New Understanding of Happiness and Well-Being. New York: Free Press.

- Sharp, R. (2014). Ready, steady, action: what enables young people to perceive themselves as active agents in their lives? *Education Psychology in Practice* 30(4).
- Tinjak, M. (2020). *Škole i roditelji partneri*. Sarajevo.
- Todorović, J. (2004). Vaspitni stilovi u porodici i stabilnost samopoštovanja adolescenata. *Psihologija*.
- Vuković Vidačić, J. (2016). *Školska kultura*. Rijeka.
- Welzel, C., & Inglehart, R. (2010). Agency, Values, and Well-Being: A Human Development Model. *Springer Open Choice*, 43-63.
- Zaff, J. F., Moore, K. A., Papillo, A. R., & Williams, S. (2003). Implications of Extracurricular Activity Participation During Adolescence on Positive Outcomes. *Journal of Adolescent Research*, 599-630.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

arise Action for Reducing
Inequalities in Education

<https://www.arisenetwork.eu>
<https://www.facebook.com/ARISEproject/>
<https://twitter.com/NetworkArise>

ARISE Consortium

